RAPORT PËRFUNDIMAR MBI "AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË PËR VEPRIMTARINË E USHTRUAR NË AGJENCINE RAJONALE TË MJEDISIT TIRANË, DURRËS, DIBER"

	Përmbajtja	1
I	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	1-2
	1.Përshkrim i shkurtër Projektit të Auditimit	2-4
	2.Përshkrim i gjetjeve kryesore	2-4
	3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	4-7
II	**HYRJE**	7-7
	1.Objekti i auditimit	7-7
	2.Qëllimi i auditimit	7-8
	3.Identifikimi i çështjes	8-8
	4.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-8
	5.Përgjegjësitë e audituesve	8-8
	6.Kriteret e vlerësimit	9-9
	7.Standardet e Auditimit	9-9
	8.Metodat e auditimit	10-10
	9. Dokumentimi i auditimit	10-10
III	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	10-10
	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	10-11
	2.Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	10-11
Pika 1	1.Mbi hartimin dhe Zbatimin e buxhetit të shtetit 1.1Mbi zbatimin e kritereve dhe procedurave të hartimit të buxhetit (PBA)	11-14 14-17
Pika 2	2. Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare. 2.1. Pasqyrat financiare dhe plotësimi i formularëve të bilancit 2.2Inventarizimi i pronës shtetërore	17-21 21-25 25-30
Pika 3	3.Auditim mbi zbatimin e ligjshmërisë në monitorimin e mjedisit, dhënie mendimi për Lejet të Tipit A, B, dhënie mendimi për Vlerësimin në Mjedis (VNM) paraprake dhe të thelluara,	30-54
Pika 4	4. Mbi auditimin e zbatimit të procedurave inspektimit në fushën e mjedisit, 4.1.Auditim mbi kryerjen e monitorimeve , 4.2.Auditimi i dokumentacionit këshillime, sanksione si dhe masat administrative me gjobë,	54-76 76-77 77-83
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	83-92
V.	**ANEKSE**	93-95

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Agjencia Rajonale e Mjedisit, Tiranë Durrës, Dibër kryen veprimtarinë në zbatim të VKM-së, nr.568,datë 17.07.2019,"Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 " Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së. Ligjin Nr. 53/2020 " Për disa ndryshime të Ligjit Nr.10431, date 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit, "i ndryshuar, Ligji Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Ligjit Nr.52/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit". Ligji nr. 10433, dt.16.06.2011"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".etj.. ka për objektiv: dhënien e mendimeve për leje të Tipit A, B mendime për VNM paraprake dhe të Thelluara, monitorimin e subjekteve të licencuara, inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave ndaj subjekteve të pajisura me leje mjedisore, ndjekjen në rrugë gjysorederi në arkëtimin e tyre ndaj subjekteve që janë marrë masa administrative me dënime (gjobe) si dhe si veprimet financiare .

I .1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

I.2. Auditimimi ushtruar në ARM,Tiranë Durrës, Dibër u realizua "Auditimin Financiare dhe i Përputhshmërisë në "Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë ,Durrës, Dibër.

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër (ARM) gjatë periudhës së përgatitjes së projekt-buxhetit, u konstatua se mungonte një analizë ekonomiko financiare, në mënyrë analitike të kostos për çdo aktivitet, përfshirë dietat dhe shpenzimet operacion ale, që do të kryhen gjatë vitit, veprime këto në kundërshtim me pikat 46-48 të Udhëzimit nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm	**Fq.11-14**	*E mesme*	Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që bashkëlidhur me projekt-buxhetin përfundimtar për AKM dhe MTM, të dërgojë kërkesat e saj për fonde me tregues statistikor të matshëm, për aktivitetin e çdo sektori si pjesë e detyrave funksionale, për efekt të llogaritjeve me efektivitet të shpenzimeve
2	VKM nr. 783, datë 22/11/2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël". Nuk është kryer Kontabilizimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, pra nuk janë mbajtur kartelat dyfishe sipas udhëzimit nr. 30. Date 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Nga Specialisti i financës nuk është hartuar bilanci i konsoliduar për dy DRM-të,sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, në Njësitë e Qeverisjes se Përgjithshme".	**Fq.21-25**	*E mesme*	Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që Specialisti i financës, të marrë masat për të çelur ditarët kontabël dhe të pasqyrojë veprimet ekonomike sistematikisht dhe në mënyrë kronologjikë si dhe të kundrojnë bilancet përkatëse në një bilanc të konsoliduar**a.**
3	Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës Dibër, nuk ka bazë të dhënash të subjekteve të pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis, mbi bazën e të cilave të hartojë programet vjetore dhe mujore të inspektimit bazuar mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut. Në planifikimet vjetore e mujore dhe në inspektimet e kryera, nuk ka përfshirë një masë të konsiderueshme të	**fq.60-62**	*E Lartë*	Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa për krijimin e regjistrave të subjekteve që ushtrojnë aktivitet si dhe krijimin e dosjeve për çdo subjekt objekt inspektimi. Në programet vjetore dhe mujore të inspektimit të pasqyrohet dhe inspektorët që kryejnë inspektimet, të hartohen në bazë risku, ku të përcaktohet në detaje inspektimi, duke u nisur nga informacioni

	subjekteve që ushtrojnë aktivitet në Qarkun e Tiranë Durrës Dibër, për 6/mujorin e dytë 2020, janë anuluar 36 inspektime pasi janë hedhur në sistem nga Titullari, autorizimet kanë të përfshira fusha të ndryshme të veprimtarisë së subjekteve të pajisura me leje mjedisore, në kundërshtim me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2, nenet 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit". Po ashtu, nuk ka metodologji konkrete për llogaritjen e riskut dhe frekuencën e inspektimit gjatë një vititë subjekteve që do të inspektohen			paraprak për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetet në Qark, në bashkëpunim me institucionet e qarkut si Drejtoria Rajonale e Tatimeve, QKB, Bashki e Njësi Administrative si dhe institucione të tjera që janë objekte të ndotjes dhe mbetjeve integrale.
4	Në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, programi vjetor i inspektimit, për periudhën korrik 2020 dhjetore 2021, nuk është hartuar sipas përcaktimeve ligjore të bëra në shkronjat "a, c, ç dhe d" të pikës 2 të Urdhërit nr.5, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve"; - Programet mujore të inspektimit për periudhën 2020 dhjetore 2021, nuk janë dërguar për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të Kreut IV të VKM nr.696, datë 16.08.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "einspektimi	**Fq.59-78**	*E lartë*	ARM, për subjektet e inspektuara në 1.5 vitet e fundit, të bëjë një vlerësim të sjelljes së tyre ndaj respektimit të kërkesave ligjore, si dhe në bazë të këtij vlerësimi, të bëhet ndryshimi i kategorizimit të riskut të tyre (i lartë, i mesëm, i ulët), e për rrjedhojë edhe frekuenca e inspektimit të tyre, gjatë planifikimit të inspektimit.
5	Nga auditimi u konstatua se, sektori i mjedisit nuk ka kryer verifikim në terren për subjekte, që kalojnë kapacitetet, nga lejet të Tipit C, në leje të Tipit B, sidomos pikat e karburantit, pas ndryshimeve ligjore nr. 52/2020 "Për Lejet Mjedisore",	**Fq.56-78**	*E mesme*	Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që sektori i mjedisit, të kryejnë verifikim në terren për këto subjekte, për pajisjen e tyre me leje mjedisore dhe verifikim nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore
6	Në 12 raste inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet se: "subjekti u gjend i mbyllur", ose nuk gjendet ne adresën e dhëne. Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit dhe nuk është lënë detyrë për paraqitje në ARM për marrje dijeni të problemeve të trajtuara, - Në 4 rastet e lënies procesverbalit kryesisht kur subjekti është gjetur i mbyllur, nuk është përcaktuar kohë e kryerjes për herë të dytë të inspektimit, apo njoftimi i detyruar nga subjekti për realizimin e detyrës.	**Fq.59-74**	*E mesme*	Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa për hartimin e një liste me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB, në bashkëpunim edhe me Drejtoritë Rajonale Tatimore.
7	Nga auditimi u konstatua se: për periudhën objekt auditimi në 15 raste nuk janë kthyer përgjigje, ankesave të ardhur nga qytetarë në lidhje me problematikat në lidhje me ndotjen e mjedisit, në të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 " Për Arkivat" dhe Kreun e III-të "Njoftimet dhe afatet Kohore për bërjen e tyre, neni 56, detyrimi për tu njoftuar, neni 59 Afatet kohore për njoftim dhe afatet	**Fq65-69**	*E larte*	Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës Dibër të marrë masa që të ngrejë grupe inspektimi për ato subjekte ndaj të cilave janë administruar ankesa nga qytetarët.

	kohore për zbatimin e akteve administrative të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999" Kodi Procedurës Administrative" me ligjin "Për të Drejten e informimit"			
8	Nga auditimi u konstatua se: për periudhën objekt auditimi 2020-2021 në praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B në dosjet përkatëse mungojnë dokumente mbështetëse, dokumente këto paraprake, mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi. Nuk ka informacione nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për ecurinë e procedurës për praktika të dhënieve të mendimit. Veprime në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe me Ligjin Nr.10440 datë 07.07.2011 " Për vlerësimin e ndikimit në mjedisit.	**Fq.30-55**	*E mesme*	Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që: - Në praktikat e dhënies së mendimit për VNM apo mendime për Leje mjedisore Tipi A/B, të bashkëlidhin dhe përfshijnë në dosje dokumente plotësuese dhe mbështetëse, pasi të jenë miratuar me udhëzim formatet përkatëse, me synim që të vërtetojnë realizimin e procedurave dhe justifikojnë dhënien e mendimit.
9	Nga auditimi u konstatua se: për periudhën objekt auditimi 2020-2021 Agjencia Rajonale Tiranë, Durrës, Dibër, procedurën e dëgjesës me publikun për lejet mjedisore Tipi A / B, i ka realizuar në një afat të shkurtër kohor (5-7 ditë) nga delegimi i dëgjesës nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.	**Fq30-55**	*E mesme*	Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që: njoftimi i dëgjesës me publikun të qëndrojë më gjate se 15 ditë në ëeb, me qëllim sensibilizimin dhe informimin sa më shumë pjesëmarrësve në takim.
10	Nga auditimi u konstatua seARM Tiranë,Durrës, Dibër për 14 subjekte të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e monitorimin mjedisor kriteret e tjera ligjore,nuk ka marrë masa administrative me gjobë ndaj subjekteve përkatëse (nga300 mijë lekë deri 500 mijë lekë), duke shkaktuar të ardhur të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën ***4,200 mijë lekë****(300 gjoba minimale x 14 subjekte = 4,200 mijë lekë)* në kundërshtim me nenin29 pika b (ii) të ligjit nr. 10488/2014 "Për lejet e mjedisit.	**fq.59-70**	*E Mesme*	Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që të njoftojë me afate konkrete subjektet mbi dorëzimin e raporteve të monitorimit mjedisor, si dhe shkeljeve tjera në të kundërt të aplikojë masa administrative me gjobë për 14 subjektet në vlerën **4,200 mijë lekë**.

A. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Ne kemi audituar veprimtarinë e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit Tiranë, Durrës Dibër, përsa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve, termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit financiare/të përputhshmërisë),Referuar VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019 **"**Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 23, , datë 03.02.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së, në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", dhe (ISSAI 4100)[1]Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualet e Auditimit.

Opinion mbi pasqyrat financiare (I pamodifikuar/pa kualifikuar)

Nga auditimi i pasqyrave financiare, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit *ISSAI 1700 DHE ISSAI 1200*, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe Manualin e Auditimit Financiar, përsa i përket shkallës së zbatimit nga subjekti *Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë Durrës Dibër,* të standardeve të kontabilitetit, të ligjit mbi

[1] ***ISSAI 4100*** *- Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet veçmas me auditimin e pasqyrave financiare.*

kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, udhëzimeve e kushteve të vendosura apo termave mbi raportimin financiar, mbi të cilat është rënë dakord *(kriteret e auditimit financia*r), u evidentua se transaksionet financiare të realizuara gjatë aktivitetit të subjektit, paraqiten në përputhje me kuadrin rregullator të raportimit financiar dhe se pasqyrat financiare paraqiten në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, në kornizën e zbatueshme të raportimit financiar.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare

Ne audituam pasqyrat financiare të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë Durrës Dibër, më datë 31.12.2019, më 31.12.2020, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar; pasqyrën e përfomancës financiare; pasqyrën e flukseve monetare; pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimin e aktiveve afatgjata; pasqyrën e amortizimit të aktiveve; shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare. Pasqyrat financiare të vitit 2020-2021, ishin në proces, për këtë arsye ne si audites nuk japim opinion për këtë periudhë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në konstatimet se, bilancet, banka, janë përfshirë në pasqyrat financiare. Pasqyrat financiare janë paraqitur sipas ligjit të kontabilitetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Evidencat e auditimit të ofruara janë të mjaftueshme dhe ofrojnë një bazë të mjaftueshme për dhënien e *opinionit të pakualifikuar.*

- Në momentin e fillimit të inventarizimit në objekt, anëtarët e komisionit të inventarizimit nuk kanë përpiluar deklarata për konflikt të interesit me punonjësit me përgjegjësi materiale, ose që kanë në përdorim aktive.

-Nga auditimi u konstatua se veprime kontabël në ditarët e magazinës nuk mbaheshin konfirm VKM-së nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël".

-Nga ARM Tiranë Durrës, Dibër, nuk është planifikuar në Projekt buxhetet përkatëse dhe buxhetin afat mesëm, paraqitja e numrit të inspektimeve në mënyrë që të bëhet planifikimi në artikullin 602 (dieta +karburant) për punonjësit pasi ka një shtrirje të gjerë territorialë dhe inspektimet kryhen në shumë raste mbi 50 km nga qendra e punës.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim

Drejtimi i ARM Tiranë, Dibër, Durrës, është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të kolauduar me një raport auditimi që përfshin një opinion.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Opinion mbi përputhshmërinë:(I modifikuar /kualifikuar)

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë Durrës Dibër me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me

monitorimin , dhënien e mendimit për leje mjedisore, për VNM të thelluara dhe paraprake si dhe inspektimet në fushën e mjedisit dhe ujërave .

Në opinionin tonë, bazuar në punën e kryer ka rezultuar se aktiviteti i ARM Tirane Dibër Durrës, është në përputhje me të gjitha aspektet materiale me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" si dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë"

Baza për opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne jemi të pavarur nga ARM Tirane Dibër Durrës në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e përputhshmërisë, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme[1] për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISSAI 400 & ISSAI 4000).

Në besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit i kualifikuar Dhënien e opinionit **i kualifikuar** e mbështesim në konkluzionet e mëposhtme të arritura në përfundim të procesit të auditimit për marrjen e masave në zgjidhjen e çështjeve:

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës Dibër, nuk ka një bazë të dhënash të sakta dhe të listuara sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun e Tiranë.

-Nuk është bërë identifikimi i subjekteve që ekspozohen me risk të lartë e ndikim në mjedis, mbështetur në të dhëna të administruara në regjistra ose në data-basë të veçanta. Kjo është kërkesë në përmbushje të detyrimeve ligjore dhe detyrimeve që rrjedhin nga Urdhri i Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.04.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë" dhe nr. 4, datë 19.02.2015"Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut.

-Planet mujore të inspektimit nuk janë të plota në informacionin që përmbajnë, pasi në këto plane pasqyrohet vetëm tematika e inspektimit, jo edhe grupet e inspektimit.

Agjencinë Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës Dibër, sektori i mjedisit nuk kanë kryer dhe bërë verifikim në terren për subjektet që kanë kaluar në leje të Tipit A, B pas ndryshimeve në ligjin 52/2020 "'Për Lejet Mjedisore".

-Në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë mungonin relacionet, raportet e realizimit të inspektimeve, nga Sektorët e mjedisit dhe ujërave, ku nga raportimet mujore konstatojmë se kryesisht treguesit janë raportuar vetëm në nivelin faktik dhe jo të ta beluar e krahasuar me treguesit e parashikuar në Planet vjetore .

-Në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës Dibër, janë anuluar 36 inspektime pasi janë hedhur në sistem nga Titullari, autorizimet kanë të përfshira fusha të ndryshme të veprimtarisë së subjekteve të pajisura me leje mjedisore.

-Në 8 raste inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet se: "subjekti u gjend i mbyllur", bashkëngjitur nuk ndodhej dokumentacioni verifikues, në terren si foto etj...

Nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër për periudhën 2020-2021 nuk ka informacione nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për ecurinë e procedurës për praktika të dhënieve të mendimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe me Ligjin Nr.10440 datë 07.07.2011"Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës Dibër.

Strukturat drejtuese të ARM, janë përgjegjëse për miratimin e dhënie mendimi për lejet e Tipit A, B, për VNM të thelluara dhe paraprake për monitorim të subjekteve ne fushën e mjedisit, inspektimet ne sektorin e ujerave dhe mjedisit, për vendosjen dhe ndjekjen e masave administrative(gjoba) deri ne arkëtimin e tyre në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës, si dhe kryerjen e kthimit të përgjigjeve ndaj ankesave nga të tretët (qytetaret) ndaj publikut brenda afateve ligjore, me qëllim rritjen e besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Stafi drejtues është përgjegjës për drejtimin e institucionit, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse monitorimi dhënie mendimi për lejet mjedisorë, VNM, për inspektimet dhe marrjen e masave administrative ndaj subjekteve nga ARM-së,Tiranë, Durrës, Dibër, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprime të mësipërme janë kryer, në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe kërkesat ligjore. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e aktivitetit të institucionit gjatë të periudhës objekt auditimi, duke i përshkruar në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor, nuk lejon vënien në dispozicion të tyre, për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Programit të Auditimit nr.155/1 datë 14.02.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 14.02.2022,deri në datë 30.03.2022, në subjektin Agjencia Rajonale Mjedisit Tiranë, Durrës Dibër,(ARM)për periudhën nga 01.07.2021 deri në 31.12.2021,u krye auditimi" Financiare dhe përputhshmërisë", nga **Grupi i Auditimi me përbërje:**

1.V,B, përgjegjës grupi
2.Sh. H, anëtare

***1.Objektivat i auditimit*:** Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të institucioneve përkatëse për procedurat e monitorimit, të subjekteve me ndikim në mjedis nga ndotja dhe dëmtimi, vlerësimin e kryerje e inspektimeve në fushën e mjedisit, dhënie mendimi subjekteve për pajisjen me leje mjedisore të Tipit A, B, (VNM) në zbatim të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"; VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "*Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi Tipi A, B, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për Lejet Respekt ivë të Mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre Lejeve nga QKL*", aktivitetin ekonomiko-financiar, përformancën e punës në përmbushje të funksioneve ligjore të mbrojtjes së mjedisit.

2.Qëllimi i auditimit: është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i përputhjes së veprimeve procedurale, administrative, ekonomike e financiare të Agjencinë Rajonale të

Mjedisit Tiranë ,Durrës,Dibër,mbi çështjet që lidhen me ruajtjen, menaxhimin, monitorimin inspektimin në fushën e mjedisit,

3. Identifikimi i çështjes

1-Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit ,

2- Mbi auditimin e Pasqyrave Financiare, inventarizimi i pronë shtetërorë,

3-Auditimi i proceduarave të monitorimit , dhënie mendimi VNM paraprake dhe të thelluara, dhënie mendimi për leje mjedisore Tipi A, B.

4-Auditimi mbi dokumentacionin e mbajtur, zbatimi i procedurave sanksione inspektime kontrollet e kryera në terren .

5-Auditimi i inspektimit të ankesave nga të tretët .

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Drejtoria Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër,Referuar VKM-së nr.568,datë 17.07.2019 **"**Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së, ligjit dhe me ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" të ligjit nr.10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit"; VKM nr. 419, datë 25.06.2014 "*Për Miratimin e Kërkesave të Posaçme për Shqyrtimin e Kërkesave për Leje Mjedisi Tipi A, B* etj..

-Si dhe udhëzimeve te dala nga Ministria Mjedisit dhe Turizmit.

-dhënie mendimi VNM paraprake dhe të thelluara, dhënie mendimi për leje mjedisore Tipi A, B.

-Inspektimi i praktikave në fushën e mjediset, si dhe dënimet administrative

5. Përgjegjësitë e audituesve:

Grupi i auditimit të KLSH-së, për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimitnë përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, grupi i auditimit ka zbatuar Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit, si dhe Standardet e Miratuara të Auditimit të cilat kanë në qendër të vëmendjes:

- Monitorimi dhe vete monitorimi i subjekteve që pajisen me leje

-Dhënia mendimi për lejet mjedisore të tipit A, B ,

Dhënia mendimi për VNM të thelluara dhe paraprake, konsultime me publikun.

- Inspektimi i praktikave në fushën e mjedisit në portal.

Ankesat e administruara nga të tretët

- Ballafaqimi dhe diskutimi i rezultateve të auditimit me personat përgjegjës.
- Përcaktimi i rekomandimeve në bazë të gjetjeve nga auditimi, për përmirësimin e gjendjes në të ardhmen, mbi përmirësimin e punës ne veprimtarinë që kryen institucioni.

6 Kriteret e vlerësimit:

Përcaktimet ligjore dhe rregullat e funksionimit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë Durrës,Dibër,normat dhe metodat e përcaktuara sipas kërkesave të ligjeve, akteve administrative, rregullores së institucionit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe data basë e subjekteve të pajisura me leje mjedisore ,VNM dhe dhënieve për mendim për lejet mjedisore.

Në të gjitha fazat e auditimit sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën është patuar si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",-Ligjin Nr.10433 date16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" VKM nr.568, datë 17.07.2019 "Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 " Për

miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së. Ky angazhim ka patuar si mision auditimin, përputhshmërisë dhe financiar, asetet, sistemin organizativ të funksionimit të mjedisit, ujërave dhe monitorimit, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër. Veprimtaria e kësaj strukture bazohet në Ligjin Nr. 53/2020 " Për disa ndryshime të Ligjit Nr.10431, date 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit, "i ndryshuar, Ligji Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Ligjit Nr.52/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit". Ligji nr. 10433, dt.16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" Ligj Nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore në ligjin nr. 111/2012", Ligj Nr. 9115 dt. 24.07.2003 "Për trajtimin e ujërave të ndotura" të ndryshuar, Ligj Nr. 8905, datë 06.06.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit detar, Ligji Nr. 9103, datë 10.07.2003 "Për mbrojtjen e Liqeneve Ndërkufitare" i ndryshuar'.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

-llojet e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve të cilat mund të ndodhin;

-procedurat e mekanizmave të auditimi, që i shërbejnë parandalimit dhe zbulimit të këtyre gabimeve, të metave, parregullsive dhe shkeljeve;

-nëse janë miratuar procedurat e duhura dhe nëse niveli i respektimit të tyre, është i kënaqshëm;

-anët e dobëta të mekanizmave ekzistuese të auditimi, që çojnë në mos zbulimin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve prej tyre;

-ndikimi që këto anë të dobëta kanë, dhe:

-shpërndarjen në kohë dhe intensitetin e gabimeve, parregullsive, të metave dhe shkeljeve.

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë, komfor me parimet, normat, rregullat dhe ligjet në fuqi.

7. Standardet e auditimit

Rregullorja e Brendshme "Mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme "Për procedurat e auditimit të KLSH"; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 1,datë 04.11.2016" Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t" (ISSAI), "Standardet e Kontrollit të KLSH", "Manualeve" si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

8. Metodat e auditimit

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:

a)*Metoda e ekzaminimit*: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe evidencën e veprimeve.

b)*Metoda e ekzaminimit kryq*: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve**.**

c)*Metoda e intervistimit*: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patuar përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxheria dhe operacione gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.

d)*Metoda e testimit të detajuar*: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistomi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimi.

10. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230"Dokumentimi i Auditimit".Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Agjencia Rajonale e Mjedisit, Tiranë Durrës, Dibër kryen veprimtarinë në zbatim të VKM-së, nr.568,datë 17.07.2019,"Për Krijimin dhe mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 " Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së. Ligjin Nr. 53/2020 " Për disa ndryshime të Ligjit Nr.10431, date 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit, "i ndryshuar, Ligji Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Ligjit Nr.52/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit". Ligji nr. 10433, dt.16.06.2011"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë".etj.. ka për objektiv: dhënien e mendimeve për leje të Tipit A, B mendime për VNM paraprake dhe të Thelluara, monitorimin e subjekteve të licencuara, inspektimin në fushën e mjedisit, ujërave ndaj subjekteve të pajisura me leje mjedisore, ndjekjen në rrugë gjyqësore deri në arkëtimin e tyre ndaj subjekteve që janë marrë masa administrative me dënime (gjobe) si dhe si veprimet financiare .

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve tëauditimit.

Pika 1. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

- Hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit; U përdorën kriteret ligjore si më poshtë:

-ligjit 9936, datë 21.07.2008"*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, sipas*"*

-ligji *88/2019 datë 18.12.2019 " Për buxhetin e vitit 2020", ligjin* nr.137/2020, datë 16.11.2020 "*Për buxhetin e vitit 2021".*

-Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm(PBA)përbën finalizimin e fazës sëparë,tëprocesittëpërgatitjes së kërkesave buxhetore afatmes me 2020-2021. Procesi është iniciuar përmes Vendimeve tëKëshillittë Ministrave, udhëzimeve, etj.

Për përgatitjen e Planit Buxhetor Afatmesëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, janë ngritur Ekipet e Menaxhimit të Programeve në kuadër të punës për Strategji, Buxhet dhe integrim, i cili do të ndjekë menaxhimin dhe sigurimin e zbatimit të ekipeve në dy faza sipas programeve në MTM.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër ka hartuar projektbuxhet vjetor për vitin 2020–2021 të cilat janë dërguar me shkresën nr/prot.225, datë 20.08.2019, për vitin 2020, projektbuxhet vjetor 2018-2021, me shkresën nr/prot.124, datë 17.08.2020, për vitin 2021, në AKM, si pjesë e programit të PBA-së ka hartuar projektbuxhet vjetor për periudhën afatmesëm 3- vjeçare të cilat janë dërguar për miratim në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës në MTM, nga AKM-ja,*por mungon urdhri dhe grupi i punës, mungojnë, kriteret,* procedurat dhe afatet nuk dokumentohen mbështetur me treguesit bazë numri i inspektimeve, këshillimeve, aktiviteteve, shoqatat, organizatat, njësitë vendore, në fushën e Mjedisit, Ujërave, me kostot përkatëse të çdo inspektim dhe aktivitet për secilin vit 2020, 2021, dhe bazën mbi të cilat do të mbështeteshin PB dhe PBA reale, funksionale në përmbushje të funksioneve ligjore të ARM Tiranë Durrës Dibër, *mangësi kjo në kundërshtim* me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; UMF nr.8, datë 29.3..2012"Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së PBA", Ligji *88/2019 datë 18.12.2019 " Për buxhetin e vitit 2020", ligjin* nr.137/2020, datë 16.11.2020 "*Për buxhetin e vitit 2021"*ligjin nr.10433,datë 16.06.2011"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", nenin 7 dhe neni 16"Misioni dhe Funksionet e Inspektoratit Qendror" pika 2 germat "b" dhe "c", nenin 12, pika 1 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", neni 40 "Parimi i Këshillimit dhe informimit" dhe të Kapitulli IV pika 256 UMF nr. 2, datë 06.02.2012 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", si dhe me Kapitullin II, paragrafët 2,3 të Manualit e Inspektimeve, miratuar me Urdhrin nr. 13, datë 23.04.2015"Për Miratimin e Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë, ku mungojnë grupet të punës të EMP-së, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, për çdo vit objekt auditimi. Këto produkte janë të integruara me produktet e ministrisë nga përfaqësues të cilat janë të mbështetur në objektiva, strategji dhe plan veprimet përkatëse të çdo viti. Këto duhen mbështetur dhe në zbatimin e objektivave të programit të Qeverisë dhe strategjitë sektoriale në fushën e mjedisit që shërbejnë si shtylla orientuese, argumentuese, sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", sipas ligjit 9936, datë 21.07.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, të ndryshuar dhe udhëzimeve përkatëse si dhe të Kapitulli IV pika 256 të UMF nr.2, datë 06.02.2012 "Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit", sipas tabelës emërtuar *"Parashikimi dhe realizimi i buxhetit.*

Lidhur me çeljen, zbatimin, ndjekjen, menaxhimin e realizimit të buxhetit të miratuar në përmbushje të objektivave plan veprimi, u konstatua pamjaftueshmëri, mungesë përformance e shprehur në: mos paraqitje "Parashikim dhe realizim buxheti" për periudhën 2020-2021 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Kërkesa për fonde buxhetore paga & sigurime shoqërore për vitin 2020, ka ardhur për shkak të urdhrit nr. 23, datë 03.02.2020 të Kryeministrit " *Miratimi i strukturës dhe organikës të AKM-së*", shtesë fondi për shpenzime operative të cilat ishin të pa detajuara nga e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, për vitin 2020 kjo sipas shkresave të lart përmendura.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër edhe për vitin 2021nuk ka kërkuar fonde shtesë, *kjo vjen si pasojë e mos hartimit dhe parashikimit te buxhetit si mos paraqitje e*

kërkesave e sektorëve përkatës për buxhetin e vitit pasardhës, veprime këto në shkelje te ligjit dhe udhëzimeve të sipërcituara duke mos respektuar rritja 10% nga viti në vit pasi nuk dëshmohen dhe dokumentohen me tregues të tillë :nr. Inspektime në fushën e mjedisit dhe ujërave, shkresa etj.... me kostot përkatëse të çdo inspektimi etj.. si tregues të matshëm të çdo inspektimi etj ...pra PB nuk mbështet në plane veprime vjetore e afatmesëm dokument i cili mungon për secilin vit 2020-2021, ekzistenca e të cilit do të përbënte produktin sipas programit dhe bazën mbi të cilën do të mbështetej PB dhe PBA reale, funksionale në përmbushjen të funksioneve ligjore të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër.

Nga auditimi rezulton se: Detaj imin i buxhetit është dokumentuar në mbështetje të ligjit 9936, datë 21.07.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, sipas*"* ligji *88/2019 datë 18.12.2019 " Për buxhetin e vitit 2020", ligjin* nr. 137/2020, datë 16.11.2020 "*Për buxhetin e vitit 2021"* Detaji mi i buxhetit është bërë sipas buxhetit të miratuar shkresave të ardhura nga Ministria e Financave dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për AKM-së, brenda kufijve sipas destinacionet për të cilin janë çelur sipas programit për mjedis, titullit, kapitullit sipas artikujve dhe detaj imin i numrit të punonjësve, detaj imin i shpenzimeve buxhetore, të miratuar, sipas Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 20.01.2020 "*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020",*si dhe Udhëzimi nr. 22 datë 17.11.2016 *"Për Procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore"*, i ndryshuar sipas udhëzimeve vjetore përkatëse.–

-Gjithashtu nuk është krijuar grupi i punës të GMS-së ne kundërshtim me nenit 27, të ligjit 10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" sipas ligjit 9936, datë 21.07.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, dhe udhëzimet përkatëse për hartimin e PBA.

Zbatimi i kritereve të buxhetit

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *"Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, te ligjit nr. 88/2019 datë 18.12.2019 "*Për buxhetin e vitit 2020*"ligjin nr. 137/2020, datë 16.11.2020 **"***Për buxhetin e vitit 2021***",** të Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 9, datë 20.03.2018, "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", Udhëzimit Plotësues nr. 2 datë 20.01.2020"*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020",*si dhe Udhëzimi nr. 2 datë 17.11.2016 *"Për Procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore"*, Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, për vitin 2020-2021, ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore dhe realizimin sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Viti 2020		Viti 2021		Ne%	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	2020	2021
1	*Llog. 600"paga e shpërblime"*	18,480	13,853	29,000	28235	75%	97.4%
2	*Llog. 601"Kontribute për sig. Shoq e shëndetësore"*	3083	2316	5500	4731	75%	86%
3	*Llog.602"shp.operative"*	522	346	1000	575	66%	57.6%
	Totali	**22,085**	**16,515**	**35,500**	**33,541**	**75%**	**94.5%**

Realizimi i buxhetit viti 2020

Nga krahasimi i buxheteve për të dy vitet rezulton që fondet nga viti në vit në dispozicion të këtij institucioni kanë një rritje, po duke pas parasysh se janë bashkuar 3 institucione ka pa mjaftueshme ri të fondeve buxhetore, dukë i bërë të pamjaftueshme për realizimin e funksionit të këtij institucioni si dhe të objektivave dhe strategjive në ruajtjen e mjedisit.

- Miratimi i plan buxhetit për vitin 2020.

Për buxhetin e vitit 2020, u konstatua se nga Ministria e Mjedisit me shkresë nr. 1922 port. datë 25.09.2020 është dërguar detaj imi i shpenzimeve koherente të buxhetit për vitin 2020 dhe detaj imi i limitit mujor në zbatim të ligjit nr.160/2014, datë 27.11.2014, "Për buxhetin e vitit 2020 " i cili është miratuar nga Ministria e Financave.

Shënim ;Buxheti i ardhur në ketë date i është bashkëngjitur buxhetit të lëvruar për Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Tiranë.

Tabela e Buxhetit të realizimit të fondeve sipas natyrës së shpenzimeve për vitin 2020.

Në 000/lekë

2020	*Llogaria*			*Totali*
	600	*601*	*602*	
Planifikimi	*18,480*	*3083*	*522*	*22,085*
ÇeljangaBuxheti	*18,480*	*3083*	*522*	*22,085*
Shpenzimet	*13,853*	*2316*	*346*	*16,515*
% e realizimit	*75%*	*75%*	*66%*	***75%***

Sipas tabelës së mësipërme fondet e akorduara janë realizuar në masën 75%, me një realizim të ulët paraqiten fondet e destinuara për pagat e punonjësve të cilat rezultojnë të realizuara në masën 88%.

Fondet e çelura nga Dega e Thesarit, janë përdorur sipas destinacioneve përkatëse për të cilat nuk u konstatuan shpenzime me ndryshim artikujsh dhe tejkalim limitesh.

-Miratimi i plan buxhetit për vitin 2021.

Për buxhetin e vitit 2021, u konstatua se nga Ministria e Mjedisit me shkresë nr. 321/1 datë 26. 01. 2021është dërguar detaj imi i shpenzimeve koherente të buxhetit për vitin 2021 dhe detaj imi i limitit mujor në zbatim të ligjit nr. 147/2015, datë 15.01.2016, "Për buxhetin e vitit 2021 "

Tabela e Buxhetit të realizimit të fondeve sipas natyrës së shpenzimeve për vitin 2021. Në 000/lek

2021	*Llogaria*			*Totali*
	600	*601*	*602*	
Planifikimi	*29000*	*5500*	*1000*	*4780*
CeljangaBuxheti	*29000*	*5500*	*1000*	*4780*
Shpenzimet	*28235*	*4730*	*575*	*4004*
% e realizimit	*97.4%*	*86%*	*57.6%*	***94.5%***

Sipas tabelës së mësipërme fondet e akorduara janë realizuar në masën 94% me një realizim të ulët paraqiten fondet e destinuara për shpenzimet operative të cilat rezultojnë të realizuara në masën 57%, pasi ka ndikuar mos plotësimi me fonde për të gjithë punonjësit dhe ka mbetur i pa realizuar.

Fondet e çelura nga Dega e Thesarit, janë përdorur sipas dstinacioneve përkatëse për të cilat nuk u konstatuan shpenzime me ndryshim artikujsh dhe tejkalim limitesh.

të buxheteve nuk janë bërë ndryshime të tij si në pakësim dhe në shtesa.

Mbi bazën e të dhënave të Agjencinë Rajonale te Mjedisit Tirane, Durrës, Dibër është rakorduar me degën e thesarit të rrethit për çdo muaj, mbështetur në udhëzimet respekt ivë të Ministrisë Financave për zbatimin e buxheteve të viteve ushtrimore.

Realizimi i **shpenzimeve operative** është dokumentuar sipas nen artikujve të llogarisë nr. 602, "Shpenzime operative" paraqitet:

në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021
1	Kancelari dhe tonerë	42,880	96,508
2	Materiale për pastrim	59,814	98,724
3	Karburant dhe vajra	98,400	199,898
6	Shpenzime telefonike dhe internet	5903	-
7	Posta dhe shërbime korrieri	59,840	142,499
8	Shpenzime mirëmbajtje obj. Ndërtimore	33,300	-

9	Siguracion autom.	8,000	18,196
10	Shteti tatim taksa	15,000	19,990

Realizimi i buxhetit viti 2021,

Buxheti është realizuar në masën 94%.

Nga krahasimi i buxheteve për të dy vitet rezulton që fondet nga viti në vit në dispozicion të këtij institucioni kanë një rritje, po duke pas parasysh se janë bashkuar 3 institucione ka pa mjaftueshme ri të fondeve buxhetore, dukë i bërë të pamjaftueshme për realizimin e funksionit të këtij institucioni si dhe të objektivave dhe strategjive në ruajtjen e mjedisit.

Për periudhën objekt auditimi nuk janë planifikuar shpenzime operative në artikullin 602 dieta. Mos shpërblimi e mos llogaritja e shpenzimeve udhëtime dieta, ka ardhur nga mosparashikimi e përfshirja në zërin "Shpenzime të tjera transporti, udhëtimi e dieta për punonjësit" log 602.39 pra në PB dhe PBA e viteve 2020-2021, në kundërshtim me ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimet përkatëse.

1.1. Zbatimi i kritereve dhe procedurave të hartimit të nevojave për buxhetit afta mesëm.(PBA) 2020-2021,

U kontrollua dhe zbatimi i kritereve për shtesa dhe pakësim të fondeve buxhetore dhe rezultoi që ato janë kryer sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"dhe në zbatim të udhëzimit të përhershëm nr .2, datë 06.02.2012,"*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*" dhe udhëzimeve përkatëse vjetore.

Janë mbajtur të gjitha korrespondencat e nevojshme në Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe AKM-në, si dhe me Degën e Thesarit, për planin fillestar, ndryshimet (shtesa & peksimet) në planin përfundimtar të buxhetit në nivel grupi, titulli, kapitulli dhe artikulli, sipas stacioneve buxhetore mujore, 12-mujore dhe akt-rakordimeve për vitet 2020-2021, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Transferimet e fondeve janë bëre me miratim të nëpunësit autorizues Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe me miratim të Ministrisë së Financave. Për vitin 2020 dhe 2021, nuk ka patuar fonde për investime.

Konkluzion: Nga auditimi rezultoi se nuk janë kryer në përputhje me legjislacionin si më poshtë.

Për projekt buxhetin afatmesëm 2020-2021, procedura e hartimit janë në kundërshtim me Kap. IV, faza e parë dhe e dytë e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të Udhëzimit nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", në lidhje me respektimin e dy fazave nëpër të cilat kalon përgatitja e projekt buxhetit afatmesëm, si dhe në kundërshtim me pikën 4, shkronja "a" të Udhëzimit vjetor nr. 2 datë 20.01.2020"*Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020",*"Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020-2021". Projekt buxheti afatmesëm 2020-2021 i ARM është përgatitur dhe dërguar në AKM dhe pranë MMT në datë 01.08.2016, me shkresën 124 datë 17 .08 .2020. Përsa më sipër mbajnë përgjegjësi nëpunësi autorizues i ARM-së, z. Xh H dhe z në cilësinë e nëpunësit autorizues. Gjithashtu procesi i përgatitjes së projekt buxhetit afat mesëm 2020-2021 nuk është kryer në përputhje me përcaktimet e bëra në Kap.I II, pika 40-45 "Përgjegjësitë e Drejtuesit të Programit"; pika 46-48 "Përgjegjësitë e anëtarëve të ekipit të menaxhimit të programit", si dhe pika 49-55 "Përgjegjësitë e nëpunësit zbatues", të Udhëzimit nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm". Pra nga titullari i institucionit, z. Xh.H në rolin e drejtuesit "Programi për mbrojtjen e mjedisit", nuk është ngritur ekipi i menaxhimit të programit sipas pikës nr. 44, shkronja "a-l", të Udhëzimit të mësipërm. Nuk është ngritur urdhër nga titullari për

paraqitjen e kërkesave sipas sektorëve këto të cilat janë në kundërshtim me pikat 46-48 të Udhëzimit të mësipërm, ne lidhje me procesin e planifikimit të buxhetit, nuk janë kryer veprimet e nevojshme në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën nr. 51, 52 dhe 53, të Udhëzimit të mësipërm. Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi nëpunësi autorizues i ARM, njëkohësisht edhe në rolin e drejtuesit të programit përkatës z. Xh.H, nëpunësi zbatues i ARM z. D. B., për mos respektimin e procedurës ligjore. Si dhe O Gj. për vitin 2021, në cilësinë e Drejtorit të Komanduar.

-Nuk është ngritur i grupit i të punës të GMS-së i cili nuk është krijuar sipas nenit 27, të ligjit 10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" sipas ligjit 9936, datë 21.07.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, dhe udhëzimet përkatëse për hartimin e PBA.

Ka munguar hartimi i PB dhe PBA për ***vitin 2020*** pasi institucioni ARM Tiranë, ka filluar veprimtarinë me datë 01.07.2020, (PB/PBA bëhet në vitin 2020), nuk është hartuar buxheti PB dhe PBA, pasqyruar në tabelën emërtuar "Parashikimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën vitin 2020-2023, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"; me UMF nr. 8, datë 29.3.2012"Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së PBA", ligjit "Për Buxhetin".

c. Nuk është respektuar kriteri rritjes prej 10%,nga viti në vit pasi nuk dëshmohen dokumentohen me tregues te tillë si numri i inspektimeve etj për produktet përkatës në fushën e Mjedisit, ,me kostot përkatëse të çdo inspektimi, etj., tregues të matshëm dhe nuk mbështetet në Plan veprime vjetore e afatmesme, dokument i cili mungon për vitin 2020-2021.

d. Buxheti (PB dhe PBA) i vitit 2020 nuk mbështetet në dokumentet e hartuara me Objektivat, Strategjinë dhe plan veprimin përkatës të çdo viti, duke u mbështetur në zbatimin e Objektivave të Programit të Qeverisë dhe në strategjitë sektoriale në fushën e Mjedisit dhe Ujërave , mangësi këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", si dhe nuk kanë respektuar kriterin e rritjes, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimet përkatëse.

e. Ka munguar programimi dhe raportimi vjetor 2020-2021 (si pjesë e plan veprimit mbi të cilën do të mbështetej edhe hartimi i projekt buxheteve përkatës) i numrit të inspektimeve i cili do të mund të parashikohej programohej me njërën prej metodave, korrektuar me detyrat apo objektiva specifike të vendosura nga institucioni qendror, dhe tjetra *metoda analitike* parashikuese, për çdo proces apo produkt "mision inspektimi", pasqyruar në tabelën emërtuar "Parashikimi dhe realizimi i numrit të inspektimeve për vitin 6/mujori i dytë 2020 dhe 2021 *(në numër)";*gjendje në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", nenin 7 dhe neni 16 "Misioni dhe Funksionet e Inspektoratit Qendror" pika 2 germat "b" dhe "c" ku shprehet se:"....*Miraton rregulla të Përgjithshme bazë për metodologjinë e vlerësimit të Riskut, programimin e inspektimeve dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve-*

Për 6/mujorin e dytë te vitit 2020 dhe vitit 2021,nga ARM nuk është përgatitur raporti i monitorimit përfundimtar dhe raportet periodike të monitorimit të buxhetit, në kundërshtim me nenin 65, Kreu VIII të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; me Kreun VI, pika 270, të Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit"; me Kreun IV, pika 89 të Udhëzimit nr.2, datë 19.1.2018 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018"; me nenin 11 dhe 12, të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ndryshuar;

si dhe me pikat 19-29, Kap. III, të Udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore".

1. **Titulli i gjetjes:**Mungon analiza e Planifikimi buxhetore afat mesëm 2020-2022,

Situata: Në kërkesat për fonde që ka përgatitur ARM, gjatë periudhës së përgatitjes së projekt-buxhetit, u vu re se mungonte një analizë ekonomiko financiare, nuk detajoheshin kostot për çdo aktivitet që do të kryhej gjatë vitit.
planifikimi i zërave/artikujve të buxhetit kryesisht të artikullit 602"shpenzimet operative"; nuk shoqërohen me tregues statistikor të matshëm, që do të realizohen gjatë vitit, për buxhetet e vitit 2020-2022 për sektorët që kryejnë inspektime në fushën e mjediset dhe ujërave, që të justifikojë kërkesën në rritje për fonde buxhetore nga viti në vit.
Kriteri: Udhëzimit nr. 8, datë 29.03.2012 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm",
Ndikimi/efekti: Nuk është parashikuar sakët plani buxhetore për shpenzimet e njësisë .
Shkaku: Mos plotësim i strukturave dhe ndarje detyrash sipas grupeve.
Rëndësia: E mesme
Rekomandimi;Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë Durrës Dibër të marrë masa për zbatimin e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të planifikojnë në buxhet ne artikullin 602 (dieta karburant) në lidhje me respektimin e dy fazave nëpër të cilat kalon përgatitja e projekt buxhetit afatmesëm, si dhe udhëzimeve te nxjerra nga Ministri e Financave në çdo vite buxhetore.
Afati: Në vazhdimësi
2. Titulli gjetjes: Mungon Grupi i menaxhimit 2020-2022,
Situata: Programimi i PBA 2020-2022,nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit (GMS),nuk është krijuar sipas nenit 27, të ligjit 10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" sipas ligjit 9936, datë 21.07.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, dhe udhëzimet përkatëse për hartimin e PBA.
-Nuk është miratuar Drejtori i ARM –së , kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor brenda datës 31 Dhjetor 2020.
-Nuk është respektuar kriteri rritjes prej 10%,nga viti në vit pasi nuk dëshmohen dokumentohen me tregues te tillë si numri i inspektimeve etj për produktet përkatës në fushën e Mjedisit, ,me kostot përkatëse të çdo inspektimi, etj., tregues të matshëm dhe nuk mbështetet në Plan veprime vjetore e afatmesme, dokument i cili mungon për vitin 2020-2021.
Kriteri:ligji 10296 datë 08.07.2010 ''Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit", me UMF nr. 8, datë 29.3.2012"Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së PBA", ligjit "Për Buxhetin".
Ndikimi/efekti: Nuk janë parashikuar fonde sipas nr.të inspektimeve në log 602(Dieta karburant) për gjithë periudhën.
Shkaku: Si pasoje e strukturës të pa plotësuar dhe organizimit të ri të ARM-së.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandimi; Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë Durrës Dibër. Të marrë masa dhe të ngre grupin e Menaxhimit si dhe zbatimin e kalendarit të programimit të buxhetit sipas afateve ligjore.
Afati: Në vazhdimësi
3.Titulli gjetjes: Nuk është përgatitur raporti i monitorimit përfundimtar dhe raportet periodike të monitorimit të buxheti.
Situata:Nuk janë hartuar raportet monitorimit, Buxheti (PB dhe PBA) i vitit 2020 -2021 në kundërshtim me: a) nenin 65, Kreu VIII të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, b) pikën 256 të

Udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", c) Kreun IV, pika 89 të Udhëzimit nr. 8, datë 13.1.2017 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2017", nenin 11 dhe 12, të Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar; Raportet e monitorimit në mënyrë periodike të realizimit të buxhetit është detyrim për informimin e herëpashershëm mbi ecurinë e buxhetit vjetor. Ato paraqesin performancën e produkteve të buxhetit të vitit të ushtruar, duke identifikuar: Arritjet në terma sasiorë dhe vlerë të produkteve të realizuara

Kriteri: Udhëzimit nr.2, datë 6.2.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit",

Ndikimi/efekti: Nuk paraqesin përformancën e produkteve të buxhetit të vitit të ushtruar, duke identifikuar, arritjet në terma sasiorë dhe vlerë të produkteve të realizuara.

Shkaku: Mos plotësim i strukturës të pa plotësuar dhe organizimit të ri të ARM-së.

Rëndësia: E Mesme

Rekomandimi; Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë Durrës Dibër. Të marre masa për te përgatitur raportin e monitorimit përfundimtar dhe raportet periodike të monitorimit të buxhetit, a)sipas nenit 65, Kreu VIII të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

Afati: Në vazhdimësi

-Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi z. Xh.H ish/Drejtor,i komanduar, z. O.Gj.ish /Drejtor i Komanduar dhe z. D. B. specialisti i financës.

Pika2. për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e aseteve dhe aktiveve dhe mbajtja e kontabilitetit.

Nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër nuk është bërë punë e mjaftueshme në lidhje me procedurat për kalimin në përgjegjësi në administrimin e godinave, automjeteve, inventarin ekonomik dhe dorëzimin e dokumentacionit arkivor për praktikat e vendimeve administrative për gjobat, të shoqëruara me proces verbal dhe inventarizim dosjesh për çdo subjekt kundërvajtës mbetet i pa zbatuar, për ish-ISHMPUT-në, Durrës dhe dorëzimin në Agjencinë Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër e cila nuk ka arritur që të ketë një efektivitet të kënaqshëm në zbatim të urdhrave të dala nga MTM.

Këto mangësi kanë ardhur si pasojë e mungesës së nxjerrjes së përgjegjësisë për ushtrimin e detyrave të përcaktuara personave përgjegjës nga strukturat e ish-ISHMPUT-së Durrës, për shkak të mungesës së bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër në zbatim të urdhrave si më poshtë të dala nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.

Në zbatim të urdhrave të dala nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit Urdhër Nr.54, datë 24.02.2020, nr/ prot 1908 **"** Për kalimin në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve, inventarin ekonomik të ISHMPUT Qendër dhe Degëve Rajonale të saj, tek institucionet e tjera të varësisë së MTM" dhe Urdhër Nr. 218, datë 03.08.2020, nr/prot 5547, i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit "Mbi dorëzimin e dokumentacionit arkivor të ISHMP-së Qendër dhe Degëve Rajonale të saj, tek AKM-ja, si dhe dorëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit të punonjësve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore".

Përmbushja e detyrave mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe zbatimi i urdhër vetë Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, mbeten të pa zbatuar në drejtim të marrjes në dorëzim për Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër dhe dorëzuesi ish-ISHMPUT-ja Durrës: të procedurave për kalimin në përgjegjësi në administrimin e godinave, automjeteve, inventarin ekonomik/ imët, për strukturat përgjegjëse të financave dhe shërbimeve mbështetëse në ISHMUT-të Qendër/Degët Rajonale, AKM/DRM, AKZM/AdZM, AKB dhe AKP si dhe dorëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit të punonjësve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore".

Zbatimi i procedurave të lëvizjes së dokumentacionit - teknik nga Dega Rajonale, te ish-ISHMPUT-së Durrës, në Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër për zbatimin e VKM-së, nr. 568,datë 17.07.2019 "Për krijimin ,mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit "dhe urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 218, datë 03.08.2020, nr/ prot 5547,ky dokumentacion duhej të shoqërohej me praktikat e vendimeve administrative për gjobat, të shoqëruara me proces verbal dhe inventarizim dosjesh për çdo subjekt kundërvajtës mbetet i pa zbatuar, për ish-ISHMPUT-në Durrës dhe dorëzimin me proces-verbal nga grupi i punës në Agjencinë Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër.

- *Administrimi vlerave monetaren bankë,*

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacion, fletëhyrje, lis pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me kon fermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin.

Të ardhurat dhe shpenzimet i përkasin periudhës raportuese, të rakorduar këto me Degën e Thesarit. Llogaria e disponibiliteteve në Thesar është e barabartë me rezultatin e ushtrimit e rakorduar me Degën e Thesarit. Dokumentacioni bazë që pasqyron veprimet e kryera me bankë e magazinë është pasqyruar në ditarët përkatës, ku veprimet janë kryer me bankë, magazinë dhe me listë-pagesa. Për periudhën e audituar për vitet 2015, 2016 dhe 2017, rezultoi se Kontabilizimi i veprimeve është bërë në llogaritë që përcakton plani kontabël sipas klasifikimit buxhetor.

Konkluzion:-Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur nga struktura që mbulon kontabilitetin në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, rezulton se veprimtaria lidhur me mbajtjen dhe evidentimin e aktiveve nuk është në përputhje kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe në zbatim të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011," Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", të Ministrit të Financave, sipas pikës 26 dhe 30, kreu III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", rezultuan se: nuk është hartuar regjistër për evidentimin e aktiveve dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre nga Agjencia Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër.Nga mos mbajtja e ditarëve të magazinës këto veprime janë pasqyruar në bilancet nga vlera te mbetur ne funde të vitit sipas hyrje dhe daljeve për vitet 20120-2021 dhe si rezultat nuk është kryer kontabilizimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, pra nuk janë mbajtur kartelat dyfishe sipas udhëzimit nr. 30. date 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" .Si pasojë e këtyre mosveprimeve, nuk është kryer kundrimi midis specialistes së financës dhe magazinës, në mënyrë që të saktësohet gjendja në fund të vitit .

-*Nga auditimi mbi* verifikimin e marrjes së dokumentacioneve financiarë dhe regjistrimet kontabël të kryera nga ARM Tiranë si dhe në Njësitë vartëse, rezulton se; Sektor i Financës, regjistrimet e veprimeve kontabël, kryhen me program excel dhe jo me "Bartës informatika", të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë. Veprimet e kryera në këtë mënyrë ndikojnë në mos besueshmërinë dhe riskun që bartin në vetvete këto programe duke qenë të ndryshueshme në çdo kohë, të cilat gjithashtu ndikojnë në pasaktësi të veprimeve kontabël e rrjedhimisht në rezultate jo korrekt. Kjo gjë çon dhe në mos

kundrim të drejtë dhe të saktë si dhe vonesa në kohë për gjetjen, korrektimin dhe sistemimin e gabimeve matematikore. Mungesa e programimit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabël dhe të pasqyrave financiare. Veprime këto në mospërputhje me ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 11.

- *Administrimi vlerave materiale, magazinimi dhe qarkullimi i tyre*

Ky institucion nuk ka AQT të patundshme si ndërtesa e as AQT të lëvizshme në vlerë të pasqyruara në kontabilitet, pasi administrata është në godinë me disa Institucione tj... që në këtë mënyrë nuk janë as pjesë e inventarit të ARM Tirane Durrës Dibër.

Gjatë auditimit rezulton se veprimet ekonomike që rrjedhin nga lëvizja e mallrave, materialeve dhe pasurisë së Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër nëpërmjet magazinës, nuk shoqërohen me dokumentacionin e nevojshëm bazë si dhe me dokumentet shoqërues dhe vërtetues si: urdhër, autorizime, urdhër dorëzimi, fletë kërkesë, plan shpërndarje dhe kartela shoqëruese proces-verbale (pjesërisht) që vërtetojnë qëllimin e lëvizjes si për hyrjet ashtu edhe për daljet e aseteve. Nga auditimi rezulton se hyrjet janë bërë mbi bazën e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuar, nga ku janë bërë kontrollet e nevojshme për sasinë, cilësinë, llojin dhe plotësimin e tyre. Për veprimet në magazinë daljet ishin të paplotësuar me plan-shpërndarje, urdhër dorëzimi, pa nënshkrimin e nëpunësit zbatues për Agjencia Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër dhe në pasqyrimin e aseteve në librat e magazinës mungonte libri i "*mjete kryesore"* për të vërtetur saktësinë, plotësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efecientë të tyre. Për evidentimin e aktiveve dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, nuk është hartuar regjistri për evidentimin e aktiveve dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre.

Nga auditimi rezulton se janë zbatuar pjesërisht kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe udhëzimi nr.30, datë.27.12.2011,të Ministrit Financave lidhur me administrimin e vlerave materiale.

Konkluzion:-Gjatë auditimit mbi pasqyrimin e aseteve në librat e magazinës si "*mjete kryesore*" kjo pasuri e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, nuk është riregjistruara në librin e magazinës si "*mjete kryesore* ".Inventari ekonomik është në ngarkim të punonjësve me kartela dhe dalje sipas kartelave, janë të firmosura vetëm nga personat përgjegjës, por këto veprime duhet të kryhen për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me efecientë të tyre.

Nga auditimi i veprimeve lidhur me daljet nga magazina rezulton se jo në çdo rast janë të shoqëruar me dokumentacion urdhër listë shpërndarje etj.. si pasoje e këtyre veprimeve, nuk janë zbatuar dispozitat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar dhe udhëzimi nr. 30, datë. 27.12.2011 i ndryshuar i Ministrit Financave.

Nga auditimi rezulton se nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe udhëzimi nr. 30, datë. 27.12.2011,të Ministrit Financave lidhur me administrimin e vlerave materiale sipas pikës 55-60.

-Në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë,Durrës, Dibër, specialisti i financës të bashkëpunojë me punonjësin e magazinës për çeljen e librave të magazinës etj...., sipas udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011,"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik sipas pikës 55-60.

Nga ARM Tiranë, Durrës, Dibër,të merën masa dhe të parashikohen në buxhetin e vitit 2023, pagesa e taksave dhe kolaudimin për 5 mjetet duke përfshirë që në momentin e marrjes në dorëzim .

4. Titulli i gjetjes; Nuk ishin hapur kartela përkatëse llogarisë 215 "Mjete transporti "ku të jenë firmosur nga personat që i kanë në përdorim.

-Nuk është hartuar regjistër për evidentimin e aktiveve dhe dokumentimin e lëvizjes së tyre nuk janë mbajtja e ditarëve të magazinës këto veprime janë pasqyruar në bilancet nga vlera të mbetura në funde të vitit sipas hyrje dhe daljeve dhe si rezultat nuk është kryer Kontabilizimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve.

-magazina, jo në çdo raste shoqërohej me dokumentacionin e nevojshëm, me dokumentat shoqërues dhe vërtetues si:, fletë kërkesë, apo plan shpërndarje ,

Situata: Mungon regjistër themeltare veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik' gjithashtu dhe plotësimi i dokumentacionit të magazinë nuk është në përputhje me udhëzimin e sipërcituar.

Kriteri: Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" Udhëzimin nr. 30 date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publik'.

Ndikimi/efekti: Nuk ka kartela për saktësimin e gjendjes së mjeteve të transportit në institucion, si dhe lëvizja e mallrave nga magazina jo në të gjitha rastet me dokumentacion shoqërues.

Shkaku; Riorganizimi i institucionit dhe mos pasje e burimeve njerëzorë për kryerjen e veprimeve.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Agjencia Rajonale e Mjediset Tiranë Durrës Dibër, të marre masa dhe të kalojë në kartela për çdo përdorues të mjetit, i cili duhet të jetë përgjegjës për çdo lëvizje që kryen mjeti,si dhe lëvizje e mallrave nga magazina të bëhet më dokumentacion shoqërues bashkëngjitur.

Afati: Në vazhdimësi

***Observacion*:** *datë 08.04.2022, nga specialistja znj. M S me prot.,155/3 datë 08.04.2022, prot.. në KLSH, në lidhje me pikën nr. 2, bashkëlidhur gjendet dokumentacioni shoqërues me urdhrat e lëvizjes autorizimet dhe dokumentacion vërtetues.*

Grupi i auditimit: *pasi shqyrtoi dokumentacionin mori në konsideratë dhe u reflektuan në projekt raport .*

Pika 2.1. Pasqyrat Financiare dhe plotësimimi i formularëve të bilancit anekseve dhe udhëzimet e dala nga Ministria e Financave.

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit sipas Planit Kontabël të miratuar për institucionet. Nxjerrjepasqyravefinanciarenëafat,plotësimiiformularëvetëbilancitdheianeksevepërkatëssipas udhëzime vetë nxjerra nga Ministria e Financavepër këtë qëllim.

Në bazë të programit të auditimit nr.155/1 datë 14.02.2022., pika 2 "Auditim financiar dhe përputhshmërisë", për periudhën 01.07.2020 deri me datë 31.12.2021" u shqyrtua dhe u verifikua dokumentacioni i vënën dispozicion, i Pasqyrave Financiare, ditari të bankës, ditarët e shpenzimeve korrente progresive vjetore, zbatimi i buxhetit për vitet në auditim *6/mujorin e dytë 2020 deri me datë 31.12.2021* të plotësuara nga Agjencia Rajonale e mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër në zbatim të ligjit për Kontabilitetin e Pasqyrat Financiare nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Udhëzimit nr.37, datë 19.12.2006, Udhëzimit nr.26, datë 27.12.2007, dhe Udhëzimit nr.10, datë 27.02.2008, "Përpërgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, vendore dhe njësitë që varen prej tyre" dhe Ligjitnr. 10296, datë 8.7 2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe

Kontrollin" dhe udhëzimitë MF nr. 30, datë27.12.2011" Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Mbas shqyrtimit të dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se :

Agjencia Rajonale e mjedisit Tiranë ,Durrës,Dibër ka kryer veprimtarinë e sajpër 6/mujorin e dytë 2020 deri me datë 31.12.2020 dhe Pasqyrat Financiare rezultojnë të përgatitura nga Specialisti i Financës D.B dhe miratuar nga Drejtori ARM–se, z. Xh.H,*dokument* I vulosur dhe nënshkruar nga Dega e Thesarit Tiranë.

- Për auditimin e kësaj pike sipas drejtimeve të përcaktuara në programinnr. 155/1prot. datë 14.02.2022 e protokolluar në AKM me nr.155/1datë 15.02.2022,në pikën3, u mbështetëm në kriteret ligjor e si mëposhtëm:

Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 *"Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"*
-Ligji nr. 40/2019 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK 2"Paraqitja e Pasqyrave Financiare"), të përcaktuara në Ligjin nr. 25/, datë 03.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
Ligji nr. 10296, datë 8.7 2010 *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".*
Udhëzimi MF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*
Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, *"Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë"*
-UMF nr. 8, datë 09.03.2018 *"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".*

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vite2020 -2021,japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, përfomancës financiare, aktiveve neto dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (i shfuqizuar),ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme", u analizuan pasqyrat financiare të 6/mujorit të dytë 2020 dhe pasqyra e shpenzimeve deri më datë 31.12.2020, nga ku rezultoi:

Pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe vitit 2021 ishin hartuar vetëm bazuar në Ditarin e Bankës dhe shumë veprime si dhe nxjerrja e pasqyrave financiare bëhej nga jashtë (extra kontabël).

Përveç artikujve të magazinës, për të gjithë postet e tjera të pasqyrave financiare, ishin përgatitur inventarët dhe analizat sipas këtyre posteve, sipas ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15, si dhe në përputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".

Kontabilizimi i llogarisë 603 në debi, nuk bëhej për çdo fletë dalje, por kryhej vetëm një herë në muaj, në mënyrë të përmbledhur.

Sa sipër është në mospërputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".

Pjesë e pasqyrës financiare të vitit 2020, janë edhe Akt akordimet me Degën e Thesarit, inventarët etj, pasqyrat F1, F2, F4, F7,F5 etj.

Mbasi u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion bazuar në Kriteret e vlerësimi në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"**,** Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, UMF nr. 8, datë

09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme",UMF nr. 30, datë 27.12.2012"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", rezultoi:
AKM Tiranë, ka përgatitur dhe raportuar Pasqyrat Financiare të vitit 2020, mbështetur në Ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".
Pjesë përbërëse të PF/2020 janë: Pasqyra e pozicionit financiar (F1); Pasqyra e përfomancës financiare (F2); Pasqyra e flukseve monetare (F3); Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4); Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);
Pasqyrat statistikore: Investimet dhe burimi i financimit (F6); Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7 .a);Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b); Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8); Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të UMF nr. 8, datë 09.03.2018, ku është dhënë informacion mbi:

Nga auditimi i Pasqyrave financiare rezultoi:

Pasqyrat Financiare të vitit 2020, rezultojnë në përgjithësi jenë të plotësuara sipas standardeve kombëtare të kontabilitetit, planit kontabël dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, në Njësitë e Qeverisjes se Përgjithshme" Pasqyrat financiare vjetore 2020 janë dorëzuar në Degën e Thesarit me datë 24.03.2021, me nr. 736 prot, me të dhënat e mëposhtme:
Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionet dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordomi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- *Nxjerrja e bilancit financiar është bazuar në azhurnimin e plotë të veprimeve financiare si dhe akordimin e llogarive sintetike e analitike, dhe jo ekstra kontabël.*

Për shpenzimet (ditari i bankës), të ardhurat, pagat, magazina, veprimet e ndryshme dhe centralizatori,artikujt kontabël janë mbështetur në dokumentacionin bazë urdhër shpenzime, fletëhyrje dhe fletë dalje, listë-pagesa dhe në mënyrë periodike dhe progresive është bërë përmbledhja e llogarisë.
Gjendjet e llogarive të paraqitura në pasqyrat financiare të vitit 2015-2016-2017 janë si më poshtë vijon:

Në Aktivin i bilancit *në fund të viteve ushtrimore paraqiten:*

Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara: *Në/ lekë*

Nr.	AKTIVI	Viti 2020
1	**Aktivet të qëndrueshme të trupëzuara (AQT)**	**7,310,557**
-	Ndërtime e konstruksione	-
-	Instalime teknike, makineri pajisje e vegla pune	4,453,021
-	Mjete transporti	2,857,536
-	Inventari ekonomik	301,542
-	Amortizimi	124,47,326

Gjendje te llogarive të AQT nuk kanë ndryshim pasi nuk ka shtesa sepse nuk ka pasur investime dhe nuk ka patuar pakësimi sepse nuk ka nxjerrje jashtë përdorimit.

- Në **Aktiv të bilancit** Gjendja e llog 4342 "*Të tjera operacione me shtetin (debitor)*", paraqitet për vitin 2020 në vlerën 301,542 lekë, ne çelje Këto gjendje përfaqësojnë "*detyrimet afatshkurtër"* të ARM tiarën Durrës Dibër detyrime të lindura në muajin Dhjetore që likuidohen ne janar vitit pasardhës punonjësve dhe të tretëve si shumë e llogarive në pasiv të bilancit përkatësisht të llog. 421"Paga e shpërblime",

llog 431 "Tatim mbi pagë", llog. 435 "Sig. shoqërore", llog 46 "Sig. Shëndetësore". Gjendja e llog. 468 "Debitorë të ndryshëm" është ***2,605,234 lekë*** .

Aktive Qarkulluese *Në/lekë*

NR.	AKTIVI	Viti 2020
2	**Aktive qarkulluese**	**301,542**
Klasa 3	I. Gjendja e Inventarit (llog.31)	*301,542*
31	Materiale	
32	Objekte inventari	
Klasa 4	Kërkesa arkëtimi mbi debitorët	
409	Furnitor (Debitorë), parapagim	
468	Debitorë të ndryshëm	
4342	Të tjera operacione me shtetin	260,5234
	Totali i Aktivit	**2,906,776**

PASIVET (DETYRIMET) e Pasqyrave Financiare vjetore evidentohet në **vlerën 2,906,776 lekë** e kundruar me aktivin Pasqyrave Financiare vjetore të njëjtën vlerë dhe përfaqëson:

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Perfomancës Financiare (formati 2), janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e ARM -së më 31.12.2020, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2020, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Në /lekë

	Pasivi i Bilancit	Viti 2020
1	*Fonde të veta*	***301542***
-	Fondet bazë	*301542*
-	Grande të brendshme kapitale	
2	*Detyrimet afatshkurtra*	***2,605,234***
401-408	Furnitorë	*7,301*
421	Personeli detyrime	*1832146*
431	Detyrime ndaj shtetit(tatim paga)	*129082*
435	Sigurime shoqërore	*542599*
436	Sigurime Shëndetësorë	75442
467	Kreditore te ndryshëm	25965
3	Llogari të tjera	
4	Rezultati i ushtrimit	
	Totali Pasivit	**2,906,776**

Llogaria 42,"Detyrime ndaj personelit" evidentohet në një **vlerë** 1,832,146**lekë,** që përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t'u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431, "Detyrime ndaj shteti për tatim taksa" evidentohet në një **vlerë prej** *129082* **lekë** që përfaqëson detyrime për tu paguar nga subjektit ndaj shtetit tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llogaria 435, "Sigurime shoqërore" evidentohet në **vlerën *542599* lekë** dhe paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të cilat paguhen në vitin e ardhshëm në Janar.

Llogaria 436, "Sigurime shëndetësore "evidentohet në **vlerë** 75442lekë dhe paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shëndetësore për pagat e muajit dhjetor të cilat paguhen në vitin e ardhshëm në Janar.

Llogaria 467 "Kreditore të ndryshëm" në fund të **vitit 2020** evidentohet në vlerën **25965 lekë** dhe përfaqëson detyrime ndaj kreditore , të cilat janë mbartur prej vitit 2020.

Llogaria 4341 "Operacione me shtetin detyrime" në fund të **vitit 2020** evidentohet në vlerën 2,605,234 **,**përfaqëson detyrimet e debitorëve nga vitet e kaluara. SIPAS TABELS SIPER CITUAR SIPAS ZËRAVE

Në formatin 4, pasqyra mbi burimet e shpenzimeve dhe investimet, paraqitet në vlerën 0 lekë për te reja vitet 2015 – 2016 - 2017 sepse nuk ka investime.

Në formatin 7/a, në pasqyrën e amortizimit janë paraqitur gjendjet e rezultuara nga llogaritja vjetore e amortizimit për inventarin e ekonomik për të cilat ishin zbatuar përqindjet e llogaritjes së amortizimit të miratuara për këtë aktive, të cilat janë sipas viteve në vlerën: 12,447,326 lekë për vitin 2020,
Kosto historike 19,451,144 lekë ,
Amortizimi 12,447,326,
vlera neto Aset të pasqyruara ne aktiv neto 7,310,557 lekë, në Aktiv te bilancit ,

Pasqyra e Perfomancës financiare (F2)

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Perfomancës Financiare të ARM më datë 31.12.2020 janë të rakorduarme Degën e Thesarit, konkretisht:

Llog.		Viti 2018
-1	***V- Granatë Kornetë***	***22,085,873***
2	***PAGESA PËR DETYRIME DHE SHPENZIME KORENTE***	***16,515,764***
	Për detyrimet e vit	*-16,515,764*
3	Për diference fondet e lira (te pice fondi të pa përdorura)	5,570,109

Vlera 16,515,764 e rakorduar me degën e thesarit ne vitit 2020,
Të ardhurat dhe shpenzimet i përkasin periudhës raportuese, të rakorduar këto me Degën e Thesarit.
Rubrika 7/a Gjendje dhe ndryshime e aktiveve afat gjata(kosto historike),
a-Në pasqyrën ndryshime 7/në çelje të aktiveve në vlerë 336,699 lekë, trashëguar nga DRM
b-Hyrje Grande të brendshëm me vlerë 19,451,144 lekë,
Inventarë **8,394,273 lekë,**
Mjete transporti 11,101,871lekë ,me gjendje në funde të vitit **19,787,843lekë**
a-Pasqyra e akumulimit ndër vite,
në vlerë 12,477,326 lekë ,totale grupuar sipas viteve
b-Kosto Neto 7,310,557 lekë, përbërë nga :
a-Inventari ekonomik 4,453,021 lekë, instalime makineri etj...
b -2,875,536 lekë mjete transporti ,
Grupi i auditimi nuk shprehet dot për pasqyrat financiare 2021, pasi bilanci mbyllet jashtë periudhës auditimit . Bilanci është në procedure mbyllje .
Opinion: Grupi i auditimit në lidhje me informacionin kontabël të paraqitur në pasqyrat financiare shpreh rezerva për vitin 2020, pasi nuk është kryer bilanci i konsoliduar për dy ARM-të, Durrës dhe Dibër, por veprimet në bilance janë kryer duke u bazuar në procesverbalet e marrjes në dorëzim nga grupet e punës të ngritura me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM-së Tiranë.
6-Titulli gjetjes: Nga ARM nuk është kryer bilanci I konsoliduar për dy ARM –të Durrës dhe Dibër , në mënyrë që të kemi një pasqyrim të saktë të veprimeve .
Situata: Nuk është hartuar bilanci i konsoliduar pas bashkimit të institucioneve për dy ARM –të**.**
Kriteri: Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, në Njësitë e Qeverisjes se Përgjithshme" .
Ndikimi/efekti: Nuk kemi një pasqyrim të saktë të pasqyrave financiare,
Shkaku: Nuk janë dorëzuar bilancet nga Drejtorit përkatëse.
Rëndësia: E lartë
Rekomandimi: Të merren masa nga Drejtori i ARM-ë Tiranë, në bashkëpunim me specialistin e sektorit të financës, për të bërë të mundur hartimin e bilancit të konsoliduar në mënyrë që të paraqiten saktë veprimet në pasqyrat financiare, pasi vetëm me marrjen në

dorëzim të inventarëve nëpërmes pv nuk mundë të paraqitet një situata reale nëse ka diferenca midis marrjes në dorëzim dhe pf.

Afati: Në vazhdimësi

7-Titulli i gjetjes; Nuk ishin hapur kartela përkatëse llogarisë 215 "Mjete transporti" ku të jenë firmosur nga personat që i kanë në përdorim, marrja në dorëzim vetëm me proces-verbale.

Situata: Nuk ka regjistër themeltare veprime në kundërshtim me udhëzimin nr.30 date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik'.

Kriteri: udhëzimin nr. 30 date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik'.

Ndikimi/efekti: nuk ka një gjendje reale mbi gjendjen e mjeteve në përdorim.

Shkaku; Mos pasje e një specialisti të fushës në komisione inxhinier për marrjen e mjeteve sipas gjendjes së punës.

Rëndësia; E lartë

Pika 2.2. -Inventarizimi i pronës shtetërore, paraqitja e sakatë në pasqyrat financiare

Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, është kryer inventarizimi i aktiveve të institucionet. Për 2020-2021 kanë dalë urdhrat e brendshëm "Për krijimin e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale dhe fillimin e procedurës së inventarizimit". Gjatë kryerjes së inventarit komisioni ka mbajtur procesverbalet përkatës sipas objekteve të inventarit dhe njëkohësisht nuk ka konstatuar artikuj të ndryshme në gjendje të papërdorshme për efekt të konsumit fizik e moral të tyre.

-Inventarët e fundit të vitit, krahasimi me nxjerrjen e llogarive përkatëse në bilanc.

Gjatë auditimit të procedurave lidhur me inventarizimin e aktiveve në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër. për periudhën objekt auditimi, rezulton se në fund të vitit objekt auditimi, ka marrë masat e nevojshme për të realizuar inventarizimin e pasurisë në përputhje kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", dhe në zbatim të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, " Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", të Ministrit të Financave.

Nga auditimi rezulton se: për vitin 2020, është miratuar Komisioni "Për kryerjen e inventarit të aktiveve dhe administrimin nga punonjësit e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër." sipas urdhrit nr.33,datë 2412.2020, komisioni i ngritur ka kryer inventarizimin e pasurisë dhe ka hartuar proces-verbali përmbledhës me nr/ prot. 9/1, datë 28.12.2020, i cili ka kryer inventarizimin e pasurisë në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër. Ky komision duhej të hartonte "*Raportin e inventarizimit fizik të aktiveve dhe materialeve të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër për vitin 2020*", lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues.

Gjatë auditimit për kryerjen e inventarizimin e pasurisë së Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër nuk është në përputhje kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010"*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe në zbatim të udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011, "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", kap.IV. Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve. " *Inventarizimi i aktiveve*" të Ministrit të Financave, pika 85, germa c, pika 87.

Vlerësimi i procedurës së lëvizjes së mallrave,justifikimi me dokumentacion:nga 31.12.2019 deri 31.12021.

Gjatë auditimit rezulton se veprimet ekonomike që rrjedhin nga lëvizja e mallrave, materialeve dhe pasurisë së ish-ISHMPUT-në Tiranë, nëpërmjet magazinës, sipas Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit Nr. 54, datë 24.02.2020, nr/prot 1908, " Për kalimin në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve, inventarin ekonomik të ISHMPUT Qendër dhe Degëve Rajonale të saj, tek Institucionet e tjera të varësisë së MTM".

Komisioni i ngritur nga Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër me urdhrin e brendshëm nr.72, datë 30.06.2020 " Për marrjen në dorëzim të automjeteve dhe inventarëve ekonomik të Ish- ISHMPUT-ve Tiranë, Durrës dhe Dibër, ky komision i ngritur ka kryer inventarizimin/transferimin për marrjen në dorëzim, me anë të proces-verbaleve si më poshtë:

Proces-verbali datë	Nr/prot..datë	ish-ISHMP	DRM	Vlera/lekë
03.07.2020	1 datë 07.07.2020	Tiranë		**12,331,763**
03.06.2020	1/1 datë 07.06.2020	Tiranë		**336,699**
07.07.2020	1/1 datë 07.07.2020	Qendër/Tiranë		**3,037,950**
07.07.2020	1/1 datë 07.07.2020	Dibër		**2,594,064**
		Durrës		**0**
07.06.2020	1/1 datë 07.06.2020		Durrës	**776,408**
07.06.2020	1/1 datë 07.06.2020		Dibër	**710,959**
Totali				**19,787,843**

Referuar sipas VKM-së nr. 568, datë 17.07.2019 " Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" dhe Urdhrit nr. 23, të Kryeministrit, datë 03.02.2020 " Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së", me ndryshimin e strukturës dhe organikës të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit një pjesë e aseteve do të kalonin në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve, inventarin ekonomik të ISHMPUT Qendër dhe Degëve Rajonale të saj, tek Institucionet e tjera të varësisë së MTM", sipas Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit Nr. 54, datë 24.02.2020, nr/prot 1908.

Nga auditimi mbi zbatimin urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, është kryer procedura për marrjen në dorëzim nga komisionet dhe janë nënshkruar nga të dy palët dhe për çdo proces verbal me nr/prot.. sipas tabelës lartë përmendur, për këto janë kryer veprimet në magazinë, për të cilat janë hartuar daljet dhe hyrjet, në sasi dhe vlera përkatëse.

1- *Me urdhrin datë 24.082020, të Ministrit të Mjedisit dhe Turizmit me lëndë kalimin në përgjegjësi të Administrimit të Godinave , automjeteve dhe Inventarin ekonomik të ISHMPUT dhe Degëve Rajonale te saj tek institucionet tjera te saj të vrasisë së MTM* **,**

Në pikën 4 të urdhrit të Ministrit, për kalimin në përgjegjësi të administrimit të Godinave , automjeteve dhe inventarin ekonomiket degëve Rajonale te ISHMPUT tek Drejtoritë rajonale ARM të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, janë ngarkuar drejtorit e përgjithshme dhe të shërbimeve .

2- Me urdhrin nr. 218 datë 03.08.2020,të ngritura nga MTM, marrjen në dorëzim të dokumenteve arkivore nga DRISH MPUT, Tiranë Durrës, Dibër, pranë ARM Tiranë Durrës Dibër.

3-Me urdhrin nr. 71 datë 30.06.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM –së, për marrjen në dorëzim, në bazë të planimetrisë së vendosjes së zyrave për ARM, të bëjë sistemimin e bazës materiale inventarin e imte ekonomik, pajisjet kompjuterike , materiale shkresore e etj...

Për DRM Durrës komisioni i përbërë nga ARM Tiarën,

-A.I, -Xh.H, -D.b,M.A

Për ARM Durrës-Behare Hasrama-Shpresa Zela

-Lela Dalipi punonjësi i ngarkuar për veprime magazine,

4- **Me urdhrin nr. 71/1 datë** 30.06.2020 , te Drejtorit të Përgjithshëm të AKM –së, për marrjen në dorëzim, në bazë të planimetrisë së vendosjes së zyrave për ARM , të bëjë sistemimin e bazës materiale inventarin e imte ekonomik, pajisjet kompjuterike , materiale shkresore e etj... Për DRM Dibër,

Për DRM Durrës komisioni i përbëre nga ARM Tiranë -Xhevdet Haxhiuaj, -D.b,-M.A-Artur Isaku,

Për DRM Dibër -Sh S. -XH.b- F.M, punonjësi i ngarkuar për veprime magazine

5- **Me urdhrin nr. 72 datë** 30.06.2020 , te Drejtorit të Përgjithshëm të AKM –së, për marrjen në dorëzim, në bazë të planimetrisë së vendosjes së zyrave për ARM , të bëjë sistemimin e bazës materiale inventarin e imte ekonomik, pajisjet kompjuterike , materiale shkresore e etj...Për Inspektoratin Tiranë ,

Për DRM Durrës komisioni i përbere nga ARM Tiranë -Xh.H, -D.b

M.A-A I,

- ***Për ARM Dibër*** -M.T-E. D

Konstatimi: nuk është zbatuar urdhrin i Ministrit për marrjen në dorëzimi të Godinave pasi në urdhrin e DP është për inventarë ekonomik mjete transporti etj..

Me urdhrin nr. 33,datë 24.12.2020,është ngritur komisioni për inventarizimit.

Nga auditimi i kryer rezultoi se :

Gjatë auditimit mbi zbatimin e urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, janë zbatuar nga

-Ish-ISHMP-ja Qendër/ Tiranë;
-Ish-ISHMP-ja Tiranë;
-Ish-ISHMP-ja Dibër ;
-Ish-DRM -ja Dibër;
-Ish-DRM -ja Durrës;
-Ish-ISHMP-ja Durrës; nuk ka kryer veprimet fizike/kontabël për dorëzimin, godinave, automjeteve, inventarin ekonomik.

Nga auditimi i veprimeve lidhur mbi kalimin në përgjegjësi administrimin e godinave, automjeteve, inventarin ekonomik të ISHMPUT Qendër dhe Degëve Rajonale Durrës, Dibër, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër",nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit, në lidhje me veprimet kontabël/fizike për kalimin e automjeteve inventarin ekonomik në përmjet të urdhër, proces-verbaleve, daljeve etj... rezulton se:

Konkluzion:

Ish-ISHMP-ja, Durrës nuk ka kryer veprimet fizike/kontabël për dorëzimin, automjeteve, inventarin ekonomik etj....nga ish-financierja *K Q* (emëruar financiere pranë Agjencisë së Bregdetit, Dega Rajonale Durrës) nuk janë zbatuar dispozitat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" dhe udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011"Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", e Ministrit të Financave,

ARM nuk ka kryer inventarizimin e llogarisë 215 "Mjete transport", nuk janë mbajtur procesverbale marrje dorëzim mbi gjendjen fizike, nuk kishin hapur kartela përkatëse për çdo mjet ku të jenë firmosur nga personat që i kanë në përdorim, nuk ka regjistër themeltare veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik'.

Mjetet e transportit janë marrë thjeshtë me procesverbal të marrjes në dorëzim pa dokumentacion shoqërues, pra vlerësimin e gjendjes të çdo mjeti.

Inventari që është kryer në institucion për vitin 2020, ka konstatuar këto pa rregulluesi ;

-Në momentin e fillimit të inventarizimit në objekt, anëtarët e komisionit të inventarizimit nuk kanë përpiluar deklarata për konflikt të interesit me punonjësit me përgjegjësi materiale, ose që kanë në përdorim aktive, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005"*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", pika 82, ku qartësisht përcaktohet se: "*...Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi.*".

-Komisionet në fillim të veprimtarisë së procesit të inventarizimit, nuk kanë hartuar akt akordim për të përcaktuar dhe fiksuar, numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes të fundit, veprim në mospërputhje me pika 83 e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* nuk ka përgatitur raportin informues për të paraqitur te Titullari i njësisë shpenzuese, informacionin mbi gjendjen fizike të vlerave të aktiveve,veprim në mospërputhje me pika 85, gërma (c) dhe 86,

-Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin Drejtorit të ARM nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, propozimin për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime te mëtejshme drejtuesit. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivit, apo mallrave e materialeve Udhëzimit nr.30. date 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik "Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, të marre masa të përpilojë një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, propozimin për nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzojë për veprime te mëtejshme drejtuesit.

-AKM ka kryer inventarizimin e llogarisë215"Mjete transporti",vetëm mbi bazë procesverbale marrje dorëzim mbi gjendjen fizike, nuk kishin hapur kartela përkatëse për çdo mjet ku të jenë firmosur nga personat që i kanë në përdorim, nuk ka regjistër themeltare veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 date 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve ne Njësite e Sektorit Publik'.

-Nga punonjësi i financës i ish-ISHMP-së Durrës,Katerina*Qirjazi* nuk është kryer asnjë veprim për zbatimin e Urdhrit të **nr. 71 datë** 30.06.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të AKM –së, Në zbatim të tij duhet të kryente veprimet fizike/kontabël për dorëzimin automjeteve, inventarin ekonomik etj....sipas si dhe Urdhrit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit Nr. 54, datë 24.02.2020, nr/ prot 1908,**"***Për kalimin në përgjegjësi administrimi të godinave, automjeteve, inventarin ekonomik të ISHMPUT Qendër dhe Degëve Rajonale të saj, tek institucionet e tjera të varësisë së MTM* .

Për vitin 2020,fletët e inventarit nuk janë hartuar por ka vetëm kartela të firmosura nga punonjësit që kanë në ngarkim nuk kanë rezultuar diferenca. Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 35, 36, 106, 109 ku citohet;

35. Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim.

36.Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të

dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative[12]*. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe atë të mashtrimeve.*
106. Relacioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga kryetari i komisionit të vlerësimit.

Për periudhën objekt auditimi janë kryer inventarët e vitit 2020, për vitin 2021,janë ngritur udhëtar dhe kryer inventari fizik, por nuk janë mbyll veprimet kontabël, për të cilat nuk mundë ë japim opinion.

Titulli Gjetjes: Mungon deklarata për konflikt të interesit me punonjësit me përgjegjësi materiale, ose që kanë në përdorim aktive.

-Komisionet në fillim të veprimtarisë së procesit të inventarizimit, nuk kanë hartuar akt akordim për të përcaktuar dhe fiksuar, numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes të fundit, veprim në mospërputhje me pika 83 e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik",* nuk ka përgatitur raportin informues për të paraqitur te Titullari i njësisë shpenzuese, informacionin mbi gjendjen fizike të vlerave të aktiveve, veprim në mospërputhje me pika 85, gërma (c) dhe 86,

Situata: Nuk janë hartuar deklaratat e konfliktit të interesit para fillimit të inventarizimitpërcaktuar si dhe fiksuar, numrin rendor të fletëhyrjes dhe fletëdaljes të fundit, nuk është përpiluar raporti lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve,

Kriteri: Ligji nr.9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", pika 82, ku qartësisht përcaktohet se: "*...Anëtarët e komisionit nuk duhet të kenë konflikt interesi si dhe me pika 85 germa (c) dhe 86,*

Ndikim/efekti: Mos kryerje e objektivave**,**

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi; Të merren masa nga Kryetari i komisionet e inventarizimit që të hartohen deklarata e konfliktit të interesit në çdo raste para fillimit te inventarizimit.

-të fiksohet nr i fundit rendorë nga magazinieri para fillimit të inventarit.

- Komisioni i inventarizimit të hartoje raportet përfundimtare dhe ti paraqesë Titullarit.

Në vazhdimësi:

Observacion;Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr..*155/2datë 08.04.2022*,datë"Mbi Projektraportin e Auditimit" nga *Xh.H* ku janë shprehur objeksionet si më poshtë;

në lidhje me pikën nr1, 2 të programit të auditivit për pjesën e buxhetit dhe pasqyrat financiare.

Qëndrimi i grupit audites: *pasi shqyrtoi dokumentacionin mori në konsideratë dhe u reflektuan në projekt raport .*

Observacion*: më nr. prot 155/3 datë 08.04.2022, në lidhje me pikën nr. 2 të programit të auditimit mbi administrimin , ruajtjen e dokumentimin Z.D.bbashkëlidhur urdhrat e titullarit dhe kartelat për secilin mjete,*

Qëndrimi i grupit audites: *pasi shqyrtoi dokumentacionin mori në konsideratë dhe u reflektuan në projekt raport .*

Observacion;Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr..*154/4 datë 08.04.2022*,datë"Mbi Projektraportin e Auditimit" nga*znj. K Q, ngre pretendimet se nuk është cituar në urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm, ku do kalojë kjo bazë materiale, në urdhrin e*

Sekretarit të Përgjithshëm, është e qartë se ku do kalojë baza materiale, e cila duhet dorëzuar pranë ARM Tiranë Durrës Dibër.Ky pretendim nuk qëndron pasi dhe flete daljet bashkëlidhur observacionit, janë pa datë që e bënë të pamundur kohën e kryerjes së veprimimit.

Qëndrimi i grupit auditues:*pasi shqyrtoi dokumentacionin nuk mori në konsideratë observacionin.*

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi punonjësit e trajtuar në akt konstatim, si dhe komisioni i inventarizimit.

3. Mbi auditimin e procedurave për mendimet e dhëna nga ARM, për lejet mjedisore të Tipit A dhe B, auditim i procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM paraprake/ të thelluara) si dhe procedurave të raporteve të monitorimit

Në zbatim të pikes 3 "Mbi auditimin e procedurave për mendimet e dhëna nga ARM, për lejet mjedisore të Tipit A dhe B, auditim i procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM paraprake/ të thelluara) si dhe procedurave të raporteve të monitorimit u shqyrtua dokumentancioni si më poshtë:

1.Aplikimet për VNM-të paraprake/ të thelluar;
2.Aplikimet për leje mjedisi Tipi A/B;
3.Mendimet e ARM-së për VNM-të paraprake/ të thelluar;
4.Mendimet e ARM-së për Leje mjedisi Tipi A/B;
5.Raportet e vetmonitorimit;
6.Konsultimet me publikun.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL" si dhe VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e proçedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe proçedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore", Agjencitë Rajonale të Mjedisit japin mendimin e tyre me shkrim AKM-së (Agjencisë Kombëtare të Mjedisit) për aplikimet (Leje mjedisi Tipi A/B, aplikimet për VNM paraprake / të thelluar) që ndodhen në juridiksionin territorial të tyre

Referuar formatit për dhënie mendimi për VNM-të me nr.228 prot., datë 03.02.2016, të miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pika 6 dhe ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", Agjencitë Rajonale të Mjedisit kanë për kompetencë verifikimin në terren të raporteve të VNM-ve.

- Në vitin 2020 (periudha 01.07.2020-31.12.2020) nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, janë dhënë mendime për 286 dosje për VNM paraprake /të thelluar;

-Për vitin 2021 janë dhënë mendime për 556 dosje për VNM paraprake/ të thelluar.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e dhënies së mendimit për subjektet si më poshtë:

- **Aplikimet e VNM-së dhe mendimet e ARM-së përkatëse për VNM paraprake/ të thelluar gjatë vitit 2020**

Nr.	Subjekti	Aktiviteti/veprimtaria	Vendndodhja	Mendimi i ARM Tiranë, Durrës, Dibër	Mangësitë

1.	2. sh.p.k	Ndërtim godinë banimi dhe shërbimesh 3, 4, 5, 7 dhe 8 kate mbi tokë dhe me 1 kat parkim nëntokë	Rruga"Lluk Kacaj", Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN160720200004,datë 07.8.2020)	Mungon verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së
2.	A. sh.p.k	Objekt banimi dhe shërbimi 8 kate me dy kate parkim nëntokë	Rruga"Pjetër Budi", Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN170920200001,datë 02.10.2020**)**	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot., datë 29.09.2020
3.	A. sh.p.k	Shfrytëzimin e gurit gëlqeror deri në produktin e gatshëm për shitje	Mali i Dorëzit, km.5 , Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN070820200001,datë 01.09.2020)	Mungon verifikimi në terren
4.	A.sh.p.k	Kërkim zbulim për mineralin e kromit	Zona minerare Nr.682/1, Bulqizë, Dibër	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN291020200002,datë 18.11.2020)	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot., datë…
5.	A.C. sh.p.k	Rikonstruksion i objektit arsimor kopshti "Lidhja e Prizrenit"	Në rrugën " Azem Galica", Paskuqan, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN150820200004,datë 08.09.2020)	Mungon verifikimi në terren
6.	A.S. C. sh.p.k	Godinë 1 kat me destinacion kapanon industrial	Në rrugën "Demokracia", Kamëz, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN231120200001,datë 14.12.2020)	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot., datë 03.12.2020
7.	A.B, sh.p.k	Rindërtimi i shkollës 9 vjeçare dhe koopshtit "Kastriot Derveni"	Thumanë, Bashkia Krujë	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN300620200005,datë 28.07.2020)	Mungon verifikimi në terren
8.	A. sh.p.k	Strukturë magazinimi dhe zyra 1 kat me mur rrethues	Në autostradën "Tiranë-Durrës", km.4, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me AN301020200003,datë 27.11.2020)	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot., datë 23.11.2020
9.	A. sh.p.k	Ndërtim godinë banimi dhe shërbimi 1,2,4 dhe 7 kate me 2-3 kate parkim nëntokë	Në rrugën "Inajete Dumi","Ali Visha", "Mustafa Mara",njësia strukturore TR /61, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me AN290720200006,datë 17.08.2020)	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot., datë 11.8.2020
10.	A.S.sh.p.k	Kërkim-zbulim për mineralin e kromit	Lufaj , Mat	Mendim pozitiv (shkresa me AN021120200008, datë 19.11.2020)	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot., datë 17.11.2020
11.	A.K.	Ndërtim objekt shërbimi 1 kat (servis)	Vaqarr, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN200720200004,datë 11.08.2020)	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot., datë 03.08.2020
12.	A.F. sh.p.k	Ndryshime dhe përmirësime në aktivitetin e kompanisë	Yrshek, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN180620200007, datë 14.07.2020)	Mungon verifikimi në terren
13.	A. P. sh.p.k	Ndërtim godinë banimi dhe shërbimesh 4 dhe 6 kat me 2 kat nëntokë	Në rrugën "Bardhyl", Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN180620200009, datë 14.07.2020	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot.,datë.
14.	A.G. sh.p.k	Rindërtim godine 1 kat me 1 kat nëntokë	Në rrugën " Ali Beqja", Bashkia Durrës	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN100820200001, datë 28.08.2020)	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot.,datë 26.08.2020

15.	A. A.	Ndërtim objekti 2 kat dhe 1 kat nëntokë me funksion punishte	Njësia administrative Farkë, bashkia Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN300720200001 , datë 17.08.2020)	Mungon verifikimi në terren
16.	A.C. shpk	Ndërtim objekti shërbimi 1 kat dhe zyra 2, 3 kate për tregti me shumicë dhe pakicë	Në rrugën "Mulliri i Vjetër", Bashkia Vorë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN141020200002, datë 05.11.2020)	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot.,datë 30.10.2020
17.	A. shpk	Rindërtimi i banesave kolektive në sheshin e pallatit Nr.14	Në bulevardin "Dyrrah", Bashkia Durrës	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN290920200006, datë 19.10.2020)	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot.,datë 13.10.2020
18.	A.N. shpk	Ndërtimi i objektit të banimit dhe shërbimit 9 dhe 11 kate me 2 kate parkim nëntokë	Në rrugën "e Kavajës", Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN160620200003, datë 14.07.2020)	Mungon verifikimi në terren
19.	D. V.	Shfrytëzim i gurit gëlqeror të mermerizuar	Në njësinë Administrative Macukull, Bashkia Mat	Mendim pozitiv(shkresa me nr.AN260620200003, datë 27.07 .2020)	Mungon verifikimi në terren
20.	D.V.	Ndërtim magazine bujqësore 1 kat me bodrum për bimë medicinale	Në Vajkal, Bashkia Bulqizë	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN260720200001, datë 14.08.2020)	Proçesver-bali i verifikimit në terren është pa numër prot.,datë 11.08.2020

- **Aplikimet e VNM dhe mendimet e ARM për VNM paraprake/ të thelluar gjatë vitit 2021**

Nr	Subjekti	Aktiviteti/veprimtaria	Vendndodhja	Mendimi i ARM Tiranë, Durrës, Dibër	Mangësitë
1.	A. C. sh.p.k	Ndërtim godinë banimi 2, 7 dhe 10 kate dhe 2 kat nëntokë	Në rrugën Dritan Hoxha" , Njësia Bashkiake Nr.7, Bashkia Tiranë.	Mendim pozitiv (shkresa me numër nr. AN090520210002, datë 21.05.2021)	Mungon verifikimi në terren
2.	A. sh.p.k	Shfrytëzim guri gëlqeror me karriere	Në zonën minerare Nr.121/6 objekti Zall Herr, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN221020210005, datë 05.11 .2021)	Mungon verifikimi në terren
3.	A. Shpk	Ndërtim magazine për materiale xhami 1 dhe 2 kate me mur rrethues	Në njësinë administrative Vaqarr, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN171220210003,datë 01.11.2021)	Mungon verifikimi në terren
4.	B. B.M.Shpk	Ndërtim kapanoni industrial 1 kat dhe mur rrethues	Në Vrrine,Njësia Administrative Rashbull, Bashkia Durrës	Mendim pozitiv (shkresa me Nr. AN301120210006, datë 20.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
5.	D. C. Shpk	Ndërtim magazine për ruajtje produktesh bujqësore 1 kat	Në njësia Administrative Vorë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. nr.AN251020210006, datë 11.11.2021)	Mungon verifikimi në terren
6.	"F. C." Shpk	Zhvillim kompleks për ndërtimin e ambjenteve të reja me funksion residencial dhe shërbimesh prej 2, 4, 5, 7, 9, 11, 12 dhe 18 kate mbi tokë dhe 4 kate nëntokë	Në Bulevardin "Gjergj Fishta", Bashkia Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN191120210004 , datë 13.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
7.	K.S. R. A" shpk	Rikuper,menaxhim, transportim,staciontransferimi i mbetjeve jo të rrezikshme dhe magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalitqë nuk përmbajnë materiale të rrezikshme	Në bulevardin "Gjergj Fishta", Bashkia Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN031220210002,datë 20.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
8.	M. O. sh.p.k	Rikonstruksion i pikës së karburantit ekzistues dhe shtesë objekti 1 kat me funksion zyra, gomisteri dhe lavazh	Në rrugën "Don Bosko", Bashkia Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN131220210002, datë 16.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
9.	N.K. Sh.p.k	Ndërtim objekt banimi dhe shërbimi 2,4,6 dhe 8 kat, dhe 2	Në rrugën " Foto Janku", Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN051120210003, datë	Mungon verifikimi në

		kat parkim nëntokë		01.12. 2021)	terren
10.	O.T. sh.a.	Ndërtim dhe instalimi i stacionit One Telecommunications "Gurrë 1616" dhe rrugëve të aksesit	Në fshatin Gurrë, Bashkia Klos,Qarku Dibër	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN241120210003, datë - 16.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
11.	I. sh.a	Ndërtim port jahtesh	Në Gjirin e Rodonit, Fshati Drac, Njësia Administrative Ishëm, Bashkia Durrës	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN151020210003, datë 02.11.2021)	Mungon verifikimi në terren
12.	S. E. & D. E.	Ndërtim godinë industriale 1 dhe 2 kat + kabinëelektrike 1 kat + vend roje 1 kat dhe mur rrethues	Fshati Vlashaj, Njësia Administrative Maminas, Bashkia Shijak	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN251120210007,datë 20.12.2021	Mungon verifikimi në terren
13.	V. G. sh.p.k	Ndërtim kompleks banimi me struktura 1 dhe 2 kat me 1 kat	Në Farkë e Vogël, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN261020210005, datë 11.11.2021)	Mungon verifikimi në terren
14.	Y. sh.p.k	Shfrytëzimi i mineralit të kromit	Në objektin "Maja e Kunorës", Bashkia Klos, Klos, Dibër	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN161120210003, datë - 20.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
15.	V. I.-F.S" sh.p.k	Ndërtimin e godinës industriale me 4 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë	Në njësinë administrative Kashar, Mëzez, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN301120210005 ,datë 20.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
16.	S. k. sh.p.k	Ndërtimin e godinës së banimit polifunksionale 7, 10 kat mbi tokë me 3 kate nëntokë	Në rrugën "Egnatia", njësia administrative 9**, Tiranë**	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN061120210001, datë 11.11.2021)	Mungon verifikimi në terren
17.	R. sh.p.k	Ndërtim i godinës tip të banimit 7 kate mbi tokë dhe 1 kat nëntokë, në rezidencën studentore universitare nr.1 (nr. 19)	Në rrugën "Pjeter Budi", Qyteti Studenti, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN161220210006, datë 11.01.2022)	Mungon verifikimi në terren
18.	N. K. sh.p.k	Ndërtim godine banimi dhe shërbimesh 4-16 kate me 3 kat nëntokë	Në rrugën ''Dritan Hoxha" , Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN101120210007, datë 03.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
19.	K. sh.p.k	Ndërtim godine banimi dhe shërbimi 5, 8 dhe 11 kat me 2 kate parkim nëntokë	Në rrugën " Telo Ndini", Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN251120210006, datë 16.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
20.	I. Xh, M. Xh., F.N. dhe V. N.	Ndërtimin e 2 godinave industriale 2 kat dhe 4 godinaindustriale 1 + 2 kat + kabinë elektrike dhe vend roje +mure rrethues	Në Xhafzotaj, Bashkia Shijak	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN280920210011, datë 14.10.2021)	Mungon verifikimi në terren
21.	H. A. "sh.p.k	Ndërtimin e objektit industrial 1-2-3 kate (zyra magazina dhe ekspozitorë)	Në Valias, rruga " Rilindja" Bashkia Kamëz	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN181120210007, datë 03.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
22.	H. sh.p.k	Ndërtim kapanoni industrial 1 kat dhe zyra 2 kat + mur rrethues+kabinë elektrike	Në autostradën "Tiranë-Durrës", Sallmone, Bashkia Shijak	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN011220210005, datë 21.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
23.	B. &C.sh.p.k	Ndërtim magazine, depo farmaceutike 1 kat	Kashar, Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN181120210003, datë 10.12.2021)	Mungon verifikimi në terren
24.	A.H. B. sh.p.k	Ndërtim magazine 1 kat me mur rrethues	Në fshatin Gjokaj, Njësinë Administrative Vorë, Qarku Tiranë	Mendim pozitiv (shkresa me nr. AN161020210004, datë 02.11.2021)	Mungon verifikimi në terren
25.	F.M. & E. sh.p.k	Rindërtim + shtesë anësore, 4 godina 1 kat me funksion hotel	Në "Lagjen 13", Bashkia Durrës	Mendim pozitiv (shkresa me nr.AN251120210001, datë 21.12.2021	Mungon verifikimi në terren

Në çdo aplikim për VNM paraprake/ të thelluar bashkëlidhur gjendej:
-raportin teknik të projektit të propozuar;
-raportin paraprak/ të thelluar të VNM-së;
-aktin e rregjistrimit të personit fizik/juridik;
-një kopje e faturës së pagesës së tarifës së shërbimit.
-Nga auditimi rezultoi se për periudhën 01.07.2020-31.12.2020, mendimet për VNM paraprake/ të thelluar (VNM-të me numër rendor 1, 3, 5, 7, 12, 15, 18, 19) janë dhënë nga shqyrtimi elektronik i dosjeve. Ndërsa mendimet e tjera të VNM-së (për raportet e VNM-së me numër rendor 2, 4, 6, 8, 9, 10, 11, 13, 14, 16, 17, 20) është kryer verifikimi i raporteve të VNM-së, por proçesverbalet janë pa numër protokolli.

Gjatë vitit 2021, mendimet për VNM paraprake/ të thelluar janë dhënë nga shqyrtimi në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit e-leje dhe nuk është kryer verifikimi në terren për të vlerësuar raportin e VNM-së. Referuar formatit të dhënies së mendimit për VNM-të paraprake, miratuar nga Agjencia Kombëtare të Mjedisit, pika 6 e formatit përcakton; **verifikimi të bëhet në terren dhe jo nga dosja që vjen elektronikisht**, ndërkohë konstatohet se Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër ka ndryshuar formatin standart të mendimit, ku në pikën 7 citohet "**mendimi i ARM pas shqyrtimit elektronikisht të dosjes**". Përsa më lart ka mospërputhje mes formatit të miratuar nga AKM dhe shkresës së hartuar/përpiluar nga ARM Tiranë, Durrës, Dibër, kjo në kundërshtim edhe me zbatimin e ligjit Nr.10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit"**,** neni 63, pika ç, ku përcaktohet**;** "*Inspektimi për mbrojtjen e mjedisit përfshin :ç) verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori i veprimtarisë"*

-Agjencia Rajonale e Mjedisit ka hartuar/përpiluar një dokument për marrje mendimi drejtuar njësive vendore ku citohet "*Njoftim VNM paraprake – për njësinë vendore.*

Në zbatim te VKM Nr.686, datë 29.07.2015 "Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësive e të Afateve për Zhvillimin e Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Procedurës së Transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore", Kreu I, Pika 5 po ju dërgojmë aplikimin e subjektit "…." sh.p.k, për të cilin keni kohë 6 (gjashtë) ditë kalendarike pune për tu shprehur".

-Shkresat për dhënie mendimi për VNM paraprake/ të thelluar drejtuar AKM janë dokumenta elektronike dhe janë nënshkruar elektronikisht vetëm nga drejtuesi i institucionit. -Po kështu, për periudhën 01.07.2020-31.12.2021, nga ana e Agjencisë Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër nuk është publikuar asnjë raport i VNM-së paraprake në ëeb-in e ARM-së për informimin e publikut gjatë proçedurës për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, veprime që bien në kundërshtim me rregulloren Nr. 01, datë 3.03.2017 me Nr.435/1 prot., datë 03.03.2017 të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit "Për zbatimin e proçedurave dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore , pika 1; "*Për një proçes sa më transparent për informimin e publikut gjatë proçedurës paraprake të VNM dhe marrjen e mendimit nga punonjësi i autorizuar nga AKM/ ARM e qarkut përkatës , brenda 5 ditëve nga data e marrjes së aplikimit për proçedurë të VNM paraprake , publikon në faqen zyrtare të internetit informacionin e plotë sic ka mbërritur nga zhvilluesi/kërkuesi*".

<u>Konkluzione</u>:

Nga auditimi i mësipërm për 45 aplikime për VNM paraprake/ të thelluar, rezultoi se 33 dosje janë shqyrtuar elektonikisht nëpërmjet sistemit e-albania dhe nuk është kryer verifikimi në terren për të verifikuar raportet e VNM-së.

Në 12 raste (periudha 01.07.2020-31.12.2020) janë mbajtur proçesverbale konstatimi në terren por janë pa numër protokolli, në kundërshtim me Ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat", neni 2, pika 1 dhe "Normat tekniko- profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", Neni 12 dhe 13.

U konstatua se nga ana e Agjencisë Rajonale e Mjedisit nuk janë marrë udhëzimet përkatëse nga AKM për marrjen e mendimit njësive vendore.

Aplikimet e Lejeve Mjedisore dhe mendimet përkatëse të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër gjatë vitit 2020.

Mendimet për leje mjedisi Tipi A/B jepen bazuar në VKM Nr.419 datë 25.06.2014 dhe rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit Nr.120, datë 12.01.2021.
Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka dërguar një kopje të aplikimit në ARM Tiranë, Durrës, Dibër, për 692 dosje në total për periudhën 01.07.2020-31.12.2021, e cila ka dhënë mendimin e saj me shkrim.
-Në vitin 2020 (periudha 01.07.2020-31.12.2020) nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, janë dhënë mendime për leje mjedisi Tipi A/B për 99 dosje;
-Për vitin 2021 janë dhënë mendime për Leje mjedisi Tipi A/B për 593 dosje.
Nga grupi i auditimit u përzgjodhën praktikat si më poshtë:
1.Subjekti B. C. sh.p. k ka aplikuar për aktivitetin përpunim, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ me vendndodhje në Bubq, Budull, Krujë, Qarku Durrës. Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 5 m3 në ditë ose më i madh se kaq. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: ekstrakti i QKB-së, çertifikatë pronësie, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raport sigurie, raport i fundit i monitorimit, shkresë nga AKM. Nga specialistët është kryer verifikimi në terren në datën 20.08.2020 dhe është pa numër protokolli. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot. 154, datë 24.08.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Sipas aneksit 4 të formularit informues, subjekti deklaron se uji sigurohet nga rrjeti i zonës në bazë të kontratës me U.. Subjekti nuk ka bashkëngjitur kontratë me U.;
2.Në aneksin 6 të formularit informues subjekti nuk deklaron koordinatat e vaskës së dekantimit, skica, planimetri të saj;
3.Raporti i vetmonitorimit është dorëzuar për periudhën 25 tetor 2019-25 prill 2020. Sipas lejes së mjedisit raportimi i fundit duhet të jetë 25 nëntor 2019-maj 2020.
2.Subjekti C.m. sh.p.k ka aplikuar për aktivitetin magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme.Staciontransferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lartme vendndodhje në Vaqarr, Tiranë. Kapaciteti është 50 ton në ditë mbetje skrapi dhe 50 ton mbetje jo të rrezikshme.Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, kontratë furnizimi me mbetje plastike, leje mjedisi tipi C dhe raport i fundit i vetmonitorimit.Nga specialistët është kryer verifikimi në terren në datën 11.08.2020 dhe proçesverbali është pa numër protokolli. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me Nr.140 prot., datë 21.08.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Mungon vendimi i AKM-së për kalimin e aktivitetit nga Leje Mjedisi Tipi C në leje mjedisi tipi B;
2.Mungon VNM paraprake për zhvillimin e aktivitetit magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme, sipas ligjit Nr. 10440 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".
3.Subjekti Sh. sh.p.k ka aplikuar për aktivitetin magazinim i hekurishteve/ skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme, magazinim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike, stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart, stacion transferimipër mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart me vendndodhje në Fushë Krujë, Qarku Durrës. Kapaciteti grumbullues, përpunimit dhe tregtimit të skrapit është 50 ton në ditë. Në dosje

aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raport vetmonitorimi, formulari i konsultimit me publikun. Nga specialistët është kryer verifikimi në terren në datën 20.08.2020 dhe proçeverbali është pa numër protokolli. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot.141, datë 21.08.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1. Mungon relacioni i dëgjesës me publikun sipas përcaktimeve në pikën 13 të kreut VI të këtij vendimi.Konsultimi me publikun ka kaluar afatin një vjeçar (është mbajtur në datë 03.12.2018);
2. Kontrata me kompaninë "S. S. I. S." sh.p.k për shitjen e skrapit nuk është e vulosur nga kompania "Sh." sh.p.k ;
3. Kontrata me subjektin "F." sh.p.k për pastrimin e ujrave të zeza i ka kaluar afati;
4. Është ndryshuar formati i formularit për leje e mjedisit Tipi B .

4.Subjekti A.O. sh.p.k (LC -2...) ka aplikuar për aktivitetin furnizim me karburant në një stacion të furnizimit me karburant me vendndodhje në "Lagjia Nr.2", Kavajë. Kapaciteti është 100000 litra karburant. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, formulari i konsultimit me publikun, projekti për mbrojtjen nga zjarri. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot . 1457, datë 22.12.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1. Në formularin e aplikimit subjekti aplikon për aktivitetin furnizimin me karburant, ndërsa në formularin e lejes së tipit B dhe në raportin e sigurisë deklaron edhe ID 1.7 (GLN) ;
2. Projekti i mbrojtjes nga zjarri është për subjekte të tjera dhe jo për subjektin "A. O." sh.p.k.

5.Subjekti I. A. sh.p.k (LC -3...-12-2020) ka aplikuar për aktivitetin proçesi i tharjes së bojës së stampimit, printimit me anë të ajrit të nxehtë me vendndodhje në rruga " Cerciz Topulli",Tiranë. Sipërfaqja është 4512 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: ekstrakti i QKB-së; kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, formulari i konsultimit me publikun, kontratë qiraje, kontratë mbetjesh. ARM, Tiranë , Durrës , Dibër në shkresën me nr. prot 1131, datë 09.11.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Kontrata e qirasë është e palexueshme;

2.Mungon verifikimi në terren.

5.Subjekti A. S. sh.p.k (LC-9...-10-2020) ka aplikuar për aktivitetin përpunimi, prerja dhelustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ me vendndodhje në Qerret, Kavajë, Tiranë. Sipërfaqja është 4512 m2 . Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, formulari i konsultimit me publikun, çertifikatë pronësie, shkresë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Nga specialistët është kryer verifikimi në terren në datën 20.10.2020 dhe proçesverbali është pa numër protokolli. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot.1013, datë 12.11.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1. Mungon skema e vendosjes së pajisjeve që do të përdoren në proçesin e punës ;
2. Në aktin e dhënies së mendimit nuk është pasqyruar verifikimi në terren.

6.Subjekti C. sh.p.k (LC-1430-09-2020) ka aplikuar për aktivitetin riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave me vendndodhje në Yzberisht,Tiranë. Sipërfaqja është 4512 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, sistemi i fikjes së zjarrit, formulari i konsultimit me publikun, kontratë qiraje, shkresë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Nga specialistët është kryer verifikimi në terren në datën 18.09 .2020 dhe proçesverbali është pa numër protokolli.ARM, Tiranë , Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot. 1013, datë 12.11.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1. Në aneksin 2 të formularit informues nuk përshkruhen proçeset e punës, pasjisjet që përdoren për zhvillimin e aktivitetit;
2. Subjekti nuk ka bashkëngjitur kontratë me subjekte të licensuara për grumbullimin e mbetjeve të gomave.

7.Subjekti S. sh.p.k (LC-0...-07-2020) ka aplikuar për aktivitetin përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhepërzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dheprodukteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, paletave etj) në rruga "A H.U", Tiranë. Sipërfaqja është 4512 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë , formulari i konsultimit me publikun, çertifikatë pronësie. ARM, Tiranë, Durrës , Dibër në shkresën me nr. prot.367, datë 21.09.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes si dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1. Sipas aneksit 2 të formularit informues për leje mjedisi Tipi B, subjekti nuk ka bashkëngjitur planimetri, skica të instalimit ;
2. Nuk deklarohet uji si lëndë e parë dhe nga kush sigurohet;
3. Mungon verifikimi në terren.

8. Subjekti E. O. (LC- 1...-09-2020)ka aplikuar për aktivitetin ringjyrosje ose risprucim i mjeteve të transportit rrugor ose pjesëve të tyre me vendndodhje në rruga "Drini", Paskuqan, Tiranë. Sipërfaqja është 174 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, formulari i konsultimit me publikun, raport vetmonitorimi. Nga specialistët është kryer verifikimi në terren në datën 17.09.2020 dhe proçesverbali është pa numër protokolli. ARM, Tiranë, Durrës , Dibër në shkresën me nr. prot. 365, datë 21.09.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1. Nuk është bashkëngjitur çertifikata e pronësisë;
2. Nuk deklarohet niveli i zhurmave i shprehur në db;
3. Raporti i vetmonitorimit duhet të jetë i 6 -mujorit të fundit.

9.Subjekti Z. sh.p.k(LC-1...) ka aplikuar për aktivitetin furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant me vendndodhje rruga "Qendër", godinë 1 katëshe, Baldushk, Tiranë. Kapaciteti i projektuar është 20000 litra karburant. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, formulari i konsultimit

me publikun, autorizim. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot. 736, datë 13.10.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1. Raporti i vetmonitorimit nuk është bërë nga një subjekt i licensuar dhe i akreditуar për të kryer proçedurën e vetmonitorimit;
2. Mungon çertifikata e pronësisë;
3. Në pikën 6 të formularit informues , deklarohet se subjekti ka lidhur kontratë me subjekte të licensuara për grumbullimin e ujërave të ndotur. Në dosje mungon kontrata;
4. Mungon verifikimi në terren .

10.Subjekti S. W. sh.p.k (LC- 1...-09-2020) ka aplikuar për aktivitetin prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike me vendndodhje rruga "Vangjel Ceco", Tiranë. Kapaciteti i projektuar është 70000 litra verë. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, formulari i konsultimit me publikun, kontratë huapërdorje, përmbledhje joteknike. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot. 427 , datë 28.09.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Sipas Vendimit Nr. 177, datë 6.3.2012 " Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre ", subjekti duhet të bashkëngjisë kontratë me subjekte për riciklimin e mbetjeve të ambalazheve që krijohen nga zhvillimi i aktivitetit;

2.Mungon verifikimi në terren.

11.Subjekti B. M. (LC-2...-10-2020) ka aplikuar për aktivitetin lyerja dhe lustrimi i makinave, riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë me vendndodhje në Kashar , Tiranë. Sipërfaqja është 279 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, formulari i konsultimit me publikun, kontratë qiraje, përmbledhje joteknike. Nga specialistët është mbajtur verifikimi në datë 26.10.2020 dhe nuk është pasqyruar në mendimin e dhënë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Mendim i ARM, Tiranë , Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot.1129, datë 09.11.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Në pikën 12 të formularit për leje mjedisi Tipi B subjekti deklaron se janë marrë masa për sistemimin e zonës, por nuk janë përshkruar masat ekzistuese ose të propozuara që synojnë reduktimin e ndikimit në mjedis pas ndërprerjes së aktivitetit .

12.Subjekti C. C. sh.p.k (LC-2...-11-2020) ka aplikuar për aktivitetin përpunimi i tekstileve ose fibrave, lavanderi me vendndodhje në Durrës. Kapaciteti larës është 10 ton në ditë. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, formulari i konsultimit me publikun. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot .1354, datë 09.12.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Në formularin e dëgjesës më publikun mungon data e zhvillimit të dëgjesës;

2.Në pikën 6 të formularit informues nuk deklarohen nivelet e zhurmave nga pajisjet e instalimit;

3.Aneksi 7 dhe 8 e formularit informues nuk janë plotësuar.

13.Subjekti D.p. sh.p.k (LC- 2...-10-2020) ka aplikuar për aktivitetin proçese të tjera rotogravurë, flexografi, stampim, printim me makinë shtypi rotativë, laminim ose lustrim

me vendndodhje në Kashar, Tiranë. Sipërfaqja është 4500 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, formulari i konsultimit me publikun, raport vetmonitorimi. Nga specialistët është kryer verifikimi në terren në datën 05.11.2020 dhe proçesverbali është pa numër protokolli.ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot. 1219, datë 11.11.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Raporti i vetmonitorimit nuk është për vitin 2020, por për vitin 2019, (korrik- dhjetor 2019)

2.Subjekti nuk ka ka bashkëngjitur kontratën e qirasë në formën e duhur ligjore (e noterizuar).

14.Subjekti R. sh.p.k (LC-2...-11-2020) ka aplikuar për aktivitetin magazinimi i hekurishteve/skrapeve te metalit qe nuk përmbajnë materiale të rrezikshme dhe stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmenden më lart, me vendndodhje në Laprakë, Tiranë. Sipërfaqja është 6616 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, formulari i konsultimit me publikun.

ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot .1384, datë 16.12.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1. Mungon VNM paraprake për zhvillimin e aktivitetit magazinim i hekurishteve/ skrapave të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme, sipas ligjit nr.10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" (shtojca 2, pika 11/d, depo e skrapit përfshirë edhe ato të automjeteve).

16. Subjekti A.T.(LC-1...-08-2020) ka aplikuar për aktivitetin përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ me vendndodhje në lagjen "Hasan", Fushë Krujë. Sipërfaqja është 5000 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raport i sigurisë. Nga specialistët është kryer verifikimi në terren në datën 01.09.2020 dhe proçesverbali është pa numër protokolli. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot. 277, datë 14.09.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Në disa prej pikave të formularit informues është përshkruar aktiviteti si pikë betoni;

2. Në pikën 13 të formularit informues, plani i menaxhimit të mbetjeve nuk jepet informacion për menaxhimin e llumrave që dalin nga vaskat e dekantimit.

17. Subjekti A. M. (LC-1...-09-2020) ka aplikuar për aktivitetin përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorative me vendndodhje në Pezë Helmes, Tiranë. Sipërfaqja është 1234 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, raport vetmonitorimi. Nga specialistët është kryer verifikimi në terren në datën 21.09.2020 dhe proçesverbali është pa numër protokolli.Mendim i ARM, Tiranë, Durrës, Dibër me nr. prot. 426, datë 28.09.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga shqyrtimi, dosja rezultoi me mangësi;

1.Në pikën 4 të formularit informues, subjekti deklaron ujë si lëndë e parë por nuk jepet informacion se nga furnizohet;

2.Nuk deklaron se ku shkarkohen ujrat nga vaskat e dekantimit të cilin e deklaron në formularin informues;

3.Në pikën 6 të formularit informues nuk deklarohet zhurma gjatë proçesit të punës .

18.Subjekti E. S.(LC-1...-09-2020) ka aplikuar për aktivitetin përpunimi dhe saldimi i metaleve me vendndodhje në rrugën "Valbona", Tiranë. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, formulari i konsultimit me publikun, raport vetmonitorimi. Nga specialistët është kryer verifikimi në terren në datën 18.09.2020 dhe proçesverbali është pa numër protokolli. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr. prot.423, datë 28.09.2020 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Subjekti nuk ka bashkëngjitur raportin e sigurisë;

2.Në pikën 2 të formularit informues përshkruhet proçesi i lyerjes, por në aplikim nuk është e përfshirë në aplikim;

3.Mungojnë kontratat me subjektet e licensuara për grumbullimin e mbetjeve metalike;

4.Mungon çertifikata e pronësisë.

- Aplikimet dhe mendimet e dhëna nga ARM për leje mjedisi Tipi A dhe B (viti 2021)

1. Subjekti A. sh.p.k (LC-9...-10-2021) ka aplikuar për aktivitetin lyerja dhe lustrimi i makinave, riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motocikletave, me vendndodhje në Vorë, Tiranë Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raport i sigurisë, dokument pronësie. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Subjekti deklaron se ka shkarkime në kanalizime, por nuk ka bashkëngjitur kontratë për shkarkimet në kanalizime;

2.Sipas pikës 1.6 të formularit informues subjekti nuk ka bashkëngjitur një dokument të planifikimit të zonës.

2. Subjekti C. A. sh.p.k(LC-0...-12-2021)ka aplikuar për aktivitetin gaz natyror aromatik ose GNL përvec rasteve kur veprimtaria është lidhur me Tipin A, ose përzierje e aromave, furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane me vendndodhje në "kthesa e Kamzës", ngjitur me mbikalimin në krah të kompleksit " Garden City", Tiranë. Në impiant janë të instaluar 4 depozita nëntokësore (2 depozita gasoil 20000 litra secila dhe 2 depozita benzinë 10000 litra secila me volum total 60000 litra karburant). Gjithashtu është instaluar dhe 1 depozitë GLN me volum total 5000 litra. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti i sigurisë, kontratë qiraje. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot. 2919, datë 16.12.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes dhe verifikimit në terren .

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Sipas pikës 1.6 të kërkesës për leje mjedisi Tipi B, subjekti nuk ka bashkëngjitur një dokument të planifikimit të zones;

2. Mungon verifikimi në terren që është pasqyruar në aktin e dhënies së mendimit Tipi B.

3. Subjekti K.A. sh.p.k (LC-9...-10-2021) ka aplikuar për aktivitetin prodhim i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit. Kapaciteti prodhues është 150 - 200 ton/ditë tulla dekorative të tipeve të ndryshme me vendndodhje në Maminas, Durrës. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raport i sigurisë, kontratë qiraje, VNM paraprake. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në

shkresën me nr. prot.2648, datë 08.11.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Subjekti aplikon për leje mjedisi tipi B dhe ka aplikuar me formular për leje mjedisi Tipi A (formulari informues).

4. Subjekti Sh. sh.p.k(LC-9...-11-2021) ka aplikuar për aktivitetin rritje intensive e shpendëve në një instalim me vendndodhje në Kavajë, Qarku Tiranë. Kapaciteti i projektuar është 1000 krerë shpendë. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, kontratë qiraje, raporti mbi sigurinë. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot. 2732, datë 19.11.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosje.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1. Sipas pikës 2 të formularit informues nuk përshkruhen proçeset e punës, metodat e rritjes intensive të shpendëve, mungojnë skicat, planimetritë dhe planvendosja e instalimit;

2.Sipas pikës 5 të formularit informues nuk deklarohen proçeset e menaxhimit të integruar të mbetjeve që gjenerohen nga instalimi.

5.Subjekti N. sh.p.k(LC-9...-11-2021) ka aplikuar për aktivitetin minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to, me vendndodhje në Bulqizë.Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, leje minerare.ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot.2660, datë 08.11.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1. Sipas pikës 1.6 të formularit informues, subjekti duhet të bashkëngjisë dokumentin e planifikimit të zonës;
2. Pika 1.6 e formularit informues nuk është plotësuar nëse impianti është i ri apo ekzistues;
3.Mungon verifikimi në terren.

6.Subjekti E.E. sh.p.k(LC-0...-12-2021)ka aplikuar për aktivitetin shpërndarje dhe magazinim i naftës dhe nënprodukteve të saj,magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në çisterna të palëvizshme në ndonjë terminal, ose ngarkim/shkarkim i naftës dhe nënprodukteve të saj në/nga një çistern e lëvizshme, çisternë hekurudhore ose anije e ujërave të brendshëm në terminal, shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në çisternat e stacioneve të furnizimit me karburant, me vendndodhje në Bulqizë.Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë: ekstrakti i QKB-së; kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, leje minerare. ARM, Tiranë, Durrës,Dibër në shkresën me nr.prot. 2940, datë 08.11.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes .

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Sipas pikës 1.6 të formularit informues subjekti duhet të bashkëngjisë dokumentin e planifikimit të zonës;
2.Sipas pika 1.6 të formularit informues, nuk është plotësuar nëse impianti është i ri apo ekzistues;
3.Mungon verifikimi në terren.

7. Subjekti N.K. sh.p.k(LC-9...-10-2021) ka aplikuar për aktivitetin përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ, me vendndodhje në fshatin Tapizë. Kapaciteti është 5-7 m3 në ditë. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti

i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, konsultimi me publikun.ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot. 2611, datë 02.11.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Fatura e pagesës nuk është për emrin e kompanisë që aplikon për leje mjedisi ose të administratorit të saj;

2. Mungon verifikimi në terren.

8. Subjekti O. sh.p.k(LC- 0...-12-2021) ka aplikuar për aktivitetin gaz natyror aromatik ose GNL, përvec rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave, furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane, me vendndodhje në rruga "e Dibrës", Tiranë. Sipërfaqja është 70 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, kontratë mbetjesh, dëgjesa me publikun.

ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot 2851, datë 09.12.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1. Mungon verifikimi në terren i paraqitur në aktin e dhënies së mendimit.

9. Subjekti F. P. sh.p.k(LC- 9...-11-2021) ka aplikuar për aktivitetin trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve nga lëndët e para nga kafshët (përvec qumështit), me vendndodhje në rruga "3 Deshmorët", Kombinati Ushqimor Yzberisht, Tiranë. Sipërfaqja është 700 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, dëgjesa me publikun. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot 2851, datë 09.12.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Mungon verifikimi në terren.

10.Subjekti R. sh.p.k (LC- 7...-06-2021) ka aplikuar për aktivitetin përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ (kapaciteti maksimal 10 m3/ditë), me vendndodhje në Kashar, Tiranë. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, dëgjesa me publikun.ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot.2081, datë 02.09.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Sipas pikës 1.6 të formularit informues, subjekti duhet të bashkëngjisë dokumentin e planfikimit të zonës;

2.Sipas pikës 2 të formularit informues subjekti nuk ka bashkëngjitur plane, skica të proçeseve të punës;

3.Nuk jepen koordinatat e vaskave të dekantimit;

4.Mungon verifikimi në terren.

11.Subjekti A. B. sh.p.k(LC- 4...-03-2021) ka aplikuar për aktivitetin magazinimi i kimikateve, me vendndodhje në Kavajë, Tiranë. Kapaciteti është 100 ton . Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, dëgjesa me publikun. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot. 1322, datë 11.06.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Data e formularit e dëgjesës me publikun (i paraqitur nga subjekti në aplikim) nuk është e njëjtë me datën e publikuar në ëeb-in e ARM Tiranë, Durrës, Dibër. Në ëeb konsultimi është në datë 23.12.2020 , ndërsa në formular data e dëgjesës është në 24.12.2020;

2.Sipas pikës 10 të formularit informues nuk janë renditur të gjitha masat me afatet dhe vlerësimet financiare përkatëse për zbatimin e programit/planit në bazë vjetore;

3. Mungon verifikimi në terren i pasqyruar në aktin e dhënies së mendimit për lejet mjedisi Tipi B.

12.Subjekti S.G. sh.p.k(LC- 8...-09-2021) ka aplikuar për aktivitetin industritë energjitike, gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin A, ose përzierje e aromave, furnizimi me karburant i makinave në një stacion te furnizimit me karburant ne zonat urbane, me vendndodhje në "Bulevardin Gjergj Fishta", Tiranë. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, dëgjesa me publikun, kontratë qiraje. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot.2634, datë 05.11.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Sipas pikës 10 të formularit informues nuk janë renditur masat me afatet dhe vlerësimet financiare përkatëse për zbatimin e programit/planit në bazë vjetore.

2.Mungon verifikimi në terren .

13.Subjekti M. sh.p.k(LC- 9...-10-2021) ka aplikuar për aktivitetin përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ, me vendndodhje në rrugën "Llazi Miho", Tiranë. Sipërfaqja është 6000 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, dëgjesa me publikun, kontratë qiraje. (Praktika është refuzuar për herë të fundit në datën 23.08.2021 nga AKM me arsyen: mungon dëgjesa me publikun dhe koordinatat e vaskës së dekantimit).

Mendim i ARM, Tiranë, Durrës, Dibër me nr.prot 2546, datë 27.10.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Mungon verifikimi në terren i pasqyruar në aktin e dhënies së mendimit .

14.Subjekti E.-L. sh.p.k(LC- 8...-09-2021) me aktivitet prodhim të ambalazhit të letrës dhe kartonave për produkte ushqimore dhe jo ushqimore me vendndodhje në rruga "Llazar Xhajanka",Tiranë. Kapaciteti është 20 ton në ditë. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B vetëm faqja e parë , pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, dëgjesa me publikun. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot 2444, datë 11.10.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Mungon verifikimi në terren i pasqyruar në aktin e dhënies së mendimit.

15.Subjekti A. sh.p.k(LC- 8...-09-2021) ka aplikuar për aktivitetin veprimtaritë e lyerjes/ veshjes të aplikuara në sipërfaqe druri, prodhim i mobiljeve, me vendndodhje në Prush, Vaqarr, Tiranë. Sipërfaqja është 826 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, dëgjesa me publikun. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot.2445, datë 11.10.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:
1. Data e dëgjesës me publikun (e paraqitur në aplikim nga subjekti) nuk përputhet me datën dhe orën e publikuar në ëebin e ARM Tiranë, Durrës, Dibër;
2.Sipas pikës 10 të formularit informues nuk janë renditur të gjitha masat me afatet dhe vlerësimet financiare përkatëse për zbatimin e programit/planit në bazë vjetore;
3.Mungon verifikimi në terren.
16.Subjekti T. D. sh.p.k(LC- 9...-11-2021) ka aplikuar për aktivitetin prodhimi i makinerive dhe pajisjeve, përpunimi dhe saldimi i metaleve, me vendndodhje në Kashar, Tiranë. Sipërfaqja totale është 4900 m2.Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, dëgjesa me publikun, dokument pronësie. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot 2827, datë 06.12.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.
Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:
1.Sipas pikës 1.6 të formularit informues subjekti nuk ka bashkëngjitur dokumentin e planifikimit të zonës ;
2.Sipas pikës 2 të formularit informues nuk është përshkruar mjaftueshëm instalimi;
3.Sipas pikës 10 të formularit informues nuk janë renditur të gjitha masat me afatet dhe vlerësimet financiare përkatëse për zbatimin e programit/planit në bazë vjetore;
4.Mungon verifikimi në terren.
17.Subjekti K.I. sh.p.k(LC- 4...-02-2021) ka aplikuar për aktivitetin minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to, me vendndodhje në Bulqizë. Sipërfaqja totale është 1.377km2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, dëgjesa me publikun.
ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot 2268, datë 21.09.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.
Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:
1.Proçesverbali i dëgjesës me publikun nuk është plotësuar sipas kërkesave të miratuar nga AKM, ku pjesëmarrësit të vetëdeklarojnë largësinë në metra nga subjekti;
2.Pika 1.6 e kërkesës për leje mjedisi tipi B nuk është plotësuar;
3.Subjekti ka ndryshuar formatin standart të formularit informues;
4.Sipas pikës 10 të formularit informues nuk janë renditur të gjitha masat me afatet dhe vlerësimet financiare përkatëse për zbatimin e programit/planit në bazë vjetore;
5.Mungon verifikimi në terren .
18.Subjekti K. sh.p.k(LC- 6...-05-2021) ka aplikuar për aktivitetin nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret, me vendndodhje në Macukull,Dibër. Sipërfaqja totale është 0.523 km2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, dëgjesa me publikun.
ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot 2267, datë 21.09.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.
Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:
1.Sipas pikës 10 të formularit informues nuk janë renditur të gjitha masat me afatet dhe vlerësimet financiare përkatëse për zbatimin e programit/planit në bazë vjetore;
2.Mungon verifikimi në terren.
19.Subjekti B. D. C. sh.p.k (LC- 3...-12-2020) ka aplikuar për aktivitetin institucionet shëndetësore, me vendndodhje në bulevardin "Gjergj Fishta", Tiranë. Në dosje aplikuesi ka

paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, dëgjesa me publikun, kontratë mbetjesh. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot. 203, datë 21.01.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Sipas pikës 1.6 të formularit informues, subjekti duhet të bashkëngjisë një dokument të planifikimit të zonës;

2.Pika ½ e formularit informues , " Informacion mbi instalimin", koordinatat e X , pika 3 dhe 4 kanë të njëjtën vlerë;

3.Sipas pikës 10 të formularit informues nuk janë renditur të gjitha masat me afatet dhe vlerësimet financiare përkatëse për zbatimin e programit/planit në bazë vjetore;

4.Mungon verifikimi në terren.

20.Subjekti E. N. sh.p.k(LC- 3...-12-2020) ka aplikuar për aktivitetin furnizimi me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane, me vendndodhje në rrugën "Selim Brahja", Tiranë. Sipërfaqja totale është 150 m2. Në dosje aplikuesi ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë; ekstrakti i QKB-së, kërkesë për leje mjedisi tipi B, pagesë tarife për leje mjedisi tipi B, raporti mbi sigurinë, kontratë mbetjesh. ARM, Tiranë, Durrës, Dibër në shkresën me nr.prot. 205, datë 21.01.2021 jep mendim pozitiv pas shqyrtimit të dosjes në mënyrë elektronike dhe verifikimit në terren.

Nga auditimi dosja rezultoi me mangësi:

1.Në faqen nr.1 të kërkesës për leje mjedisi Tipi B, subjekti përshkruan aktivitet fabrikë këpucësh ndërkohë që në aplikimin që ka dorëzuar pranë QKB-së (Qendra Kombëtare të Biznesit) kërkon për leje mjedisi për aktivitetin karburant;

2.Projekti i mbrojtjes së zjarrit është për aktivitetin shtypshkronjë dhe jo për karburant;

3.Sipas pikës 1.6 të formularit informues, subjekti duhet të bashkëngjisë një dokument të planifikimit të zonës;

4.Subjekti deklaron që është i pajisur me leje mjedisi Tipi C por nuk ka bashkëngjitur kopjen e lejes ekzistuese , shkresën e AKM, sipas shkronjës d, të urdhërit të Ministrit të Mjedisit nr.163, datë 16.06.2020 ;

5.Mungon raporti i vetmonitorimit;

6.Sipas pikës 10 të formularit informues nuk janë renditur të gjitha masat me afatet dhe vlerësimet financiare përkatëse për zbatimin e programit/planit në bazë vjetore;

7.Mungon dëgjesa me publikun.

Duke bërë krahasimin ndërmjet dy viteve, vërejmë se numri i mendimeve për leje mjedisi Tipi A/B është rritur, kjo si pasojë e ndryshimit të ligjit Nr.52/2020" Për lejet e mjedisit", ku instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat, në varësi të kapacitetit referuar shtojcës 1, të këtij ligji, klasifikohen si leje mjedisit të tipit B, aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Modeli tip i dhënies së mendimit për leje mjedisi Tipi A/B është miratuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit , ku në pikën 6 citohet "*Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër pas shqyrtimit të dosjes elektronike dhe /ose verifikimit në terren për aktivitetin….. jep mendimin e saj pozitiv /negativ në lidhje me aplikimin*".

Nga auditimi u konstatua se 38 dosjet e evidentuara rezultojnë të jenë me mangësi në dokumentacion, ndërsa mendimet përkatëse të Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër kanë qenë pozitive.

Gjithashtu nga ana e Agjencisë Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër nuk është kryer verifikimi në terren. Referuar proçesverbaleve të mbajtura gjatë vitit 2020 për verifikimin në terren të instalimit, konstatohet se janë mbajtur pa numër protokolli.

Nga auditimi rezultoi senga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër nuk është mbajtur një rregjistër me të dhënat për lejet e mjedisit Tipi A dhe B, që ndodhen brenda territorit të tyre, nuk është koordinuar me Qendrën Kombëtare të Biznesit, për vendimet e marra nga Ministri i Mjedisit, kjo në kundërshtim me pikën 5 dhe 9 të kreut VII të rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Nr. 120 prot., datë 12.01.2021**.**

Theksojme se mungesa e këtij rregjistri ka sjellë si pasojë mosplanifikimin e planit vjetor të inspektimeve.

Konkluzione :

1.Nga auditimi rezultoi se mendimet për leje mjedisi Tipi A dhe B janë dhënë në mënyrë jo profesionale. Të gjitha praktikat e audituara kanë qenë me mangësi në dokumentacion dhe pavarësisht kësaj mendimet nga ana e ARM Tiranë, Durrës, Dibër janë dhënë pozitive, veprime këto që bien ndesh me VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 dhe me pikën 5 dhe 9 , kreun VII të rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Nr.120 prot., datë 12.01.2021 "Rregullore e brendshme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit".

- **Konsultime me publikun**

Në bazë të VKM Nr. 419 , datë 25.06.2014 " Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri , të kushteve për lejet respektive të mjedisit , si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL", kreu VI , Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të delegojë ARM për të marrë pjesë në proçedurën e konsultimit me publikut. Subjekti kur aplikon për tu pajisur me leje mjedisi Tipi A/B duhet të dorëzojë edhe relacionin e dëgjesës me publikun në Qendrën Kombëtare të Biznesit .

- **Konsultimet e realizuara nga ARM Tiranë, Durrës, Dibër gjatë vitit 2020**

Gjatë vitit 2020 janë realizuar 83 konsultime me publikun nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Qarku, Tiranë, Durrës, Dibër.

Nga grupi i auditimit u përzgjodhën procedurat e konsultimeve si më poshtë:

Nr.rendor	Subjekti	Aktiviteti	Vendndodhja	Delegimi i konsultimit nga AKM	Data e zhvillimit të konsultimit me publikun
1.	D. O.	Thertore	Synej, Kavajë	21.12.2020	29.12.2020, ora 12:00
2.	K. sh,p.k	Ndërtim Hec Shini	Përroi i Bizës dhe Valit , Bashkia Mat	18.12.2020	28.12.2020, ora 12:00
3.	D. sh,p.k	Stacion transferimi i mbetjeve jo të rrezikshme	Krujë	18.12.2020	23.12.2020, ora 12:00
4.	P. sh.a	Përpunim metali	Rruga "Rinia", Durrës	16.10.2020	23.10.2020, ora 11: 00
5.	D. 3. sh.p.k	Shfrytëzim kromi	Krastë, Bulqizë	09.10.2020	13.10.2020, ora 11:00
6.	H. sh.p.k	Shfrytëzim kromi	Bulqizë	05.10.2020	07.10.2020, ora 11:00
7.	Sh. I. sh,p.k	Ndërtim montim i linjës 220 kë	Bashkia Dibër	23.09.2020	28.09.2020, ora 12:00
8.	A. sh,p.k	Shfrytëzim kromi me galeri nëntokësore	Bulqizë	04.09.2020	10.09.2020, ora 10:00.
9.	S. W. sh.p.k	Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike	Rruga " Vangjel Ceco", Tiranë	27.08.2020	10.09.2020, ora 11:30
10.	D. V.	Shfrytëzim mineral gëlqeror të mermerizuar	Macukull	21.08.2020	27.08.2020, ora 10:00
11.	F. P. sh.p.k	Impiante të pastrimit të kromit	Bulqizë	18.08.2020	21.08.2020, ora 10:00
12.	A. sh.p.k	Riparim i automjeteve	Maminas, Shijak	27.07.2020	30.07.2020, ora 12:00
13.	R.B.	Veprimtari që përdorin solvent , saldim, prodhim	Rruga nacionale "Plepa-Ndroq", Tiranë	14.08.2020	19.08.2020, ora 11:30

		makineri			
14.	C.	Riparim, mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve	Yzberisht, Tiranë	14.08.2020	20.08.2020, ora 12:00

- **Gjatë vitit 2021 janë realizuar 354 konsultime me publikun nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Qarku, Tiranë, Durrës, Dibër.**

Nr.rendor	Subjekti	Aktiviteti	Vendndodhja	Delegimi i konsultimit nga AKM	Data e zhvillimit të konsultimit me publikun
1.	F. sh.p.k	Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane, gaz natyror (GLN)	Bashkia Klos, Qarku Dibër	28.12.2021	10.01.2022, ora 11:00
2.	R. sh.p.k	Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane, gaz natyror (GLN)	Lagjja "Partizani", Burrel , Dibër	11.11.2021	16.11.2021, ora 11:00
3.	S. Xh. sh.p.k	Rritje intensive e shpendëve në një instalim	Kavajë	04.11.2021	18.11.2021, ora 11:00
4.	D. sh.p.k	Ndërtim e funksionim Hec Ljusa	Afër fshatit Vinjol, ,Bashkia Mat, Qarku Dibër	03.12.2021	14.12.2021, ora 11:00
5.	Gj.B.	Përpunim druri	Shkozet, Durrës	03.12.2021	09.12.2021, ora 12:00
6.	A.B. sh.p.k	Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme	Vorë, Qarku Tiranë	14.12.2021	19.12.2021, ora 11:00
7.	G.L.sh.p.k	Institucione shëndetësore	Rruga nacionale "rruga e Kavajës" , Tiranë	12.07.2021	21.07.2021, ora 12:00 .
8.	L. n. sh.p.k	Institucione shëndetësore	Pranë QSUT Nënë Tereza, Tiranë	13.12.2021	21.12.2021, ora 11:00
9.	I. L. sh.p.	Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve	Prush, Tiranë	04.11.2021	11.11.2021, ora 10:00
10.	O.sh.p.k	Industri energjitike	Rruga "e Dibrës" , Tiranë	16.10.2021	10.11.2021, ora 10:00(është plotësuar afati 15 ditor i qëndrimit në ëeb i njoftimit)
11.	K.I.sh.p.k	Institucione shëndetësore	Rruga "Kongresi i Manastirit", Tiranë	05.07.2021	22.07.2021, ora 09:30(është plotësuar afati 15 ditor i qendrimit në ëeb)
12.	B.T. sh.p.k	Furnizim me karburant	Fshati Mucaj, Tiranë	07.07.2021	15.07.2021, ora 10:30

Çdo praktikë konsultimi me publikun kishte bashkëlidhur:
-e-mailin e ardhur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për delegimin e konsultimit;
-relacionin e dëgjesës me publikun;
-akt verifikimin e mbajtur nga ana e specialistëve të ARM Tiranë, Durrës, Dibër.
Nga auditimi u konstatua se konsultimet me publikun janë realizuar në një afat të shkurtër (5-7 ditë) nga delegimi i konsultimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit. Në akt verifikimet e mbajtura nga ana e specialistëve është përshkruar në proçesverbal që pjesëmarrësit në konsultimet nuk kanë patur ankesa/shqetësime për instalimin për të cilën është kryer konsultimi.
Ndërsa njoftimi në faqen e ëebit http://drmtirane.akm.gov.al përban të dhëna si; data e takimit/ subjekti/vendi i takimit.
Theksojmë se për vitin 2020 konsultimet me publikun nuk janë protokolluar, kjo në kundërshtim me ligjin "Për arkivat" dhe "Normat tekniko- profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", Neni 12 dhe 13. Konsultimet e pa protokolluara janë përcjellë nëpërmjet e-mailit Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.
Konkluzione:
1.Nga ana e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas Vendimit Nr. 419, datë 25.6.2014 " Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A,

B , për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e tyre", kreu VI " Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të tipit A dhe B , pika 10 ; ku përcaktohet se : "*Njoftimi për dëgjesën me publikun shpallet gjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve:c) në tabelën e njoftimeve, në një vend të dukshëm në mjediset e NJQV-së dhe ARM-së së qarkut përkatës*".

Për sa më lart, të gjitha proçedurat e konsultimit me publikun janë realizuar në një afat të shkurtër (5-7 ditë) nga delegimi i konsultimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

2.Njoftimi në faqen e ëebit http://drmtirane.akm.gov.al nuk përmban të dhënat e mëposhtme;

-Lloji e instalimit / veprimtarisë;

-Adresa e vendndodhjes së kompanisë .

Veprime që bien në kundërshtim me Vendimin Nr. 419, datë 25.6.2014 " Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B , për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri , të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e tyre" Kreu VI " Informimi dhe pjesëmarrja e publikut për aplikimin për leje mjedisi të Tipit A dhe B, pika 11 ku përcaktohet se ; *Njoftimi duhet të shoqërohet me: a) llojin e instalimit/veprimtarisë; b) emrin e personit fizik/juridik; c) adresën e vendndodhjes së instalimit;*

ç) vendin ku gjendet kopja e njoftimit në NJQV-në dhe adresën elektronike të AKM-së ku është publikuar njoftimi. dh) përcaktimin e vendit, të datës dhe orës së organizimit të dëgjesës me publikun

Lidhur sa trajtuar në Akt-Konstatimin nr. 3, datë 31.03.2021, për të cilin në fazën e hartimit të projekt raportit, janë paraqitur observacione .

1.Nga **znj.A. M.** është paraqitur observacion ndaj akt konstatimit Nr.3 , lidhur me shqyrtimin e lejeve mjedisore për subjektet O., F. P., F.P. si dhe konsultimet me publikun për subjektet L. N., I.L., O., ku pretendon se shqyrtimi i dokumentacionit për leje mjedisi Tipi A/B është kompetencë e AKM , praktika e F.P. (LC 7...-06-2021) nuk ka qenë objekt shqyrtimi nga ana e saj si dhe kundërshton shkeljen e afateve për konsultimet.

Qëndrimi i grupit auditues: Pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, grupi i auditimit merr në konsideratë dhe ka bërë edhe ndryshimet përkatëse:

-Është paraqitur kontrata e qirasë e subjektit O.(LC-9...-11-2021) dhe plotësimi i afatit 15 ditor të afishimit të dëgjesës në ëeb për subjektin O. sh.p.k.

Ndërsa për kontestimet e tjera të paraqitura në observacion, grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë mbasi:

1.Relacioni i dëgjesës me publikun realizohet sipas pikës 12, kreu VI, të VKM Nr. 419 , datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subject tek tjetri , të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL", ndërsa verifikimi në terren për subjektin përfshin: vlerësimin e operacioneve të kryera në veprimtarinë e dhënë, kontrollin e mjediseve dhe të pajisjeve, kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë etj, sipas nenit 63, pika e, ë, f, të ligjit me Nr. 10 431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit".

2.Sipas rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një nga detyrat e specialistit të lejeve mjedisore është edhe shqyrtimi i dokumentacionit për aplikimet për leje mjedisore A / B.

3.Subjekti me LC-7...-06-2021 (akti i dhënies së mendimit me nr.prot.2081, datë 02.09.2021) është hartuar nga znj.A. M .

2. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr..*155/2datë 08.04.2022*,datë"Mbi Projektraportin e Auditimit" nga **znj.M .L** është paraqitur observacion ndaj akt konstatimit Nr.3 , lidhur me shqyrtimin e lejeve mjedisore për subjektet A. B., S. G, M., si dhe konsultimet me publikun për subjektet G. L., L. N., I.L., O., K. I., ku pretendon se shqyrtimi i dokumentacionit për leje mjedisi Tipi A/ B nuk është kompetencë e ARM si dhe kundërshton shkeljen e afateve për konsultimet e realizuara.

Qëndrimi i grupit auditues: Pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, grupi i auditimit merr në konsideratë dhe ka bërë edhe ndryshimet përkatëse:

1. Plotësimi i afatit 15 ditor të afishimit të dëgjesës në ëeb për subjektet O. dhe K. I.

Ndërsa për kontestimet e tjera të paraqitura në observacion , grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë mbasi ;

1.Relacioni i dëgjesës me publikun realizohet sipas pikës 12, kreu VI, të VKM Nr. 419 , datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subject tek tjetri , të kushteve për lejet respective të mjedisit , si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL", ndërsa verifikimi në terren për subjektin përfshin: vlerësimin e operacioneve të kryera në veprimtarinë e dhënë, kontrollin e mjediseve dhe të pajisjeve, kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë eti, sipas nenit 63, pika e, ë, f të ligjit me Nr. 10 431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit". 2. Sipas rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një nga detyrat e specialistit të lejeve mjedisore është edhe shqyrtimi i dokumentacionit për aplikimet për leje mjedisore A/ B.

3. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr..*155/2datë 08.04.2022*,datë"Mbi Projektraportin e Auditimit" nga **z. R. Xh.** është paraqitur observacion ndaj akt konstatimit Nr.3 , lidhur me shqyrtimin e lejeve mjedisore për subjektet E. L. , A., T. D. si dhe konsultimet me publikun për subjektet G.L., K.I., ku pretendon se shqyrtimi i lejeve mjedisore nuk është kompetencë e ARM dhe kundërshton shkeljen e afateve për konsultimet.

Qëndrimi i grupit auditues: Pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, grupi i auditimit merr në konsideratë dhe ka bërë edhe ndryshimet përkatëse:

1.Është paraqitur formulari informues për subjektin E. L.(LC-9...-11-2021) dhe dëgjesa me publikun për subjektin K. I. sh.p.k është realizuar brenda kuadrit ligjor.

Ndërsa për kontestimet e tjera të paraqitura në observacion , grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë mbasi :

1.Relacioni i dëgjesës me publikun realizohet sipas pikës 12, kreu VI, të VKM Nr. 419 , datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subject tek tjetri , të kushteve për lejet respektive të mjedisit , si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL", ndërsa verifikimi në terren për subjektin përfshin: vlerësimin e operacioneve të kryera në veprimtarinë e dhënë, kontrollin e mjediseve dhe të pajisjeve, kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë eti, sipas nenit 63, pika e, ë, f të ligjit me Nr. 10 431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit".

2.Sipas rregullores së brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, një nga detyrat e specialistit të lejeve mjedisore është edhe shqyrtimi i dokumentacionit për aplikimet për leje

mjedisore A dhe B.

4. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr..*155/2datë 08.04.2022*,datë"Mbi Projektraportin e Auditimit" nga **znj.M .H.** është paraqitur observacion ndaj akt konstatimit Nr.3 , lidhur me shqyrtimin e lejeve mjedisore për subjektet C. , Sh., S. , E. O., S. W., A. M., ku pretendon se ARM nuk është kompetente për shqyrtimin e lejeve mjedisore A dhe B .

Qëndrimi i grupit audites: Pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë kontestimet e bëra mbasi:

1.Referuar VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të posaçme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL", ARM duhet të japin mendimin e tyre profesional me shkrim .

5. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr..*156/2datë 08.04.2022*,datë"Mbi Projektraportin e Auditimit" nga **znj.M. S.**është paraqitur observacion ndaj akt konstatimit Nr.3, lidhur me shqyrtimin e lejeve mjedisore/VNM paraprake /të thelluar për subjektet A.S.C., A.G., A. C., A., A. K., A.St., A. T. , Sh. sh.p.k , C. , A.M, N. K. si dhe konsultimet me publikun për subjektet D. O., D. , P. sh.a, S. Xh., Gj. B., A. B, ku pretendon se shqyrtimi i dosjeve nuk është kompetencë e ARM , si dhe kundërshton shkeljen e afateve për datën e konsultimit.

Qëndrimi i grupit audites: Pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, grupi i auditimit merr pjerërisht në konsideratë kontestimet e bëra për caktimin e datave për konsultimet me publikun dhe për formatin tip të verifikimit të VNM-ve. Përsa i përket kontestimit e bërë për formatin tip të verifikimit të raporteve të VNM-vë , dërguar nga përgjegjësi i lejes mjedisore me e-mail - specialistëve theksojmë :

Bazuar në ligjin Nr. Ligjin Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" , neni 43

1. Nëpunësi civil mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij, gjatë ushtrimit të detyrës në shërbimin civil.

3. Nëse nëpunësi civil ka dyshime për paligjshmërinë e urdhrit të eprorit, ai nuk e zbaton urdhrin, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.

Nga ana e specialistëve të lejeve mjedisore, nuk është informuar drejtuesi i institucionit për parregullsinë e formatit të akt verifikimit të VNM –ve (proçesverbalet gjatë vitit 2020 janë mbajtur pa numër protokolli) .

6.Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr..*154/2datë 08.04.2022*,datë"Mbi Projektraportin e Auditimit"nga **z.I. N.** është paraqitur observacion ndaj akt konstatimit Nr.3, lidhur me verifikimin e subjekteve për subjektet A. K., A. P., ku pretendon se formati i akt verifikimit i miratuar nga organi epror nuk kishte vend për numrin e protokollit.

Qëndrimi i grupit audites: Pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, grupi i auditimit e merr pjesërisht në konsideratë. Përsa i përket kontestimit e bërë për formatin tip të verifikimit të raporteve të VNM-vë , formati është dërguar nga përgjegjësi i lejes mjedisore me e-mail specialistëve dhe nuk është i miratuar nga drejtuesi i institucionit ose organi epror.

Bazuar në ligjin Nr. Ligjin Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" , neni 43

1. Nëpunësi civil mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij, gjatë ushtrimit të detyrës në shërbimin civil.

3. Nëse nëpunësi civil ka dyshime për paligjshmërinë e urdhrit të eprorit, ai nuk e zbaton urdhrin, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.

Nga ana e specialistëve të lejeve mjedisore, nuk është informuar drejtuesi i institucionit për parregullsinë e formatit të akt verifikimit të VNM –ve (proçesverbalet gjatë vitit 2020 janë mbajtur pa numër protokolli)

7. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.*.155/2datë 08.04.2022*,datë"Mbi Projektraportin e Auditimit" nga **z.Xh. B. dhe z. Sh.S.** është paraqitur observacion me e-mail ndaj akt konstatimit Nr.3 , lidhur me verifikimin e subjekteve për subjektet A.M., D.V., A. S., si dhe shqyrtimin e lejeve mjedisore N., K.I. 2012, K. si dhe konsultimet me publikun për subjektet K., D., H., Sh. I. A., D.V., F. P. , F. , R., D., ku pretendon se; formati tip është dërguar nga zyra e sektorit të lejeve mjedisore, shqyrtimi i dokumentacionit për leje mjedisi Tipi A/ B nuk është kompetencë e ARM, si dhe dëgjesat me publikun nuk janë përcjellë me e-mail, së bashku me datën që ka ardhur nga AKM.

Qëndrimi i grupit auditues: Pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, grupi i auditimit merr pjesërisht në konsideratë modelin e formatit të verifikimit të raportit të VNM, konsultimet me një specialistë lejesh mjedisore. Përsa i përket kontestimit e bërë për formatin tip të verifikimit të raporteve të VNM-vë , dërguar nga përgjegjësi i lejes mjedisore me e-mail -specialistëve theksojmë:

Bazuar në ligjin Nr. Ligjin Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" , neni 43

1. Nëpunësi civil mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij, gjatë ushtrimit të detyrës në shërbimin civil.

3. Nëse nëpunësi civil ka dyshime për paligjshmërinë e urdhrit të eprorit, ai nuk e zbaton urdhrin, por informon pa vonesë eprorin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin e tij me shkrim.

Nga ana e specialistëve të lejeve mjedisore, nuk është informuar drejtuesi i institucionit për parregullsinë e formatit të akt verifikimit të VNM –ve (proçesverbalet gjatë vitit 2020 janë mbajtur pa numër protokolli)

Përsa i përket pretendimit se nuk është përcjellë e-maili i AKM për konsultimet nuk qëndron pasi , nga auditimi rezultoi, se verifikimet që janë mbajtur në ditën e konsultimit, nga specialistët është shënuar edhe data e ardhjes së konsultimit nga AKM.

8. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.*155/2datë 08.04.2022*,datë"Mbi Projektraportin e Auditimit"nga **z.Xh.H** është paraqitur observacion me Nr.155/2, datë 08.04.2022 ndaj akt konstatimit Nr.3 , ku pretendon se drejtuesi i institucionit sipas rregullores së brendshme nr.120, datë 12.01.2021, nuk është përgjegjës për publikimin në ëeb të VNM-së.

Qëndrimi i grupit auditues: Pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, grupi i auditimit nuk e merr në konsideratë. Sipas rregullores Nr.1, datë 3.03.2017 të AKM, drejtuesi i institucionit cakton personin përgjegjës për publikimin e VNM-së në ëeb e ARM Tiranë, Durrës, Dibër. Përsa më lart drejtuesi i institucionit nuk ka caktuar person përgjegjës për të kryer publikimin në ëeb të VNM-ve.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr.***155/6****2datë* ***30.05.2022***,datë"Mbi Projektraportin e Auditimit" nga nga **z.R. Xh., znj.A.M. ,znj.M. L, znj. M. S.**, është paraqitur observacion lidhur me shqyrtimin e lejeve mjedisore A/B , verifikimin në terren për verifikimin e instalimit/ raporteve të VNM, si dhe afatet për dëgjesat me publikun ku pretendojnë se;

1.verifikimet në terren për raportet e VNM-së dhe verifikimet për instalimet për leje mjedisi Tipi A/B nuk janë realizuar duke marrë parasysh mjetet logjistike që Agjencia Rajonale e Mjedisit disponon, titullari i institucionit nuk ka lëshuar autorizim për verifikimin në subjekt;
2.ARM nuk është përgjegjëse për shqyrtimin e dosjeve për leje mjedisi Tipi A/B;
3.Realizimi i dëgjesave në një afat 3-5 ditë ka ardhur si pasojë e autorizimeve që janë realizuar nga drejtuesi i institucionit dhe se ARM është palë pjesëmarresë në dëgjesë;
4. formatin tip të verifikimit në terren.

Qëndrimi i grupit auditues: Pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, grupi i auditimit nuk i merr në konsideratë kontestimet e bëra, pasi veprimet e tyre bien ndesh me VKM Nr.419, datë 25.06.2014, rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me nr.120 prot., datë 12.01.2021 dhe me nenin 4, pika 5 të Vendimit Nr. 4, datë 19.6.2017 " Për miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë"

Gjetje nga auditimi: Mospërmbushje e detyrave në dhënien e mendimit për VNM paraprake/të thelluar/ leje mjedisi Tipi A dhe B.

Situata: Shqyrtimi i praktikave me Nr. rendor 1, 3, 5, 7, 12, 15, 18, 19, (shqyrtimi i VNM-ve gjatë vitit 2020) dhe praktikat me numër rendor 1-25 (shqyrtimi i VNM –ve gjatë vitit 2021), janë bërë në mënyrë elektronike dhe nuk është kryer verifikimi në terren.

Kriteri: Ligji Nr. 10 431, datë 09.06.2011 " Për mbrojtjen e mjedisit" nenin 63 , pika 6.

Efekti : Nuk janë ruajtur objektivat e mbrojtjes së mjedisit si:
a) parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
b) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;

Shkaku: Mungëse objektivash për mbrojtjen e integruar të mjedisit.

Rëndësia : E mesme

Rekomandimi: Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë , Durrës, Dibër të marrë masa për verifikimin në terren të raporteve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) me qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë si dhe përdorimin e matur dhe racional të natyrës nga ana e veprimtarisë që aplikon për tu pajisur me vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM) .

Gjetje nga auditimi: Modeli i dokumentit/shkresës për marrjen e mendimit nga njësitë e qeverisjes vendore është hartuar/përpiluar nga ARM Tiranë, Durrës, Dibër.

Situata: Mendimet për VNM me numër rendor 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20,(viti 2020) dhe praktikat me numër rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20 (viti 2021).

Kriteri: Vendimin Nr. 686, datë 29.7.2015 " Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afatave për zhvillimin e proçedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe proçedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", kreu 4.

Efekti: Moskryerje e detyrave sipas VKM nr.686, datë 29.07.2015

Shkaku: Moszbatim i legjislacionit në fuqi

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër të marrë udhëzimet përkatëse nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për marrjen e mendimit njësive të qeverisjes vendore.

-Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër , të marrë masa që specialistët e lejeve mjedisore të aplikojnë në sistemin e-albania, për tu pajisur me nënshkrim elektronik, me qëllim plotësimin e strukturës së dokumentit elektronik.

Gjetje nga auditimi: Mendimet për leje mjedisi Tipi A/B kanë rezultuar me mangësi në dokumentacion dhe nuk është kryer verifikimi në terren.

Situata: Aplikimet për lejet mjedisore me numër rendor 1, 2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16, 17,18, (viti 2020) dhe praktikat me numër rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,15,16,17,18,19,20(viti 2021), nga auditimi kanë rezultuar me mangësi në dokumentacion.

Kriteri : VKM Nr.419, datë 25.06.2014 dhe rregullorja e brendshme e Agjencisë Kombëtare e Mjedisit me Nr. prot.120, datë 12.01.2021 dhe neni 63, pika e, ë, f të ligjit me Nr. 10 431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e Mjedisit".

Efekti: Si pasojë e mos shqyrtimit të dokumentacionit/verifikimit në terren të lejeve mjedisore Tipi A/B, nuk është parandaluar, pakësuar dhe mbajtur nën kontroll ndotja e shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës.

Shkaku: Moszbatim i legjislacionit në fuqi

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Agjencia Rajonale e Mjediist Tiranë Durrës, Dibër të marrë masa që të shqyrtojë aplikimet për Leje mjedisi Tipi A dhe B në respektim të kritereve dhe kërkesave të legjislacionit në fuqi, duke përfshirë kontrollin e rregullshmërisë nga pikëpamja ligjore e dokumentacionit dhe verifikim në terren të instalimit.

Rëndësia : E lartë

Gjetje nga auditimi: Proçedura e dorëzimit të raporteve të monitorimit

Situata: Si pasojë e nxjerrjes së urdhërit Nr.77, datë 02.07.2020 të drejtorit të AKM, subjektet që janë të pajisur me leje mjedisi tipi A dhe B dorëzojnë pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit raportet e vetmonitorimit.

Kriteri: Vendim Nr. 568, datë 17.7.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ", pika 6 c;

Efekti : Sektori i monitorimit pranë ARM-ve nuk i ushtron detyrat e tij funksionale , si pasojë e urdhërit nr. 77 datë 02.07.2020 të drejtorit të AKM .

Shkaku: Moszbatim i legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Mjedisit të shfuqizojë urdhërin Nr.77, datë 02.07.2020 "Procedurën e dorëzimit të raporteve të vetmonitorimit" dhe subjektet të dorëzojnë raportet e vetmonitorimit pranë ARM-ve përkatëse.

Gjetje nga auditimi: Caktimi i datës dhe publikimi në ëeb i njoftimeve për dëgjesat me publikun

Situata: Në praktikat me numër rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14(viti 2020) dhe praktikat me numër rendor 1,2,3,4,5,6,7,8,9,12 (viti 2021) konsultimet janë realizuar në një afat 5-7 afat të delegimit të e-mailit nga Agjencia Kombetare e Mjedisit .

Kriteri: VKM Nr.419 , datë 25.06.2014 kreu i VI "Informimi i publikut"

Efekti: Pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjesën me publikun ka qenë e ulët.

Shkaku: Moszbatim i legjislacionit në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë , Durrës, Dibër të marrë masa që njoftimi i dëgjesës me publikun të qëndrojë i publikuar në ëebin zyrtar përgjatë afatit 15 ditor, me qëllim njoftimin, sensibilizimin dhe informimin e sa më shumë pjesëmarrësve në takim.

-Në zbatim të pikës 4.Auditim mbi dokumentacion e mbajtur, zbatimi i procedurave përkatëse,për shkeljet e konstatuara dhe masat e marra vërejtje, këshillime, paralajmërime, sanksione gjoba nga inspektimet në terren.

- *Organizimi dhe funksionimi, misioni dhe kriteret mbi të cilat bazohet veprimtaria e ARM Tiranë,Durrës,Dibër.*

- Referuar VKM-së nr. 568,datë 17.07.2019 **"**Për krijimin ,mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" dhe Urdhrit nr. 23,të Kryeministrit, datë 03.02.2020 " Për miratimin e strukturës dhe organikës së AKM-së.Ky auditim ka pasur si mision auditimin e, përputhshmërisë dhe financiere sistemin organizativ të funksionimit të mjedisit, ujërave dhe monitorimit, në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër. Veprimtaria e kësaj strukture bazohet në Ligjin Nr. 53/2020 " Për disa ndryshime të Ligjit Nr. 10431, date 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit, "i ndryshuar, Ligji Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Ligjit Nr. 52/2020 "Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit". Ligji nr. 10433, dt 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" Ligj Nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", Ligji Nr. 6/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 111/2012", Ligj Nr. 9115 dt. 24.07.2003 "Për trajtimin e ujërave të ndotura" të ndryshuar, Ligj Nr. 8905, datë 06.06.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit detar, Ligji Nr. 9103, datë 10.07.2003 "Për mbrojtjen e Liqeneve Ndërkufitare" i ndryshuar.
AKM është përgjegjëse për çdo funksion apo kompetencë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit që përfshin fushën e mjedisit, ujërave duke ushtruar juridiksionin e vet brenda kompetencës territoriale dhe lëndore që ajo mbulon.

- Për kryerjen e inspektimeve dhe për plotësimin e misionit të këtij institucioni në fushën e mbrojtjes ,mbështetur në kriteret e vlerësimit që burojnë nga kuadri rregullator në fuqi (ligjit nr. 10279 datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet Administrative",ligjit nr. 10433 datë 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 10431 datë 9.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" i ndryshuar, ligjit nr. 10488 datë 14.07.2011 "Për lejet mjedisore" i ndryshuar, VKM-së nr.568,datë 17.07.2019 **"**Për krijimin,mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit"si dhe rregullores së Brendshme nr. 120 datë 19.01.2021,"Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të mjedisit të mjedisit dhe ujërave në nivel rajonal.

-Me Urdhër të Brendshëm Nr.29, datë 21.10.2020 në zbatim të Urdhrit Nr.28, datë 28.10.2020 "Për bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e protokolleve të sigurisë në kuadër të task- forcës anti COVID-19" janë ngritur grupet e punës të përbërë nga specialist, inspektor të Sektorëve të Inspektimit Mjedisor, Monitorimit, Inspektimit të Burimeve Natyrore (Ujërave) dhe Informacionit dhe Përpunimit të Dhënave Tiranë.

Fusha veprimtarisë së institucionit ,

- Kryerjen e inspektimeve dhe plotësimi misionit të këtij institucioni në fushën e mbrojtjes Objektivat e Sektorit të Inspektimit Mjedisor janë ,

1. Të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm mbi mjedisin dhe ndaj veprimtarive me ndikim në mjedis, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet forcimit të zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe kërkesave të vendosura në lejen mjedisore.
2. Të siguroje zbatimin dhe kontrollin e zbatimit te detyrave të lëna që rregullojnë veprimtarinë ne fushën e inspektimit te mjedisit.
3. Të përgatisë raporte për drejtuesin e tij të drejtpërdrejt, si dhe në rastet kur nga shkelja janë cenuar të drejta apo interesat e ligjshëm te një personi të trete, përgatitin njoftimin për personin e trete për këtë fakt, gjetjet e inspektimit dhe masat e marra.
4. Të marrë pjesë në inspektime të përbashkëta dhe bashkërendojë punën me inspektoratet e tjera shtetërore, si dhe institucione shtetërore në varësi të ministrive të linjës, bazuar në marrëveshjet e përbashkëta të miratuara, duke evidentuar problematikat dhe

nëpërmjet masave detyruese komplekse të ndërmarra nga secili institucion kontrollues në zbatim të kompetencave përkatëse ligjore jepet zgjidhja e këtyre problemeve, si dhe raporton dhe bën publike rezultatet e inspektimit.

5. Merr pjese në grupe pune, si dhe jep mendime të ndryshme në lidhje me sektorin përkatës.

Sektori i inspektimit mjedisor ka në përbërje të tij një përgjegjës dhe 8 inspektorë dhe sektori i ujërave 1 përgjegjës dhe tre specialistë.

-Për periudhën objekt auditimi 6/mujoi i dytë 2020 dhe viti 2021 nga Sektori i Mjedisit janë hartuar dhe janë miratuar plane pune nga Drejtori AKM-së, por në asnjë rast nga ***Inspektorati Qendror Tiranë.***

Për 6-mujorin e dytë Korrik-Dhjetor 2020 janë kryer inspektime për 3 muaj e dytë ,nga ku rezultoi se programet janë hartuar në mungesë të treguesit sasior.Janë hedhur në portalin o-nline 88 autorizime. Inspektimet janë kryer vetëm për muajt Gusht shtator dhe Tetor , në muajin nëntor 2020 janë ndërprerë inspektimet në zbatim të urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale nr. 156 datë 10.03.2020"Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së pandemisë të shkaktuar nga Covid-19"dhe urdhrit të Kryeinspektorit të Përgjithshëm nr. 28 datë 21.10.2020"Për bashkërendimin e inspektimeve për zbatimin e protokolleve të sigurisë në kuadër të tas forcës , anticovid-19, pika 1 e urdhrit të sipërcituar. Kjo situatë ka vazhduar për periudhën nëntor - dhjetor 2020.Për periudhën objekt auditimi ARM nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të llastuara sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun Tiranë, Durrës dhe Dibër, mbështetur në këto të dhëna të bëhej identifikimi i subjekteve dhe veçimi i atyre me risk të lartë e ndikim në mjedis. Kjo në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe detyrimeve që rrjedhin nga Urdhrat e Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.04.2015 *"Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë* "dhe nr. 4datë 19.02.2015*"Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut".*

Sektori i Ujërave:

Në zbatim të pikave të programit të auditimit nr.155/1, datë 14.02.2022, nga grupi i auditimit të KLSH-së kërkuar sektorit Ujërave miratimin e planeve vjetore dhe ato mujore ,na u paraqit vetëm plani për vitin 2020 i miratuar nga z. Xh.H, Drejtori i Komanduar me përshkrim të çështjeve që do të auditohen, nuk na u vu në dispozicion planet punës të programuara dhe të realizuar për periudhën objekt auditimi nuk është realizuar asnjë inspektim. Për mos angazhim të sektorit ,mos realizim të inspektimeve në këtë sektorë, mbanë përgjegjësi Drejtori i ARM-së, pasi ka anashkaluar në kundërshtim me ligjin inspektimet në sektorin e ujërave si një sektor i rëndësishëm i këtij institucioni. Sektor ka në përbërje përgjegjës sektori dhe 3 specialistë , për mos hartim programi mujore të këtij sektori mban përgjegjësi z. K.K në cilësinë e përgjegjësit të sektorit si dhe titullarët Tre inspektorët e këtij sektori për periudhën objekt auditimi janë angazhuar në sektorë tjerë.

a. Nga sektori i mjedisit nuk janë përmbushur synimiet e inspektimit, pasi sektori i inspektimit të mjedisit nuk ka hartuar programet vjetore dhe mujore të inspektimit mbështetur në metodologjinë e vlerësimit të riskut duke përcaktuar numrin e akteve të inspektimit dhe subjektet e inspektimit, si dhe të krijojë bazë të dhënash të plota të subjekteve, të pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis, mbi bazën e të cilave të hartojë programet vjetore dhe mujore te inspektimit.Për vitin 2020,nga Drejtoria e inspektim-kontrollit pranë AKM është hartuar dhe miratuar nga Ministri i MTM-së me nr.5467 prot datë 30.07.2020 ,programi i punës së inspektimit në mjedis për periudhën gusht-dhjetor 2020 dhe programi tematik i punës së sektorit të ujerave për këtë periudhë. Këto programe janë hartuar mbi bazën e objektivave me qëllim realizimin e politikave të MTM.Janë përcaktuar dhe tematikat e inspektimeve por nuk është përcaktuar treguesi sasior i inspektimeve, kjo parashikuar në nenin 4 të udherit nr. 5 datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë për programimin e inspektimeve "Të Inspektorit të

Përgjithshëm ku në pikën 2 citohet: "*Programi vjetor I inspektimit, planifikon në mënyrë sasiore aktet e inspektimit duke u bazuar* "ne pikën 3.a citohet: "*Programi vjetor i inspektimeve bëhet mbi bazë tematike dhe ka për qëllim planifikimin sasior të akteve të inspektimit dhe përcaktimin e tematikave të inspektimit gjatë vitit"*.Nga drejtori i ARM Tiranë, Durrës e Dibër, mbështetur mbi programet e cituara më lart me nr.22prot. datë 05.05.2020, është hartuar programi i punës për periudhën korrik-dhjetor 2020 Edhe në këtë plan mungon treguesi sasior i inspektimeve.

ARMTiranë,Durrës,Dibër,gjatë periudhën objekt auditimi ka pasur Strukturë të paqëndrueshme inspektorësh, karakterizuar me lëvizje të inspektoreve sipas urdhrave të brendshëm të inspektoreve për kryerjen e inspektimeve.

-Theksojmë së në asnjë rast nuk janë hartuar planet mujore sipas formatit të kërkuar nga Inspektoratin Qendrore.

-Nuk është kryer analizimi mujore mbi realizimin e inspektimeve sanksionet e vendosura të cilat duhen dërguar brenda dt. 5 të çdo muaji në DIK si dhe brenda datës 20 në Ministri dhe Inspektoratin Qendrore

-ARM nuk ka funksionuar sipas strukturës pasi ka sektorë të cilët nuk kryejnë funksion sipas organikës, sic rezulton sektori i Laborator me një përgjegjës sektori dhe tre specialist, ndërkohe që nuk ka laborator,

-Gjithashtu sektori i monitorimit ka detyrë sipas rregullores së brendshme,për grumbullimin e të dhënave që dorëzohen nga persona fizik dhe juridik veprimtaritë e të cilëve janë subjektet të lejeve mjedisore me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm,këto kompetenca kanë kaluar pranë sektorit të monitorimit në AKM.

- Sektori i lejeve një përgjegjës dhe 6 specialistë leje, ndërkohë që më ndryshimet ligjore nuk ka me leje mjedisore dhe si e tillë nuk mundë të këto sektorë lejesh, që në krijimin të ARM-së, ka paqartësi të organikave me strukturat dhe si i tillë dhe funksionimi dhe realizimi i detyrave për gjithë secilin sektorë dhe punonjës nuk ka qene efecient dhe efikas.

b. Janë kryer inspektime nga specialistë të sektorëve tjerë si nga sektori i monitorimit, sektori i lejeve, apo dhe sektori i laboratorit.
c. Ka mungese të udhëzimeve përkatëse për të bërë të mundur kryerjen e inspektimeve si dhe mendimeve për VNM sipas ligjeve në fuqi.
d. Nga krijimi dhe strukturimi i institucionit ARM ka një shtrirje të gjere territorialë dhe si rrjedhojë ka një numër të konsiderueshëm subjektesh që ushtrojnë aktivitet në disa zona me ndikim në mjedis. Shumë inspektime nuk janë realizuar për shkak të largësisë dhe të pamundësisë së shërbimeve mbështetëse (logjistikës), institucioni ka gjithsej 4 mjete në dispozicion dhe më një sasi të jo të konsiderueshme karburanti për shtrirjen e gjëra që ka, e cila e bënë të pa mundur realizmin e inspektimeve, si rezultat dhe puna inspektimeve nuk është në nivelet e duhura, nuk është bërë analiza nga Drejtori si dhe sektori i mjediset për numrin e inspektimeve si rrjedhoje e këtyre veprimeve, për gjithë periudhën objekt auditimi,si dhe nuk janë parashikuar dhe as planifikuar shërbime, udhëtimi në artikullin 602 (dieta +karburant).
e. Për gjithë periudhën objekt auditimi nuk janë hartuar raporte informuese ndaj eprorit të nga inspektorët të cilën e kanë detyrim sipas rregullores së brendshme.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se:

1. Sektori i Inspektimit Mjedisor dhe Ujërave, nuk ka krijuar dosje të përhershme të inspektimit për çdo subjekt të inspektuar kërkesë kjo e Urdhrit të Inspektoratit Qendror Nr. 13 datë 23.04.2015"Për miratimin e manualit të përgjithshëm të Inspektimit në Republikën e Shqipërisë".

2. ARM, nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuar sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun e Tiranë Durrës dhe Dibër, ku në bazë të këtyre të dhënave të bëhej identifikimi i subjekteve me risk të lartë me ndikim në mjedis, në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe detyrimeve që rrjedhin nga Urdhrat e Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015"Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë" dhe nr.4 datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut.

3. ARM Tiranë Durrës dhe Dibër nuk ka metodologji konkrete për llogaritjen e riskut të subjekteve që do të inspektohen, me qëllim përcaktimin e subjekteve që kanë risk më të lartë dhe frekuencën e inspektimit gjatë një viti;

4. Planet mujore të inspektimit nuk janë të plota në informacionin që përmbajnë, pasi në këto plane pasqyrohet vetëm tematika e inspektimit, jo edhe grupet e inspektimit , subjekti i cili do të inspektohet, ne kundërshtim Kapitulli II të Urdhrit të inspektorit të përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 "Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë".si dhe urdhrit nr. 4.

5.Nuk është hartuar rregullorja e metodologjisë së përcaktimit të dënimeve, në fushën të inspektimit, në kundërshtim me pikën 8, neni 48 të Ligjit Nr.10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë";

-Nga drejtuesi i institucionit nuk janë planifikuar trajnime për punonjësit në kundërshtim me urdhrin e Inspektoratit Qendrorë.

6. Inspektimet on-line për sektorin e Mjedisit kanë filluar në muajin Shtator të vitit 2020 dhe Tetor pastaj janë ndërprerë me urdhrin nr. 28 datë 21.10.2020, të Kryeinspektorit të Përgjithshëm për sensibilizimin e qytetarëve për masat anti covid. -Inspektimet kanë filluar me programe mujore në Qershor të vitit 2021 ose rreth 1 vite me vonesë, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në Urdhrin nr. 284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line"; Kujdes i shtuar duhet bërë në dokumentimin dhe evidentimin e punës inspektuese. Sipas kërkesave të manualit të inspektimit, sektorët e inspektimit duhet të mbajnë një dosje të përhershme për çdo subjekt, dosje të cilës i referohet për çdo inspektim që do të kryhet. Dosja e përhershme duhet të përditësohet pas plotësimit të çdo inspektimi me qëllim që të sigurohet përditësimi i përmbajtjes së saj. Kjo dosje e përhershëm është edhe pjesë e sistemit elektronik "e-inspektimi", ***e cila jo në çdo ratë është plotësuar nga Inspektorët, për inspektimet që kanë kryer në terren.***

7**.** Në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë mungonin relacionet, raportet e realizimit të inspektimeve, nga Sektorët e mjedisit dhe ujërave , ku nga raportimet mujore konstatojmë se kryesisht treguesit janë raportuar vetëm në nivelin faktik dhe jo të ta beluar e krahasuar me treguesit e parashikuar në Planet vjetore (pasi edhe planet vjetore mungojnë). Mungesa e këtyre treguesve ka sjellë mos mbështetjen edhe në hartimin e Projekt buxheteve përkatëse, formë kjo raportimi në kundërshtim me normat e programimit dhe me kërkesat e ligjeve "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", "Për Buxhetin", ligjit "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor" me udhëzimet përkatëse, dhe me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", nenin 7 dhe neni 16 "Misioni dhe Funksionet e Inspektoratit Qendror" pika 2 germat "b" dhe "c" dhe me VKM nr. 568 datë, 17.07.2019 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, në zbatim te Urdhrit të Kryeministrit nr. 23, datë 03.02.2020 "Për miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" *Parashikimi dhe realizimi i numrit të inspektimeve për 6/mujorin e dytë 2020 dhe vitin 2021,*

8. Në inspektimet e kryera në terren, për plotësimin e procesverbalit të inspektimit nuk është i gjithë informacionin i nevojshëm duke u bazuar në kushtet e lejes mjedisore që disponon subjekti dhe zbatimin e secilit prej kushteve,si dhe të të gjitha mangësive të konstatuara nga ushtrimi i aktivitetit, sipas inspektimit në terren nga ana e inspektorëve,nuk ka përshkrime specifike mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton kushtet e lejes mjedisore.Konstatimet e inspektorëve janë të përgjithshme dhe për rrjedhim detyrat e lëna kufizohen në pajisje me leje,si dhe kryerjen e dërgimin e vetë monitorimeve. Detyrat që lihen nuk janë të lidhura me konstatimet konkrete të situatës në terren të kryera nga specialistë të fushës së mjedisit. Sa më sipër është në kundërshtim me pikën 3, neni 45, ligji nr.10433, datë 16.06.2011 Neni 45, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

9.Nga auditimi në sektorin e mjedisit u konstatua se nuk është inspektuar një numër i lartë i subjekteve me veprimtari miniera gurore karriera nga ***p***ërzgjedhja e subjekteve për tu inspektuar nuk kryhet sipas rëndësisë së tyre dhe sipas ndikimit që mund të kenë në mjedis, pasi nga praktikat e përzgjedhura subjektet janë me ndikim të ulët ose të mesëm në mjedis. P.sh., vetëm në (16) rast është bërë inspektimi i guroreve në qarkun e Dibër, si dhe në 12 raste Miniera dhe karriera ne Bulqizë.

10-Sektori i Inspektimit mjedisor në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, nuk ka një bazë të dhënash të saktë dhe të listuar sipas ndikimeve që kanë në mjedis subjektet të cilat operojnë në Qarkun Tiranë, Durrës dhe Dibër, mbështetur në këto të dhëna të bëhej identifikimi i subjekteve dhe veçimi i atyre me risk të lartë e ndikim në mjedis. Kjo në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe detyrimeve që rrjedhin nga Urdhrat e Inspektoratit Qendror nr.13, datë 23.04.2015*"Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë* "dhe nr. 4datë 19.02.2015*"Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut".*

11. Në shumë raste inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet se: "subjekti u gjend i mbyllur", ose nuk gjendet ne adresën e dhëne. Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit dhe nuk është lënë detyrë për paraqitje në ARM për marrje dijeni të problemeve të trajtuara, veprim në *kundërshtim me nenin Neni 36- Detyrimet e subjektit të inspektimit pika "d".* Këto mangësi dhe pasaktësi të konstatuara në kryerjen e inspektimeve janë në kundërshtim me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit"dhe me ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" nenin 45-48,ku neni 45.

- Gjithashtu në rastet e lënies procesverbalit kryesisht kur subjekti është gjetur i mbyllur, nuk është përcaktuar kohë e kryerjes për herë të dytë të inspektimit, apo njoftimi i detyruar nga subjekti për realizimin e detyrës. Nga inspektorët nuk ka informacione dhe të dhëna për ndjekjen e inspektimeve për herë të dytë. Nga inspektorët në disa raste nuk ka një material informues për kryerjen e inspektimeve duke shtjelluar hollësisht problemet e konstatuara dhe masat shtrënguese të marra në përputhje me të drejtën e inspektorit për vendim. Për këto raste nuk ka asnjë këshillim, qortim, gjobë apo mbyllje të aktiviteteve, veprime që tregojnë për një pune me performancë të dobët dhe pa përgjegjësi të inspektorëve.
- Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së, Nuk është zbatuar neni 11 "Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimi" të ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe rezultatet e tij me institucione të tjera.

-Nuk ka rastet e lënies së detyrës për ri inspektim, kryesisht kur subjekti është gjetur i mbyllur, apo njoftimi i detyruar nga subjekti për realizimin e detyrës. Nga inspektorët nuk ka një material informues për kryerjen e inspektimeve duke shtjelluar hollësisht problemet e konstatuara dhe masat shtrënguese të marra në përputhje me të drejtën e inspektorit për vendim. Në formularin e Inspektimit, në paragrafin I "Të dhënat të përgjithshme të subjektit", në pika 3"Lloji i aktivitetit ekonomik" gjëndërohet nga sistemi e plotësuar me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet.

12.Në formatin e procesverbalit të inspektimit, në paragrafin 7"Gjetje të konstatuara" nuk shënohen gjetje por citohet vetëm si gjetjet, janë shkelje të neneve të caktuar ligjorë, të cilët përmenden në vijim të procesverbaleve. Ne të gjitha rastet nga inspektimet, ku nuk janë konstatuar shkelje, nuk është plotësuar pika 9 "Në rast se nuk konstatohen shkelje të jepen arsyet e përfundimit të procedimit" e Seksionit II"Procedura e inspektimit" në Procesverbalin e Inspektimit. Në këto raste kjo pikë është lënë e paplotësuar. Kjo bie në kundërshtim me pikën 3 neni 45 dhe nenin 47 të ligjit nr. 10433,datë 16.06.2011"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", është shmangur plotësimi i formularit të inspektimit me të gjitha të dhënat që i takojnë subjektit në bazë të verifikimit në vend.

13. Në formularin e Inspektimit, në paragrafin I "Të dhënat të përgjithshme të subjektit", në pika 3 "Lloji i aktivitetit ekonomik" gjëndërohet nga sistemi e plotësuar me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet në mënyrë që sistemi të mos bëhet pengesë për mbarëvajtjen e procesit të inspektimit, i cili është tejet dinamik, nisur dhe nga numri i lartë i aktiviteteve që operojnë në Qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Dibrës.

Auditimi me zgjedhje I praktikave 2020

Nga auditimi I praktikave rezultoi se :

Është miratuar plani nga Ministri i Mjedisit dhe Turizmit për periudhën gusht -dhjetor 2020,për 4 katër rajonet. Në planin për 5-mujorë janë planifikuar të kryhen 115 inspektime për vitin 2020 nga të cilat hedhur ne sistem 88 autorizime dhe realizuar 55 inspektime.

Inspektimet e planifikuara/të paplanifikuara dhe realizimet,

Inspektimi dokumenteve të hedhur në sistemin o-linë.

Përsa i përket planit të realizimit të inspektimeve dhe raportimit të tyre, për periudhën shtator tetor 2020 nuk na u vu në dispozicion raportimet mujore të realizimit të inspektimeve të sektorit të inspektimit mjedisor por nga informacionet e marra për i realizimit e inspektimeve del se janë realizuar gjithsej 56 inspektime të realizuara sipas muajve.

Theksojmë se për vitin 2020 inspektimet janë realizuar vetëm për dy muaj muajin shtator dhe muajin Tetor.

Në muajin Shtatorë janë hedhur në sistem 29 autorizime,

Për vitin 2020 janë anuluar pasi janë hedhur në sistem mbi 30 inspektime nga Drejtori I Komanduar I ARM-së, Tiranë Durrës, Dibër ***Xh.H*** për periudhën 01.07.2020, deri ne datë 10.12.2020, me justifikim për arsye logjistike,kryesisht në subjekte me veprimtari të ndryshme si dhe miniera, karriera gurore veprime që bien në kundërshtim me ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" kreu III komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit Neni 19,20.

Nga data baza e marre në fq AKM rezulton se janë të pajisura më leje mjedisore miniere , gurore, karriera dhe miniera 218 subjekte të cilat duhet të ishin prioritet për drejtuesin e institucionet. Për vitin 2020, janë planifikuar vetëm 23 raste, ne tre qarqet me justifikimin që nuk kemi data basë të subjekteve që janë të pajisura me leje mjedisore, në faqen e AKM –së, janë të afishuara të gjitha subjektet që janë active dhe të pezulluara që nga data *e krijimit dhe deri në funde të vitit 2021, cilat i kemi paraqitura si anekse në material* .

*Vlen të theksohet se nuk v lesuar sa duhet nga drejtuesi I institucionit për subjekte që kanë rriskë dhe ndikim në mjedis, të cilat duhet të kishin prioritet për tu inspektuar,sidomos për ato raste kur duhet kryer rehabilitimi i zonës***.** *Gjithashtu nga ndryshimet ligjore që janë bërë për lejet e tipit C, që kalojnë në leje të Tipit B dhe sidomos ato që kanë veprimtari në fushën e karburanteve për 6/mujorin e dytë 2020, është planifikuar dhe inspektuar një numër shumja i vogël i subjekteve, për këto veprime mbanë përgjegjësi drejtori i Institucionit të ARM-së,*

-Në gjashtë mujori /dytë 2020, janë hedhur në portal 88 autorizime nga të cilat 36 janë anuluar dhe 52 janë mbyllur, numri I madhe i procedurave të anuluara janë miniera gurore karriera si dhe subjekte me veprimtari të ndryshëm. Për 36 subjektet e anuluara mban përgjegjësi Drejtori i ARM –së,për mos planifikim të sakte dhe mos realizimit te planit të inspektimeve.

-Tabele me nr inspektimi

Nr.	Periudha/muaji	Nr.inspektimeve plan	Nr.inspektimeve fakt
1	Qershor		
2	Korrik	32	15
3	Shtator	29	29
5	Tetor	-	15
6	Gjithsej	61	59

Nga auditimi me zgjedhje, I praktikave të inspektimeve për periudhën Korrik –Dhjetore 2020, në 28 praktika të audituara në sistemi online rezultuan shkelje dhe parregullsi. Theksojmë se për 6/mujorin e dytë 2020 inspektimet janë kryer vetëm në tre muaj, shkaqet kanë qënë ristrukturimi i ARM –së si dhe covid 19.

Për vitin 2020 janë hedhur në sistem o-nline gjithsej 88 inspektime. Theksojmë se nga inspektimet e planifikuar për tre muajt janë anuluar 36 inspektime me veprimtari të ndryshme ,inspektimet janë anuluar me arsyen mungesë logjistikë për realizimin e tyre.
Nga drejtuesi është cituar se nuk kemi pasur mjete, për kryerjen e inspektimeve ,ky pretendim nuk qëndron pasi institucioni ka pas mjete dhe pse me një sasi të limituar karburanti, nëse qëndron argumentimi, pse duhet të ishin hedhur në sistem, si dhe njoftuar subjektet, atëherë nuk është planifikuar dhe menaxhur sic duhet planifikimi i inspektimeve , këto veprime japin një përformancë të ulte institucioni dhe keq menaxhimi nga titullari i institucionit
ARM duke qene se është ristrukturuar në vitin 2019, dhe duke pas në konsideratë situata e covid 19, zgjedhjet lokale etj. Duhet të kishte ngritur grupe pune për një planifikim të saktë të inspektimeve të cilat kanë ndikim në mjedis dhe të behej e mundur dhe analizimi i burimeve njerëzorë, por kjo gjë nuk është bërë për gjithë periudhën e audituar veprime që bien në kundërshtim më me Ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011"Për Inspektimin në Republikan e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10448 me date 14.07.2011"Për lejet e mjedisit" me Ligjin nr.10296 "Menaxhimit Financiare dhe Kontrollit", neni 8 përgjegjësia e Titullarit të njësisë.
Për anulimin e inspektimeve në subjekte të cilat janë anuluar, pasi janë hedhur ne sistem online, për pezullim të pa justifikuar dhe mos planifikim i saktë, ish/ Drejtori I ARM-së, në cilësinë e drejtuesit dhe të menaxherit te institucionit, këto veprime bien në kundërshtim dhe të rregullores së brendshme nr. 120 datë 12.01.2019 "Për organizimin dhe Funksionimin e AKM –së Tiranë, Durrës, Dibër, neni 2 pika 3,4,5 të rregullores Detyrat Funksionale të Drejtoritë të Agjencisë.
-Auditimi i inspektimeve online, nga 88 autorizimet 36 të anuluara nga Titullari ku disa prej subjekteve , paraqiten si më poshtë.
Disa prej rasteve të përshkruara si më poshtë.
1-Subjekti "**A.G**" autorizim nr 000083 me veprimtari "**Industri Energjetikë**"**ne datë pasi** është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
2- Subjekti "**O** " me autorizimin nr,000073 , me veprimtari "**B pasi**"është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
3- Subjekti "**D**",autorizimi nr.000075, me veprimtari "**S**" **pasi** është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
4-"**G H**" me autorizimin nr,000074, me veprimtari **Sherbim Spitalor jo publiki pasi** është hedhur autorizimi në sistem është anuluar
5-**P**" **P**" me autorizimin nr,000070, me veprimtari "**përdorim plastike**" **pasi** është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
6-Subjekti "**F**"**i** me autorizimin nr,000069, me me veprimtari "**Blegtori** "**pasi** është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
7-Subjekti "**A S**" me autorizimin nr,000065, me veprimtari **përpunim metali pasi** është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
8-Subjekti "**G.M**". me autorizimin nr,000064, me veprimtari "**prodhim ushqim pije**"është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
9-Subjekti" **A 2014**, " me autorizimin nr,000061, me veprimtari "**Karriera, Miniera**"është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
10,Subjekti "**F**", me autorizimin nr,000057, me veprimtari "**Prodhim beton hekuri** "është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
11-Subjekti "**A**" me autorizimin nr,000057, me veprimtari "**Ndertim**"është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
12-Subjekti **A** me autorizimin nr,000052, me veprimtari "**Ushqime dhe pije**"është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.

13-Subjekti "**D K**" me autorizimin nr.000050, me veprimtari "**B dhe H**"është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
14-Subjekti Company-C-B, me autorizimin nr.000049, me veprimtari "**prodhim solventesh** "është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
15-Subjekti" **GT**" me autorizimin nr.000051, me veprimtari "**M Karriera** "është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
16.Subjekti "**K U**" me autorizimin nr.000048, me veprimtari "**Prodhim betonihekuri** "është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
17-Subjekti **G** me autorizimin nr.000047, me veprimtari "**Ndertim**"është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
18-Subjekti "**K**"me autorizimin nr.000046, me veprimtari "**Miniera Karriera**"është hedhur autorizimi në sistem është anuluar
19-Subjekti "**A&k M** "me autorizimin nr.000045, me veprimtari "**Prodhim betoni**" **hekuri** është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
20-Subjekti"**R K Tirana**" me autorizimin nr.000044, me veprimtari"**Miniera Karriera**"është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
21-Subjekti "**K**" me autorizimin nr.000041, me veprimtari "**Miniera Karriera** "është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
22-Subjekti "**K**" me autorizimin nr.000044, meFgjoni veprimtari "**Miniera Karriera**"është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
23Subjekti "**N**" me autorizimin nr.000003, me veprimtari "**Miniera Karriera**"është hedhur autorizimi në sistem është anuluar.
-Për veprimet e mësipërme mbanë përgjegjësi z.Xh.H ish/Drejtori i ARM –së Tiranë, Durrës Dibër .
Për vitin 2020 u uadituan me zgjedhje 27 praktika në sistem, te cilat kishin pa rregullësi në plotësimin e liste verifikimve, por në 3 praktikat rezultuan se nuk janë marrë masa administrative ndaj subjekteve të cilat nuk ishin në përputhje me ligjin .
1- Me procesverbalin 2020-000001-2 datë:30/09/2020 "'**A R''** me veprimet "Menaxhimi i mbetjeve" me inspektoret **G.Tdhe E.D** ,sipas pikës 7 "Gjetje të procesverbalit konstatuar veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10448 date 14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar, mos plotësim dokumentacionit brenda afatit ligjorë merr dënim me gjobë në vlerën 300,000 lekë.-Në vendim përfundimtarë nr. 020-000001 - 5 datë: 12/10/2020, grupi i inspektimit nuk ka marrë masë ndaj subjektit mungon kontrata për transferim të mbetjeve, *në këto kushte ndaj subjekti duhej marrë dënim me gjobë në vlerën minimale 300,000 lekë vlerë e cila përben të ardhur të munguar në buxhetin e shteti.*
2-Me procesverbalin 2020-000088 - 2 datë: 26/11/2020, në subjektin "**E - B 2005"** me veprimtari "**Industria minerare**"me inspektorët**, B.Cdhe J.Zh** në procesverbalin sipaspikës 7 "Gjetje janë konstatuar shkelje të ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 "Për Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve", neni 62, Pika 6 , Ligji Nr. 10448 datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit" i ndryshuar, neni 29, Pika 1/ b/ ii ,
-Në vendimin përfundimtare nr.-000088-5 datë:18/12/2020 masa "paralajmërim" bashkëlidhur mungon dokumentacioni plani i menaxhimit, ne këto kushte ndaj subjekti duhej marrë dënim me gjobë ne vlerën minimale 1*3000,000=300,000 lekë, *vlerë e cila përben të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.*
3- Me procesverbalin n -000058 - datë: 08/10/2020 subjekti ''**K''**, Dibër me aktivitete "Minierë" me inspektorët **E.D dhe G T,**në procesverbal dhe vendim përfundimtarë konstatojnë së subjekti plotëson dokumentacionin, por nga auditimi konstaton se subjekt nuk ka dorëzuar pranë AKM-së, raportin e vete monitorimit në kundërshtim me Ligji nr. 10448

dt.14.07.2011 "Për lejet e mjedisit" i ndryshuar.Pika: 1 germa b, ii. në këto kushte ndaj subjektit duhej marre dënim me gjobë minimale *300,000 lekë., vlerë e cila përben të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.*

Për 6/mujorin e dytë të vitit 2020 rezultojnë se tre subjekte nuk plotësojnë kushtet e lejes ndaj të cilave duhej të ishte marrë masë me dënim administrativ gjobë **3*300,000=900,000 lekë** , vlerë e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.

Tabela me subjekt që janë konstatuar të mbyllura.

Nr	Emërtimi i Subjektit	NIPT	Aktiviteti	Data e inspektimit/ inspektoret	Nr. serial i Ceshtjes	Problematikat e konstatuara/ detyrat elena (afatet)
1.	A.F	L41407010C	Rritja intensive e derrave	21.09.2020 A.K J.Zh	2020-000028	Nuk u gjet në adresën e përcaktuar në sistem.
2.	Ts	J61811521O	Menaxhim i mbetjeve	03.09.2020 A.K J.Zh	2020-000010	Subjekti i mbyllur
3.	A b	K82207503C	Prodhim bitumi, materiale ngjitëse, tulla e betone për ndërtim	14.09.2020 A.K J.Zh	2020-000032	Nuk u gjet në adresën e përcaktuar në sistem.
4	E.'s.	J82014501O	Grumullim, seleksionim,perpunim deri në product të gatshëm I të gjitha llojeve të lëkurës eksportim dhe importim I saj	Dt. 03.09.2020 I.A	AKM-TR-2020-000023	Subjekti i mbyllur
5	F a	K71411501L	Lavanderi dhe ngjyrosje te produkteve tekstile	Dt.17.09.2020 I.A	AKM-TR-2020-000027	Subjekt i mbyllur
6	I Sh	K93709203M	Thertore	Dt. 22.09.2020 I.A	AKM-TR-2020-000029	Subjekt I mbyllur
7	A 3	L01926019T	Indfustri Miniere	A.K J.Zh	2020-000037	Subjekt I mbyllur

-Sipas tabelës për muajin shtator 2020 në 7 inspektimet e kryera, inspektorët kanë citur në procesverbal se subjektet u gjenden të mbyllura, ose pa adresë e përcaktuar në sistem, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10443'Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" Neni 41 Të drejta të tjera të inspektorit Përveç sa parashikohet më sipër në këtë seksion, inspektori, për qëllimit të inspektimit, ka edhe këto të drejta: a) të kryejë fotografime, filmime apo regjistrime si dhe në *kundërshtim me nenin Neni 36- Detyrimet e subjektit të inspektimit pika "d"*. Këto mangësi dhe pasaktësi të konstatuara në kryerjen e inspektimeve janë në kundërshtim me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit" dhe me ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" nenin 45-48,ku neni 45. Si dhe nuk janë marrë informacione nga QKB dega e Tatimeve, nëse këto subjekte kryejnë veprimtari apo paraqiten me status pasiv pranë QKB-se, si dhe të planifikohen në planet e radhës kryerja e inspektimeve.

Për veprimet dhe mos veprimet mangësitë në dokumentacionin dhe procedurat e inspektimeve të kryera nga Sektori i inspektimit Mjedisit, lidhur me programet ne autorizimet e inspektimeve, me lënien formulimin e detyrave rekomandimeve, mos riverifikimin e zbatimit të tyre, me marrjen dhe zbatimin e masave administrative, me rritjen e efektivitetit të inspektimeve, menaxhimin efektiv dhe efecient të inspektimeve, nga ARM Tiranë Durrës Dibër për periudhën Korrik2020 Dhjetore 2021janë kryer veprime në kundërshtim me legjislacionin; në mos përmbushje të kërkesave të nenin 45 pikat 1,2,3,4, të ligjit nr.10433,

datë 16.06.2011"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM nr. 568, datë 16,09,2019 "Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare Të Mjedisit Tiranë Durrës Dibër",VKM-së nr.568,datë 17.07.2019 **"**Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" si dhe rregullores së Brendshme nr. 120 datë 19.01.2021,"Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjediset të mjedisit dhe ujërave në nivel rajonal.

Për inspektimet e me sipërme mbajnë përgjegjësi G.T,E.D, I.M B.C, J.Zh, A.K, Ilir Agalli dhe Sadush Shara,në cilësinë e inspektorëve.

Observacion: ARM me shkresën nr. 155/3 prot., datë 08.04.2022 ka protokolluar në KLSH, arsyetim të bërë ndaj akt-konstatimin e grupit të auditimit, për subjektet sipas rasteve dhe sipas observacioneve të sjella nga inspektorat G.TE.D, I.M A.K J.Zh kanë paraqitur dokumentacioni bashkëlidhur si më poshtë :

1-Për subjektin **R** është sjellë plani i rehabilitimit me nr. prot nga ARM ,

-Plani I menaxhimit të riskut ,- plani i menaxhimit të mjedisit,

2-Subjekti **Gj** Bashkëngjitur Raporti vjetore I monitorimi mjedis me nr. prot AKM,4171 datë 31.08.2020,

-Plani menaxhimit, plan përputhshmërisë, plani I menaxhimit të mbetjeve, planin e menaxhimit në mjedis.

3-Subjekti"**K'**bashkëlidhur shkresa përcjellëse nga AKM me nr. Prot.4657 datë 14.09.2020, ku gjendet Plani I Menaxhimit në mjedis, Regjistri I mbetjeve ,plani I menaxhimit të riskut plani I përputhshmërisë,

4-Subjekti **T**subjekti dhe në listë verifikim citohet se gjendet i mbyllur duhet lenë

5- Subjekti**' D"**,bashkëlidhur raportin vjetorë më nr prot.. 4657 datë 14.09.2020, nga AKM,-planin përfundimtare në rast mbylljes së veprimtarisë së subjektit.-F,planin e menaxhimit të mbetjeve,

Observacion: ARM me shkresën nr .155/3 prot., datë 08.04.2022prot.. në KLSH,

arsyetim të bërë ndaj akt-konstatimin e grupit të auditimit,: I.A B.C, ka paraqitur dokumentacioni bashkëlidhur si më poshtë,

7-Subjekti **D** bashkëlidhur dokumentacioni ,

-Raport vete monitorimi pranë ARM datë 26 .06.2020

-Plan Project Rehabilitimi dhe menaxhim I mbetjeve,

-Plan I menaxhimit të riskut,

-Plan menaxhim mjedisi,

8-Subjekti**A E**dokumentacioni bashkëlidhur ,shkresa përcjellëse pranë AKM prot., 1929 datë 29.04.2021, Raport monitorimi , raport vjetorë raport I testimit dhe përcaktimi I mbajtjes së grimcave të ngurta në Ajër dhe Mjedis.

Observacion: ARM me shkresën nr. 155/3 prot., datë 08.04.2022, prot.., në KLSH, arsyetim të bërë ndaj, akt-konstatimin e grupit të auditimit, J.Zh ,A.K

paraqitën dokumentacionin, kontrata shërbimi për grumbullim, transportim dhe trajnim e riciklimit e vajrave lubrifikim të përdorura.

Observacion: ARM me shkresën nr. 155/3 prot., datë 08.04.2022 në KLSH, arsyetim të bërë ndaj, akt-konstatimin e grupit të auditimit, B.C, I.A

1-subjektet **''V t",**

-Bashkëlidhur raporti i vetë monitorimit dhe monitorimit pro.., datë 01.10.2020, pro..,t 5036/1AKM.

-Programi I menaxhimit të riskut datë 01.10.2020,

-Subjekti P'' bashkëlidhur dokumenti i marrë nga QKB që subjekti nuk ushtron veprimtari dhe rezulton I pezulluar.

Subjekti ''**C''** bashkëlidhur dokumenti i marrë nga QKB që subjekti nuk ushtron veprimtari dhe rezulton I pezulluar.

Qëndrimi i grupit të audituesi: Grupi i auditimit, Pas shqyrtimit të observacioneve të bëra më sipër, mori në konsideratë, pjesërisht komente dhe ka bërë ndryshimet përkatëse në Project raport

Mbi verifikimin dhe ndjekjen e Ankesave;

Në lidhje me*: Verifikimin, ndjekjen dhe kthimin e përgjigjeve të ankesave të ardhura në DRM Tiranë ',Durrës, Dibër, nga qytetar dhe institucione të ndryshme për 6/mujorin e dytë 2020,*

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua:

Janë protokolluar pranë institucionit 36 ankesa, nga të tretët dhe kthyer përgjigje 23 ankesave pa përgjigje 13 ankesa .

Ankesat ndahen Për Inspektoratin e Mjedisit 36, për Inspektoratin e Ujërave 0 .

-Ankesat qe u konstaton pa përgjigje dhe me mangësi.

Të meta të konstatuara,

Nga auditimi i ankesave për vitin 2020,

1 -Ankesë nga qytetari datë 12.07.2020, nisur me emali në ARM, ku shprehen se ka shpërthime të forta nga guroret në zone zall –herr, ankesa është protokolluar 6–muaj me vonese nga ARM

Autorizimi me nr. 1339/1, datë 09.12.2020 të ARM Tiranë.

Me shkresën nr. 1339/2 datë 16.12.2020, me lende marrje masash, **ndaj L E** Shpk subjekti rezulton i pajisur me leje mjedisore,

E metë:

- Nga Titullari nuk është lëshuar autorizim për këtë ankesë, pra nuk është kryer inspektim nëse subjekti ka plotësuar kushtet e lejes.
- Qytetarit që ka bërë kërkesë, nuk i është kthyer përgjigje zyrtare, në lidhje me kërkesën.

2–Me shkresën nr.13/2 datë 18.1.200 të sjellë nga Agjencisë e Mbrojtjes së Konsumatorit në lidhje me ankesën e banorit T.M, cili ankohet për punishte në zonën e sharrës të cilat shkaktojnë ndotje mjedisore dhe akustike, me shkresën nr. 5839/1 datë 07.12.00 AKM, është drejtuar ARM për ndjekje dhe dhënie përgjigje ankimuesit.

Qytetarit që ka bërë ankesën i është kthyer përgjigje se nuk është subjekt që pajiset me leje mjedisore,

E metë

-Nga verifikimi në sistem subjekti është i pasitur me leje mjedisore .

- Nga ana e Drejtorit nuk është lëshuar autorizim për verifikimin e kësaj ankese, edhe nëse nuk është subjekt që pajiset me leje mjedisorë, kanë detyrimin për verifikim te ndotjes së mjedisit, sipas ligjit .

3 –Me e-malin datë 11.12.200, të një banori nga Durrësi , ka bërë ankesë në lidhje me një fabrika tullave port 2262 datë 12.12.200, ARM Tiranë.

- Autorizim për verifikim nr. 1408/1, datë 2.12.2020, Inspektorët A.K J.Zh,

Subjekti rezulton që është në proces për tu pajisur me leje mjedisorë të Tipit B.

E metë

- Nga Titullari nuk është lëshuar autorizim për inspektim për këto ankesë, nëse subjekti është pajisur me leje mjedisore.

4 –Ankesa me nr 4116/2 datë 19.10.2020, të banorit Saimir Kurti banues në Tiranë , në lidhje me një serisë makinash ankesa Protokolluar me nr. 4116/3datë 27.10.2020, ARK Tiranë. deleguar ARM –së, me shkresën nr 10241 datë 10.1.2020 Drejtori Xh H ka ngrit një grup pune për evidentimin e anesës,ku nga evidentimin kanë rezultuar problematika .

-Është nxjerrë autorizimi nga Drejtori, datë 12.11.2020,Inspektorët A.K J.Zh,

E metë

- Nga Titullari nuk është lëshuar autorizim për inspektim për këto ankesë,

Qytetarit që ka bërë ankesën i është kthyer përgjegjëse,

5-Me ankesën pa nr pa datë të një banori nga Durrësi, Sh H, se një subjekt thyen gurë ka zhurma dhe pluhur në të gjithë zonën .

Me shkresën nr.817/1 datë 29.10.2020,është kthyer përgjigje ankimuesit se subjekti ka paraqitur raport vet monitorimi dhe është brenda normave të lejuara Drejtori Xh.H

Me shkresën nr.87/2 datë 03.11.2020, ndaj subjektit D SHA është theksuar se subjekti duhet të ndërmarrë masa duke ju referuar nenit 6 të ligjit nr,10431 datë 09.0.2011'Për Mbrojtjen e Mjedisit",

E metë

-Nga Titullari në shkresat ka mos përputhje pasi në datë 29.10.2020, kthen përgjigje anketuesit se është brenda normave të lejuara ndërsa në datë 03.11.2020 theksohet për marrje masash dhe përmirësim të kushteve ,si është arritur në këtë konkluzion nëse nuk është kryer inspektim.

-Drejtori nuk ka nxjerre autorizim për inspektim për verifikim të përmirësimit të kushteve të lejes.

6-Me shkresën nr. 515 datë 27. 10. 2020nga Agjencia e mbrojtjes së Territorit është drejtuar AKM –së se banoreve të një pallati ""L F" kodra e Diellit Tiranë ankohen për ndotje mjedisore ndaj subjektit AM i cili realizon reklama me plastik adezive,

-Me shkresën nr. 1240/1 datë 3.1.2020 është kthye përgjigje aktiviteti është në fazë instalimi.

E metë

Nga Titullari nuk është nxjerrë autorizim apo inspektim nëse subjekti është në proces për tu pajisur me leje mjedisore

- Qytetarit që ka bere ankese nuk i është kthyer përgjigje zyrtare,

7-Me shkresën nr.459/2 datë 30.09.2020 të AKM –se, në lidhje me ankesën e Sh Kryetar i Bashkisë Vore shpreh shqetësimin e fshatit Gjokaj Për subjektin "A.A", ndotjen e ujërave dhe akustikës,

-Me shkresën nr. 17/1 datë 1.10.2020, është kthye përgjigje nga ARM, se subjekti është i pajisur me leje dhe do jete në monitorim të vazhdueshëm për plotësimin e kushteve.

E metë

Nga Drejtori Xh.H nuk është nxjerrë autorizim apo inspektim nëse subjekti ka përmirësuar konstatimin e bërë për kushtet e lejes mjedisore ,

E metë

Nga AKM ,ndaj subjektit është marre masë administrative me gjobë në vlerën 500,000lekë, në kundërshtim **Ligjit 50/2020 "Për Lejet e mjedisit",**

8-Me shkresën nr.4862//1datë 28.09.2020, të përcjelle nga Drejtori i AKM –së, Tiranë, në ARM për një ankesë të sjelle nga banorët ne Selitë të Vogël, për Kompaninë "A -K''për zgjerimin e një kanali të ujërave të shiut.

-Me shkresën nr. 414/1 datë 01.10.2020,Titullari ARM ka kthyer përgjigje ankuesit se do ta monitorojmë ne vazhdimësi ,

E metë

-Nga ARM Tiranë Drejtori nuk ka nxjerrë autorizimi apo inspektim për verifikimin e subjektit nëse plotëson kushtet e lejes mjedisore .

9-Me shkresën nr. 3149 datë 09.09.2020, nga Njësia vendore e Kujdesit shëndetësore , drejtuar ARM Tiranë, ankesë e banorëve E G dhe RM për frigoriferët e Firmës "H" për matjen e nivelit të zhurmave,

E metë

-Nga ARM Tiranë Drejtori nuk ka nxjerrë autorizimi apo inspektim për verifikimin e subjektit nëse plotëson kushtet e lejes mjedisore
- Qytetarit që ka bërë ankesë nuk i është kthyer përgjigje zyrtare.
Veprime në kundërshtim *me Udhëzimin nr.8 datë 27.11.2007, "Për nivelet kufi të zhurmave në mjediset e caktuar".*
10-Me shkresën nr. 1273/1 datë 31.08.2020, ankese e disa banorëve drejtuar, dërguar Prefekturës Tiranë për subjektin e Përpunimit dhe riciklimit të mbetjeve plastike "G.P.R", A, banorët ankohen për ndotje akustike, zhurma të larta, tymra era të këqija, shpërndarje e mbeturinave jashtë objekti etj...
-Me shkresën nr. 215/1 datë 08.09.2020, është kthyer përgjigje,
E metë
-Nga ARM Tiranë Drejtori nuk ka nxjerrë autorizimin apo inspektim për verifikimin e subjektit nëse plotëson kushtet e lejes mjedisore. Në Kundërshtim me *Ligjin nr.10266,datë 15.04.2010, ''Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja".*
11- Me ankesën datë 20.07.2020, të qytetarit Th N banues në lagjen 13 Plazh Durrës ,drejtuar ARM Tiranë , për subjekt me aktivitet cikli dhe përpunim bakri, për zhurmat dhe erat e kimi kateve gjatë procesit te shkrirjes.
-Me shkresën r.55/1 datë 10.08.2020, është kthyer Përgjigje anketuesit se nuk është subjekti që duhet të pajiset me leje mjedisore .
E metë
- Drejtori i komanduar,i ARM-së, Tiranë, Durrës, Dibër, nuk ka nxjerrë autorizimi apo inspektim për verifikimin e ankesës edhe pse nuk është subjekt që pajiset me leje mjedisore.
Në këto kushte janë kryer veprime në kundërshtim *me Udhëzimin nr.8 datë 27.11.2007,"Për nivelet kufi të zhurmave në mjediset e caktuar".*
-Theksojmë se nga auditimi i ankesave që pretendohet të jenë kthyer përgjigje në asnjë rast nuk janë ngritur grupe pune nga titullari për verifikim në terrenet ankesave nga qytetar apo grupet e interesit , nëse pretendimet e tyre qëndronin duhej të marrashin masa inspektime, pasi në disa raste pa pas një dokument që është kryer verifikimi shprehen në kthim përgjigje se subjekti do jete në monitorim.
-Në rast kur nuk u është kthyer përgjigje zyrtare apo dhënë përgjigje pa dokumentacion vërtetues bashkëngjitur nga ARM Tiranë ,Durrës Dibër. Mbanë përgjegjësi ish /Drejtori Xh.H.
-Për sa kohë ky informacion është protokolluar pa tjetër duhet të ishte verifikuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 17,19 pika 3dhe 4,"Për përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve" dhe neni 21" Për dorëzimin e dokumenteve në rrjetin arkivor" të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 " Për Arkivat "dhe Kreun e III-të "Njoftimet dhe afatet Kohore për bërjen e tyre, neni 56, detyrimi për tu njoftuar, neni 59 Afatet kohore për njoftim dhe afatet kohore për zbatimin e akteve administrative të Ligjit 8485, datë 12.05.1999" Kodi Procedurës Administrative" me ligjin "Për të Drejtën e informimit".
Për këto veprime për mos kthim përgjigj mos ndjekje të proceduarve në rastet kur duhej kryer inspektim në terren, për verifikim si dhe ngritje të grupeve të inspektimit mban përgjegjësi z Xh.H me detyrë Ish/Drejtori iARM –se për 6/mujorin e dytë 2020.

Inspektimet viti 2021

Viti 2021

Plani i përgjithshëm I inspektimit për muajt Janar-Dhjetore 2021 është miratuar me shkresën nr. 635/1datë 23.12.2020, nga Ministri I Mjedisit dhe Turizmit pa nr. Datë dhe një program I përgjithshëm për periudhën Dhjetor-Janar 2021,

-Me shkresën nr. 26 datë 06.01.2021, nga Drejtori I Përgjithshëm I AKM-së, për arsye të zgjedhjeve të Përgjithshëm për periudhën Janar –Qershor 2021, me urdhër verbal të Kryeministrit nuk janë realizuar inspektime. Inspektimet kanë filluar në muajin Qershor 2021. Referuar situatës problematike të krijuar nga përhapja e Covid 19 ,Sektori i Inspektimit në Mjedis ka filluar kontrollet në terren për zbatueshme rinë e kushteve të lejeve mjedisore dhe legjislacionit mjedisor në fuqi në muajin Qershor 2021, referuar Planit Vjetor të Monitorimit, miratuar nga titullari i institucionit.

Planet sipas Muajve

- Planet mujore për inspektimit qershor 2021, miratuar në datën 25.05.2021,
-Plani muajit korrik është miratuar dt 29.06.2021, plani i inspektimit për muajin gusht është miratuar në datë 23.07.2021,
-plani për muajin shtator është miratuar në datën 25.08.2021,
-plani i inspektimeve për muajin tetor është miratuar në datë 27.09.2021,
Plani I inspektimeve për muajit nëntor është miratuar në datë 26.10.2021,

për muajin dhjetor nuk ka plan të miratuar nga Drejtori I Përgjithshëm AKM –së, pasi është dorëzuar jashtë afatit dhe nuk është bërë miratim. Inspektimet për këtë muaj janë kryer pa miratim plani mujore por sipas autorizimeve të nxjerra nga Drejtori I Komanduar ***për periudhën*** 10.12.2020 deri në date 28.01.2022.

Inspektimet e planifikuara/të paplanifikuara dhe realizimet

Programi vjetor për vitin 2021,për sektorin e inspektimeve janë hartuar nga drejtoria qendrore në AKM.Janë hedhur në sistem gjithsej 244 inspektime, nga këto jashtë programi gjithsej 37 inspektime në muajin dhjetor 2021. Për vitin 2021 janë marrë ***11 dënime administrative me gjobë***. Pjesa më e madhe e inspektimeve janë bërë sipas programit mujor dhe procedurës së përcaktuar të kryerjes së një inspektimi, por ka patuar edhe inspektime jashtë plani kryesisht në bazë denoncimi apo informacioni nga të tretët. Inspektimi jashtë plani janë kryer edhe në rastet e ankesave të deleguara nga Portali i Bashkëqeverisjes "Shqipëria që duam". Për periudhën objekt auditimi nuk ka patur inspektime në kushtet e flagrancës, pasi referuar ndryshimeve ligjore janë krijuar struktura të posaçme pranë Ministrisë së Brendshme për ndjekjen e rasteve flagrante apo ilegale. Ne autorizimet e inspektimeve janë përfshirë edhe inspektorë të sektorëve të tjerë. *ARM nuk ka bazë të dhënash të plotë të subjekteve të pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis, mbi bazën e të cilave të hartojë programet vjetore dhe mujore të inspektimit bazuar mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut.*

Për periudhën objekt auditimi nuk ka një listë të subjekteve të pajisura me leje mjedisore, mbi të cilat kryhen dhe programet mujore dhe vjetore.

Gjithashtu nga ndryshimet ligjore që janë bërë për lejet e tipit C, që kalojnë në leje të Tipit B dhe sidomos ato që kanë veprimtari në fushën e karburanteve për 2 vitet është bërë një punë jo e kënaqeshe pasi nuk janë planifikuar dhe inspektuar nga ARM,

Për periudhën objekt auditimi janë inspektuar një numër shume i ultë i subjekteve të pajisura me leje mjedisore si, gurore, miniera karriera në krahasime numrin e tyre , përveç faktit qe këto inspektime kryhen dhe nga Drejtoria e Inspektimit pranë Agjencisë Kombëtarë të Mjedisit.

Për muajt Janar-Dhjetor 2021, Sektori i Inspektimit në Mjedis ka realizuar në total 244 autorizime në portal dhe kryer inspektime në terren, të cilat janë kryer me planifikim mujor dhe nga jashtë planit referuar denoncimeve, ankesave apo raste vete tjera të ngjashme., si më poshtë:

244 Autorizime të hedhura në portal,
71 jashtë planit në të gjithë muajt
12 të anuluara nga inspektimet që kanë qene Brenda plani,
-Inspektimet on-line nuk kanë filluar në përputhje me afatin e vendosur në Urdhrin nr.284, datë 03.05.2017 të Inspektorit të Përgjithshëm "Për kryerjen e inspektimeve on-line";

Këto subjekte janë inspektuar me qëllim kontrollin e kushteve të lejes mjedisore në përputhje me dispozitat e legjislacionit mjedisor. Kontrollin e të gjitha llojeve të mbetjeve të gjen eruara në këtë instalim dhe mënyrën e trajtimit të tyre.

Kontrollin dhe vlerësimin e masave për menaxhimin e mjedisit nga ana e veprimtarisë. Kontrollin e përmbushjes të standardeve të cilësisë së mjedisit, verifikimin dhe vlerësimin e çdo raporti të paraqitur nga operatori .

Realizimi inspektimeve sipas muajve viti2021

Realizimi inspektimeve sipas muajve viti2021

Nr.	Periudha/muaji	Nr. Autorizimeve ne sistem	Jashtë plani gjatë muajve	Anulluar
	Maj	44		
1	Korrik	36	7	
2	Gusht	34	1	6
3	Shtator	29	5	1
4	Tetor	44	12	
5	Nëntor	19	12	5
6	Dhjetor	38		
	Gjithsej	244	37	12

Nga auditimi i procedurave të inspektimit konstatohet se inspektimet jashtë plani kryesisht bazuar në ankesa lidhur me pajisjen me leje mjedisore dhe kushtet e ushtrimit të aktivitetit sipas rasteve të ankimimit. Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion, intervistomi të inspektorëve dhe përgjigjeve të pyetësorit mbërrijmë në konkluzion se sektori i inspektimit mjedisor e ushtron aktivitetin e tij në përputhje me Ligjin nr. 10433 datë 16.6.2011"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar dhe aktet tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tij.

Si dhe me vendimin nr. 568 datë 17.07.2019, Për krijimin organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtarë të mjedisit''.

Për sa i përket realizimit të inspektimeve dhe raportimit të tyre, u vunë në dispozicion raportimet mujore të realizimit të inspektimeve të sektorit të inspektimit mjedisit dhe i detajuar realizimi i planit të inspektimit.

Sektori i Ujerave për periudhën e audituar nuk ka kryer asnjë inspektim.

Viti 2021

Inspektimet në Sektorin e mjedisit,

Nga 244 autorizime të hedhura në portalin onlin dhe realizuar 224 u audituan me zgjedhje, 42 praktika nga te cilat u konstatuan pa rregullsi në plotësinnin e liste- verifikimit, kurse në 11 praktika rezultuan me shkelje dhe parregullsi të trajtuara me poshtë.

1-Me procesverbalin nr.-2021-000206 - 5 datë: 05/11/2021, në subjektin **M**, me veprimtari "Veprimtaritë që përfshijnë përdorimin e sol enteve" me inspektor**, A.B**

E.D, në procesverbalin në pikës 7 "Gjetje "konstatuara shkelje në kundërshtim me Neni 61 Ligji nr. 10463 dt.22.09.2011"Për Transferimin e mbetjeve të rrezikshme", në rast mos plotësimi dokumentacioni ndaj subjektit merret gjoba 300,000 lekë.

Në vendimin përfundimtare nga grupi inspektimit nuk është marrë masa, bashkëlidhur **mungon** kontratën e mbetjeve dhe dokumenti i transferimi të mbetjeve.

<u>në këto kushte ndaj subjektit duhej marrë masë në vlerën e minimale Gjobe 300,000 lekë,</u> vlerë e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.

2-Me procesverbalin nr. 2021-000264 - 2/1datë: 10/12/2021"**'C K** i aktivitetit ekonomik Veprimtaritë që përfshijnë "përdorimin e sol enteve",me inspektorë **F.M dhe B.D,** në të gjitha rubrikat janë plotësuar që subjekti nuk ka shkelje të kushteve të lejes**.**

<u>Bashkëlidhur munguan dokumentacioni shoqërues veprime që bien në kundërshtim me ligjin</u> nr. 10433 datë 16.06.2011"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", *për mos plotësimin e dokumentacionit duhej gjobë në vlerë minimale **300,000 lekë,** vlerë e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.*

3- Me procesverbalin nr -2021-000216 - 2/1 Datë: 04/11/2021. Emri i Subjektit **D** Lloji i aktivitetit "**përdorimin e sol enteve**", me inspektorë **A.B dhe E.D**, në procesverbal dhe vendim nuk janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, dokumentacionit shoqërues

Mungon: raporti periodik, I dorëzuar pranë AKM –se, në këto kushte duhej marrë masa dënim me gjobë minimale *300,000lëkë,vlerë e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.*

4-Me procesverbalin nr-2021-000018 - 2/1 datë: 22/06/2021 Qarku:. Emri i Subjektit **R**Lloji i aktivitetit ekonomik **"Aktivitete te tjera"** me inspektore **A.K J.Zh,** në listë verifikimin dhe pv në pikën 7"Gjetje Konstatime "veprime në shkelje të janë lënë shkelje të kërkesave ligjorë ndaj subjektit në vendimin përfundimtarë grupi i inspektimit nuk lënë masa ndaja subjektit, veprime në kundërshtim me Ligji nr. 10448, date 14.7.2011"Për lejet e mjedisit" I ndryshuar, neni 29,

Mungon: Raporti 6-mujor i Vet- monitorimit me subjekt të licencuar për të pasqyruar kryerjen e matjeve në aktivitet, në këto kushte ndaj subjekti duhej marrë masa dënim me gjobë minimale *300,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.*

5-Me procesverbalin nr.2021-000080 2/1 Datë: 13/07/2021 Emri i Subjektit **D G,** Lloji i aktivitetit ekonomik "Veprimtari te tjera" ,me inspektore **A.K dhe J.Zh,** në listë verifikim dhe procesverbal se subjekti nuk ka shkelje të kërkesave ligjore, bashkëlidhur Subjekti i **mungon,** subjektit i ka përfunduar në vitin 2019 kontrata e shërbimit të mbetjeve në këto kushte ndaj subjektit *duhej marrë masa dënim minimal me gjobë 300,000 lekë.*

6-Me procesverbalin 2021-000282 - 2 datë: 15/12/2021"Brilliant Line" Veprimtaritë që përfshijnë përdorimin e solenteve, me inspektor, **A.B dhe E.D**, në procesverbal në pikës 7 "Gjetje "konstatuara shkelje në kundërshtime ligjin. 10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" I ndryshuar, neni 29 Ligji nr. 10 463, date 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar te mbetjeve" në mos plotësim dokumentacioni sipas afateve të përcaktuara në ligj subjekti merr dënim me gjobë 300,000 lekë.

Në vendim përfundimtarë grupi I inspektimit nuk ka marrë masë ndaj subjektit mungon kontratën e mbetjeve dhe dokument transferimi të *mbetjeve ,në këto kushte ndaj subjektit duhej marrë masë në vlerën e minimale gjobë 300,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.*

7- Me procesverbalin nr -2021-000082 -2/2 Datë: 22/07/2021, Emri i Subjektit "R SH.P.K ," Lloji i aktivitetit ekonomik **"Industria minerare** "**B.C** keni 7"Gjetje Konstatime "janë konstatuar shkelje të10433 dt. 16.06.2011"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjin Nr. 10463 date 9/22/201"Për menaxhimin e integruar te mbetjeve"(ndryshuar), në vendim përfundimtare nuk është marrë masë ndaj subjektit.

Mungon; Raporti periodik , raporti vjetore, si dhe kontrata apo dokument për transferimin e mbetjeve të rrezikshme, kontratë për evadimin e mbetjeve tip plastike me subjekt të licencuar. në këto kushte ndaj subjektit *duhej marrë masa dënim minimal me gjobë 300,000 lekëvlerë e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.*

8-Me procesverbalin nr. 2021-000151-2/1 Datë:20/09/2021. Emri i Subjektit **M** Lloji i aktivitetit Fabrika/punishte/pika për prodhimin e përpunimi produkteve te bulmetit "më inspektorë **F.M dhe B.D**, në procesverbal në pikën 7 Gjetje Konstatohen shkelje të . neni 23.Ligji: Nr. 9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujerave te ndotura"(i ndryshuar) pika: 2/ç si dhe të Ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 "Për Lejet e Mjedisit" I ndryshuar, neni 29,në vendim përfundimtar nuk ka demin administrativ.

Mungon një dokument që përshkruan normat e shkarkimeve me të mëdha se norma e lejuar. Subjekti sipas fletës së analizës duhet të vërtetoje zbatimin e kushteve 7.2.10, 7.2.11, 7.2.12,

7.2.13 *në këto kushte ndaj subjektit duhej marrë demin me administrative me gjobë minimale 300,000lekë,vlerë e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.*

9-Me procesverbalin nr. 2021-000260 - 2/1 Datë: 07/12/2021. Emri i Subjektit ''**L C''..** Lloji i aktivitetit ekonomik "Veprimtari te tjera" me inspektorë inspektorët **F.M B.D**,ne cek listën nuk janë plotësuar të gjitha rubrikat çfarë e bënë të pa qartë plotësimin e kushteve të lejes të subjektit, si dhe ne sistem nuk ndodhet dokumentacioni bashkëlidhur, në këto kushte *duhej marrë masa dënim me gjobë 300,000 lekë, vlera e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.*

10-Me autorizimin nr 000258-1 datë 03.12.2021,në subjektin **F** me veprimtaritë Tjera", me inspektorët ***F.M dhe B.D*** ,në listë –verifikimi rezulton se subjekti nuk plotëson disa nga kushtet e lejes.

-Në pv nr 000258-2 datë 07.12.2021, në pikën 7 "Gjetje Konstatime" janë konstatuar shkelje pika 1,6 neni 21 të Ligjit 10463 datë 22.09.2011"Për Menaxhimin e Mbetjeve të Integruara", pika1/b,neni 29 ligjit 10488 datë 14.07.2011''Për Lejet e Mjedisit'' i ndryshuar, si dhe VKM 229 datë 23.04.2011, për zbatimin e kushtit 8 të lejes Mjedisore që dispono subjekti.

-Në procesverbal datë 07.12.2021,janë lënë tre dënime administrative në rast se nuk plotëson dokumentacionin, brenda afatit.

-**Në** vendimin përfundimtarë datë 07.01.2022, inspektorët nuk kanë marrë masë ndaj subjektit.

Mungon: kontrata për evadimin e mbetjeve, kjo kontratë nuk është paraqitur pranë AKM, në këtë *raste ndaj subjektit duhej marrë masë, dënim me gjobë minimale 300,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.*

11-*Me autorizimin datë* -000282 - 2 datë:15/12/2021,"B L" të aktivitetit Lloji i aktivitetit ekonomik Veprimtaritë qe përfshijnë "përdorimin e solventeve" me inspektorë **A.B dhe R.XHnë procesverbalin** pikën 7"Gjetje Konstatime" veprime në shkelje të Neni 62, Pika 16 të Ligjit nr. 10463 dt. 22.09.2011 'Për Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve',

mungon; kontrata për mbetje të rrezikshme me një subjekt të licencuar, në vendim përfundimtarë, nuk ka dënim me gjobë në këto kushte ndaj subjektit *duhej marrë masa dënim me gjobë 300,000 lekë, vlera e cila përbën të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.*

Në 11 subjekte janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore, vlera ***11*300,000=3,300,000 lekë, e cila përbejnë të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit.***

Lista e subjekteve të cilat janë gjendur të mbyllura ose pa adresë.

Nr	Emërtimii Subjektit	NIPT	Aktiviteti	Data e inspektimit/ inspektoret	Nr. serial i ceshtjes	Problematikat e konstatuara/ detyrat elena (afatet)
1	F	L21501050B	Menaxhimi i mbetjeve	F.M , B.D	-000294	Subjekti nuk u gjjend
2	H.L.-GP	K31922001Ë	Veprimtari tjera	F.M , B.D	2021-000256 - 2/1 Datë: 26/11/2021	Subjekti nuk u gjjend
3	K 2.	L72307018A	Trajtimet me regjie dhe prodhimi i lekures	J.Zh A.K	000183 - 2/1 Datë: 14/10/2021	Subjekti nuk u gjjend
4	V Z	L11304029O	Veprimtarite e lendes se druri	J.Zh A.K	2021-000146 - 2/1 Datë: 09/09/2021	Subjekti nuk u gjjend i mbyllur
5	B &	L62206043R	Veprimtari te tjera	A.B E.D	2021-000181 - 2/1 Datë: 25/10/2021	Subjekti nuk u gjjend i mbyllur
6	O.V 2		prodhimin e perpunimin e produkteve te peshkut	E.D Ramis Xhurxhi	2021-000171	Subjekti ka deren e mbyllur dhe dergimi i njoftimit te autorizimit me poste nga ARM Tirane Durres Diber

						eshte kthyer mbrapsh.
7	D&O	Industri energjitike	L72107050D	21/10/2021	Nr. AKM-TR-2021-000204 – 2	Subjekti nuk u gjet,
8	K Shpk	lyerjes/veshjes aplikuar në materiale lëkure	L72307018A	14/10/2021	-2021-000183 – 2	Inspektimi nuk u krye. Subjekti rezulton i mbyllur

-Në 8 rastet e mësipërme për subjektet e mbyllura gjatë kryerjes se inspektimi nuk është bërë verifikimi në QKB, nëse subjekte janë aktive apo kanë mbyllur aktivitetin. Veprime që bien në kundërshtim me ligjin e sipërcituar.

Nr1	B G	Magazinim , rikuperim i hekurishteve, skrapeve të metalit ose çmontimi i mbetjeve nga motorrët e makinave. Riparim i pajisjeve motorike dhe motoçikletave	K72205009J	Anulluar	Anulluar
1	D.P	Shfrytëzim I mineralit të kromit me galeri	K87530903A	Anulluar	Anulluar
2	A	Shfrytëzim I mineralit të kromit	J86906401D	Anulluar	Anulluar
3	E	Shfrytëzim I mineralit të kromit	K06626413S	Anulluar	Anulluar

-Për anulimin e 3 subjekteve pasi janë hedhur ne sistemin online , mbanë përgjegjësi Drejtori I ARM-së, si dhe përgjegjësi I sektorit të mjedisit për pezullim të pa justifikuar dhe mos planifikim i saktë.

Observacion: Agjencia Rajonalë e Mjedisit Tiranë Durrës Dibër, me shkresën nr .496/16 ka protokolluar paranë KLSH observacionet me nr. 155/3 prot., datë 08.04.2022,
arsyetim të bërë ndaj akt-konstatimit të grupit të auditimit, për subjekte sipas rasteve nga inspektorët Gerson Tafa, E.D,J.Zh,A.K, B.D, F.M M.K,A.B ,R.XHI.M, I.A B.Cdhe F.M më poshtë.

1-Subjekti **A E** shpk,me shkresën nr. 1929 datë 29.04.2021, ka protokolluar pranë AKM –së, raportet e monitorimit plan menaxhimit, plan menaxhimi të mbetjeve, raport testim analiza uji, plan menaxhimi mbetjeve.

2-Subjekti"**K**''nuk është realizuar për shkaka të kushteve atmosferike është anuluar si inspektim.

3-Subjekti **LIM –EM** , është hedhur gabimisht pasi është realizuar në vitin 2022, jashtë periudhës objekt auditimi.

4-Subjekti **C** Bashkëlidhur raport vete monitorimi , regjistri I mbetjeve,

Observacion: ARM me shkresën nr.155/3 prot., datë 08.04.2022 në KLSH,
arsyetim të bërë ndaj akt-konstatimin e grupit të auditimit J.Zh dhe A.K ka paraqitur dokumentacioni bashkëlidhur si më poshtë

5- Subjekti **Z** -Kontratë shërbimi,
-Raport vjetore monitori dhe të mjedisit për nr. Prot.., 14801/1 datë 01.04.2021, pranë AKM së,
-Kontratë magazinimi rikuperim hekurishtesh.
-Përshkrim të monitorimit në mjedis,

6-Subjekti **I**, ka sjellë raportin vete monitorimit prot..1980 datë 05.05.2021 pranë AKM së.
- Raport vjetorë të mjedisit,

7-**E –Be** bashkëlidhur raporti vjetorë I monitorimit,
-Raporti I mjedisit,
8-Subjekti"**R.B**", Bashkëlidhur raport vete monitorimi nr prot 2825 datë 22.06.2020
Observacion: ARM me shkresën nr. 155/3 port., datë 08. 04. 2022prot.. në KLSH, arsyetim të bërë ndaj akt-konstatimin e grupit të auditimit, inspektorët M.K Flori an Mara E.D,
9-Subjekt"**J.B" ,**bashkëlidhur dokumentacioni, i dorëzuar pranë ARM datë 13.10.2021, Kontrata Shërbimi për mbetjet, teknike ,leja mjedisi për transportimin e mbetjeve,-kontrate për heqjen e llumrave nga vaska e dekantimit nga subjekte te licencuara.
planin e përputhshmërisë,
10-**Subjekti R** dokumentacioni bashkëlidhur,
regjistri I mbetjeve , raporti I vete monitorimit,
11- Subjektit **E** bashkëlidhur kontratën e shërbimit për trajtimi e llumrave .
12- Subjektit **A**bashkëlidhur raportet e monitorimit dhe vete monitorimit datë 01.12.2021 pro ..6067/3,zbatimin e kushteve që plotësohen ne 3mujorin e parë të lejes.
-Programin e monitorimit të zhurmave ,
13-subjekti "**A"** bashkëlidhur dokumentacioni raporti i monitorimit,
14- **s**ubjekti **A**bashkëlidhur dokumentacioni raporti i monitorimit ,
Observacion: ARM me shkresën nr. 155/3 prot., datë 08.04.2022prot.. në KLSH, arsyetim të bërë ndaj akt-konstatimin e grupit të auditimit, F.M, B.D ,
15-subjektet**S-Ca**bashkëlidhur leja mjedisore,
16-**Subjekti "Be'' I.M**bashkëlidhur dokumentacioni raporti vete monitorimit dhe kontrata e transferimit të mbetjeve Inspektorët R Xh,
Inspektorët R X,
17-Subjekti **AGS 2** R.XHB.Cbashkëlidhur raporti I vetë monitorimit
18-Subjekti **E** , inspektor F.M,
Qëndrimi i grupit auditues: Grupi i auditimit, pasi shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, mori në konsideratë, pjesërisht komente dhe ka bërë ndryshimet përkatëse në Raport Përfundimtarë.
<u>Praktika që në sistem janë konstatuar pa shkelje të kërkesave ligjore sipas inspektimeve por bashkëlidhur mungon dokumentacioni.</u>
1-Subjekti **A** Lloji i aktivitetit ekonomik "Industria kimike" inspektuar në datë: 03/11/2021, me inspektor, **A.B E.D,**në inspektime theksohet se subjekti plotëson gjithë kushtet e lejes sipas, por sipas Ligjit nr. 10433 dt. 16.06.2011"Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", çdo inspektim duhet të shoqërohet me dokumentacion shoqërues dhe vërtetues, në ketë rast në sistem nuk ndodhet dokumentacioni.
2-**Me procesverbalin** -2021-000126 - 2/ datë: 30/08/. Emri i Subjektit **A.l** Lloji i aktivitetit ekonomik Prodhime te ndryshme, betoni, hekuri" me inspektorë **B.D dhe F.M**,në pv shprehen se subjekti nuk ka shkelje por bashkëlidhur nuk ka asnjë dokumentacion shoqërues veprime që bien në kundërshtim me ligjin nr. 10433 dt. 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", çdo inspektim duhet të shoqërohet me dokumentacion shoqërues dhe vërtetues, si dhe ligjit 202/2020 "Për lejet e Mjedisit"shtojca 4.1.
3-Me procesverbalin nr-000266-2/1Datë:14/12/2021,Emri i Subjektit "**R** **"** Lloji i aktivitetit ekonomik "Industritë prodhuese te makinerive dhe pajisjeve" me inspektor S.V,në sistem online ne liste verifikimnëpv dhe vendim përfundimtarë shprehen se i plotëson të gjitha kushtet e lejes bashkëlidhur, nuk ndodhen raportin monitorimit, vete monitorimit i dorëzuar në AKM , në këto kushte duhej marrë masë administrative.
4-Me procesverbalin nr-2021-000264 -2/1 Datë: 10/12/2021, Emri i Subjektit **C k** Lloji i aktivitetit ekonomik "Veprimtaritë qe përfshijnëpërdorimin e sol enteve" inspektorët **F.M**

B.D, në pv dhe vendim përfundimtarë shprehen se subjekti nuk ka shkelje, bashkëlidhur mungon dokumentacioni justifikues në kundërshtim me ligjin nr.10433 dt.16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë",çdo inspektim duhet të shoqërohet me dokumentacion shoqërues dhe vërtetues. në këto kushte

Observacion: ARM me shkresën nr. 155/3 prot., datë 08.04.2022 prot…në KLSH, arsyetim të bërë ndaj akt-konstatimin e grupit të auditimit, për subjektet

1-Subjektit **M**

bashkëlidhur raportet e monitorimit dhe vete monitorimit datë 01.12.2021 prot.. 6067/3,zbatimin e kushteve që plotësohen ne 3mujorin e parë të lejes.

-Programin e monitorimit të zhurmave

2- Subjekti **R**

bashkëlidhur dokumentacioni I hedhjes në sistem nga inspektorët

Observacion: ARM me shkresën nr.155/3 prot., datë 08.04.2022 prot…në KLSH, arsyetim të bërë ndaj akt-konstatimin e grupit të auditimit, për subjektet F.M B.D.

3-Subjekti''**G**

',RXh dhe A.B **,** bashkëlidhur dokumentacioni**,** raporti i vetë monitorimit,

4-Subjekti"'**Go G**

Studio", bashkëlidhur dokumentacioni me prot 6719 datë 29.12.2021,në AKM ,

5- Subjekti **E,** inspektorët F.M dhe B.D, bashkëlidhur kopje e dokumentacionet nga sistemi.

Qëndrimi i grupit të audituesë Grupi i auditimit, pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës dhe dokumentacion vërtetues mori në konsideratë pjesërisht, komente dhe ka bërë ndryshimet përkatëse në Raport Përfundimtarë.

Konkluzion:

-Nga inspektorët për gjithë periudhën objekt auditimi nuk ka një material informues për realizimin e planit për çdo muaj duke shtjelluar hollësisht problemet e konstatuara dhe masat shtrënguese të marra në përputhje me të drejtën e inspektorit për vendim.

-Në asnjë rast nuk janë hartuar raporte javore apo mujore për evidentimin e subjekteve që kanë probleme në fushën e inspektimit dhe mbi ketë bazë të hartohen planet mujore të inspektimit. -Një inspektim konkret autorizohet, si rregull, në bazë të programit të inspektimit. Programimi i inspektimit hartohet nga vetë inspektorati, bazuar në metodologjitë e vlerësimit të rrezikut dhe në detyrimin për inspektimin të parashikuara nga ligjin i posaçëm.

-Janë konstatuar pa rregulluesi në plotësimin e listë verifikimit mbajtjen e procesverbaleve si dhe në hartimin e vendimeve përfundimtarë.

-Në të shumtat e rasteve në sistemin online nuk gjendën bashkëlidhur i gjithë dokumentacioni për çdo subjekt në rastet kur shprehen se subjekti plotëson të gjitha kushtet e lejes.

Për veprimet e trajtuara në këtë material mbajnë përgjegjësi inspektorët Gerson Tafa, B.C,E.D, J.Zh, A.K, F.M, Florian Mara,I.M, S.vB.D dhe I.A.

Lidhurme **Trajnimet e inspektoreve** për periudhën e audituar **konstatohet se** nga inspektorati nuk janë kryer, trajnime detyre kjo e përcaktuar nenenin16, pika a, ë, f, te ligjit. Ne këtë kuadër nuk janë kryer testimet fillestare dhe periodike të inspektoreve, *ne zbatim te pikës g, të nenit 16 te ligjit.*

Pra nuk është zbatuar neni 21 i ligjit, "Kualifikimi dhe testimi i inspektoreve, pika1. Inspektorët shtetërorë dhe vendorë u nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm dhe testimit profesional fillestar përpara konfirmimit në përfundim të periudhës së provës dhe testimit periodik. Testimi profesional fillestar dhe ai periodik bëhen në bazë të një provimi që organizohet nga Inspektorati Qendror".

Rekomandim;Të merren masa për kryerjen e trajnimeve të inspektoreve sipas ligjit të sipërcituar, pasi ka parregullsi në mbajtjen e pv,

Nga auditimi me zgjedhje në sistem e-inspektimeve rezulton se;

*Në 3 praktikat inspektorët në liste verifikim pv dhe vendimin përfundimtarë shprehen se subjektet nuk kanë shkelje të kërkesave ligjore , por në asnjë nga rastet e mësipërme nuk kanë dokumentacionin shoqërues dhe vërtetues,veprime këto që bien në kundërshtim me ligjet e sipërcituara, në mos plotësim dokumentacioni nga inspektorë , këto veprime janë në shkelje të kërkesave ligjore, të cilat përbëjnë të ardhur të munguar në buxhetin e shtetit (3*300,000=900,000 lekë).*

Për veprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi punonjësit e trajtuar ne akt konstatim.

Për Trajtimin e ankesave pranë ARM Tirane Dibër Durrës ka zyra informacioni të cilat janë marrë kryesisht me kthim përgjigjesh në portal, ku për vitin 2021 janë trajtuar dhe kthyer përgjigje 100 ankesa të ardhura me shkresë institucionale kryesisht ndotje akustike , etj që nuk përfshihen në lejet tpit B, si dhe kthim përgjigje ankesash në portal mbi 90 raste të gjitha brenda afateve, nga specialistët e informacionit pranë ARM Tiranë, F.k Sh L, ndërsa zyrat në rrethe janë angazhuar për veç marrjes së ankesave dhe ne mendime për VNM apo mendime për Leje Mjedisore.

Nga shqyrtimi i ankesavë të sjella në subjekte dhe të protokolluara në AKM

Janë protokolluar 110 ankesa të ciat janë kthyer përgjigje dhe në portal dhe në rrugë zyrtare.

kanë marrë përgjigje 14 ankesa pa përgjigje 12 ankesa.Nga këto ankesa pa përgjigje u konstatuan pa rregulluesi në kthim përgjigjes,

1-Me ankesën e ardhur në datë 14.06.2021 , nga AKM për verifikim ankese nga znj. Sh S., në fasoneri ne Durrës,

E metë :

nga ana e titullarit nuk është kthyer, përgjigje,

E metë :

2-Me ankesën nr.5503/2 datë 02.12.2021,delegim kompetencë, të sjellë në AKM-së,

nga anketuesi të sjellë nga qytetari Sh.H. për ndotje ambienti nga një subjekt që pret gurë ,dhënë për shqyrtim specialistes **S.V** pa kthim përgjigje,

-E metë

Anketuesit nuk i është kthyer përgjigje.

3-Me shkresën nr. datë 07.12.2021, të protokolluar pranë ARM-së, është kthyer përgjigje për subjektin G&B Petrol nga inspektoret **M.S**, që subjekti duhet ti pezullohet aktiviteti ndërkohë që ndaj subjektit duhej marrë masë administrative për mos pajisje me leje. Bashkëlidhur nuk ka dokument verifikues për verifikimin në terren .

E metë

Ankuesit nuk i është kthyer përgjigje.

4-Me shkresën nr472/1 datë 13.07.2021, ankesë ë sjell nga Kryesia e Bashkëpronarëve ku ankohen për kompleksin lura –për erat dhe gazrat që shkaktohen sidomos gjatë periudhës së verës ngarkuar inspektori **I.A,**

E metë

Anketuesit nuk i është kthyer përgjigje.

5-Me shkresën nr. 3428 datë 19.07.2021, të sjellë nga AKM , protokolluar në 19.07.2021, ne ARM ankesa e drejtuar AKM nga një qytetarë ne lidhje me një subjekt që kryen tregtim peshku, ne adrese Bulevardi "'Bajraam Curri"'

Titullari i ka ngarkuar për ndjeje te ankesës S.V ,

E metë

Ankuesit nuk i është kthyer përgjigje.

6-Me shkresën nr.471/1datë 13.07.2021, ankese e sjellë nga Prefekti i Qarkut Durrës, sjellë ankesën e një grupi banorësh për një subjekt që nga aktiviteti që zhvillo krijon ndote në mjedis,

Drejtori ka ngarkuar për ndjekjen e kërkesës I.A.

E metë

Ankuesit nuk i është kthyer përgjigje.

7- Me shkresën me nr 3580/1 datë 16.09.2021 të sjelle nga AKM , bashkëlidhur nuk ka ankese vetëm shkresa e AKM në të cilën citohet se subjekti 'Coca- cpla Bottling" ka bllokuar procedurën për asgjësim të produktit nga inspektorët e ARM Tirane Durrës Dibër,
Ngarkuar për ndjekjen e praktikës I.A.
Të Meta :
Anketuesit nuk i është kthyer përgjigje.
8-Me shkresën datë 14.09.2021, Avokati i Popullit , ka përcjelle pranë ARM –së, ankesën në lidhje me një peticion te banoreve Spital Durrës, ne lidhje me pretendimin se banorët kanë shqetësim me ndotjen e mjedisit nga një subjekt që me ""konservim peshku".
Ngarkuar për ndjekjen e praktikës **S.V.**
E metë Ankuesit nuk i është kthyer përgjigje.
Theksojmë se këto janë disa nga ankesat me zgjedhje, pasi dhe pjesa tjetër kur janë kthyer përgjigje jo në të gjitha rsatet, janë të dokumentuara me dokument verifikim nga inspektorët në terren.
-Këto veprime janë në kundërshtim, pasi rastet kur nuk u është kthyer përgjigje zyrtare por dhënë përgjigje pa dokumentacion vërtetues bashkëngjitur nga ARM Tiranë, Durrës Dibër. Mbanë përgjegjësi ish /Drejtori i ARM -së.
-Deri sa ky informacion është protokolluar pa tjetër duhet të ishte verifikuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 17,19 pika 3dhe 4,"Për përpilimi, shtypja, shumëfishimi dhe evidencimi i dokumenteve" dhe neni 21" Për dorëzimin e dokumenteve në rrjetin arkivor" të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 " Për Arkivat" dhe Kreun e III-të "Njoftimet dhe afatet Kohore për bërjen e tyre, neni 56, detyrimi për tu njoftuar, neni 59 Afatet kohore për njoftim dhe afatet kohore për zbatimin e akteve administrative të Ligjit 8485, datë 12.05.1999" Kodi Procedurës Administrative" me ligjin "Për të Drejtën e informimit "si dhe me Rregulloren e brendshme Për organizimin dhe funksionimin Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tirane Durrës Dibër dhe ngarkon me përgjegjësi te gjithë punonjësit e lartë përmendur, si dhe ish/Drejtorin e ARM- së,

Pika4,1. Auditimi mbiraportet e vetemonitorimit

Raportet e vetmonitorimit Subjektet që janë pajisur me leje mjedisi Tipi A/B, bazuar në Ligjin "Për lejet e Mjedisit" dhe në rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit me Nr.prot.120, datë 12.01.2021 "Rregullore e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit", duhet të dorëzojnë raportet 6 mujore të vetmonitorimit pranë ARM-ve përkatëse.

Numri i raporteve të vetmonitorimit pranë ARM Tiranë, Durrës, Dibër të dorëzuara sipas muajve:

PeriudhaKorrik –Dhjetor 2020

Muaji	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Numri i raporteve te vetmonitorimit	11	3	34	10	5	9

Periudha Janar –Dhjetor 2021

Muaji	Numri i raporteve të vetmonitorimit
Janar	5
Shkurt	4
Mars	2
Prill	4
Maj	13
Qershor	8

Korrik	0
Gusht	0
Shtator	2
Tetor	1
Nëntor	2
Dhjetor	2

Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, raportet e vetmonitorimit të sipërmendura i ka përcjellë me shkresë përcjellëse Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si pasojë e urdhërit nr.77, datë 02.07.2020 të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Në datë 02.07.2020, drejtori i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ka nxjerrë urdhër me shkrim " Për proçedurën e dorëzimit / pranimit të dokumentave dhe raporteve të monitorimit " pika 1, ku citohet "*Të gjitha dokumentet dhe raportet e vetmonitorimit mbi zbatimin e kushteve të lejes mjedisore të Tipit A dhe B, të dorëzohen dhe të protokollohen në protokollin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me shkresë përcjellëse mbi dokumentacionin e paraqitur sipas pikës 3 , në formatin CD",* veprime këto që bien ndesh me nenin 27 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i proçedurave administrative të Republikës së Shqipërisë". Përsa më lart, urdhëri i sipërcituar e ka lënë sektorin e monitorimit pranë ARM-ve pa përmbushur detyrat funksionale të sektorit.

Konkluzione:

Nga auditimi rezultoi se sektori i monitorimit pranë ARM Tiranë, Durrës, Dibër nuk ka përmbushur detyrat e sektorit përkatës për të grumbulluar dhe menaxhuar raportet e vetmonitorimit si pasojë e urdhërit Nr. 77, datë 02.07.2020, të drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Theksojmë se Urdhëri Nr. 77, datë 02.07.2020 është në kundërshtim me nenin 27 të Kodit të Proçedurave Administrative, që kur ka konkurrim kompetencash ndërmjet dy institucioneve (AKM-ARM), konflikti në rastin konkret zgjidhet vetëm nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit.

Pika4,2, -Nga auditimi kryer mbi masat administrative (Gjoba).

Në zbatim të misionit dhe të funksionit të tij, ARM, është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushat përkatëse në përputhje me përgjegjësitë në juridiksionin tij për mjedisin, ujëra që burojnë nga kuadri rregullator në fuqi (ligjit nr. 10279 dt 20.5.2010 "Për kundërvajtjet Administrative", ligjit nr. 10433 dt 16.6.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 10431, dt 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore", ligjit nr. 10448 dt 14.7.2011 "Për lejet mjedisore",

Dokumentet që u audituan :

-Data bese e gjobave te mbajtur nga Juristi për sektorin e Mjedisit

-Shkresat përcjellëse te sjella nga Inspektorati Qendrore ne rastet e ankimit te kërkuara nga ARM.

-Shkresat përcjellëse të paraqitura në Inspektoratin Qendrore për gjobat e vendosura për sektorin e Mjedisit

-Shkresat përcjellëse te nisura nga kryeinspektori pranë gjykatës administrative Tiranë.

-Shkresat përcjellëse të nisura përmbarueseve privat në rastet e kthimit përgjigje nga Gjykata Administrative Tiranë të kthyera ne titull ekzekutiv.

-Shkresat përcjellëse ne lidhje me shoqëritë përmbarimore të cilat kane kontrate të lidhur me Inspektoratin Qendrore Tiranë.

Për periudhën e audituar theksojmë se ndjekjen e procesit përmbarimorë ndaj subjekteve te marra masa administrative nga ARM Tirane për çdo urdhër ekzekutiv është lidhur ne nivel qendrorë nëpërmjet palës kreditore AKM dhe Përmbaruesit. Ne përbërje të strukturës së Inspektimit të ARM Tirane , për vitin Korrik2020-2021, janë: Sektori i Inspektimit Mjedisor dhe Sektori i Inspektimit të

ARM; Në përbërje të strukturës së Inspektimit të ARM Tiranë , për vitin korrik 2020-2021 janë: Sektori i Inspektimit Mjedisor; Sektori i Inspektimit të ARM, Sektori i Inspektimit Ujerave.

Mbështetur në dispozitat ligjore që janë në fuqi i cili parashikon sanksione administrative dhe rregullores së brendshme të miratuar nga ARM 120 datë -12.01.2021 rezulton se sektorët e sipërcituar kanë kompetenca për të vendosur sanksione administrative për shkeljet e dispozitave ligjore në fushën e mjedisit, pyjeve, ujërave dhe turizmit.

Arkëtimi i gjobave nga shkelësit e ligjit janë të ardhura nga veprimtaria kryesore e institucionit dhe si të tilla derdhen në buxhetin e shtetit.

Referuar këtyre drejtimeve grupi i auditimit kërkoi të dhëna në drejtim të inspektimeve të kryera, gjobave të vëna si dhe ndjekjes së tyre, për efekt të masave të marra në drejtim të përmirësimit të punës, arkëtimit të gjobave të vëna shkelësve të ligjit.

Nga grupi i auditimit referuar të dhënave të vëna në dispozicion u arrit në konkluzionin se nuk është likuiduar vullnetarisht asnjë masë administrative gjobë .

Për likuidim vullnetar kompetenca për kryerjen e këtij veprimi mandatet e arkëtimit mund te merën nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, AKM dhe nga ARM Dega Rajonale Tiranë. Për gjobat e paguara përmes studiove përmbarimore mandatet e pagesave merren nga AKM. Për derdhjen vullnetare dhe për mandatet të cilat janë marrë nga AKM , informohemi nga sistemi i thesarit qe na i dërgon ministria.

Për periudhën korrik**2020-2021**, nga inspektorët e ARM Tirane nga sektori e inspektimit Mjedis janë marrë **–15** Vendime për Dënim Administrativ në vlerën **-10400 000**-lekë..

Për korrik**2020** janë marrë –**4**Vendime për Dënim Administrativ në vlerën –**800.000lekë.**

Për vitin 2021 janë marrë **-11** Vendime për Dënim Administrativ në vlerën –**9.600.000 lekë**

Për të dhënë një pasqyrë më të qartë mbi numrin e Vendimeve për Dënim Administrativ (gjobë) të vendosura gjatë vitit korrik**2020-2021**, nga ARM Tirane sipas fushave të inspektimit po japim të dhënat në tabelën nr. 1 sa më poshtë vijon:

Tabela nr. 1 Vendimet për Dënim Administrativ për të 2 sektorët periudha korrik**2020-2021,**

ARM Tirane	Gjoba nga Sektori i Inspektimit Mjedisor	
Viti	NR. Gjoba	Vlera në 000/ lekë
korrik**2020**	**4**	**800,000**
2021	**11**	**9600,000**
Totali	**15**	**10,400,000**

Statusi i 15 Vendimeve Administrative te ankimuara pranë Komisionit te Ankimeve														
	Gjoba të derguara ne përmbarim		**Gjoba në proces për titull ekzekutiv në Gjykatë**		**Gjoba të shlyera vullnetarisht**		**Gjoba në ankim gjyqësor , në proces**		**Gjoba në pritje mbarimit të afatit të ankimit administrativ**		**Gjoba të shfuqizuara**		**Totali i gjobave të vëna nga ARM Tirane**	
	Nr Gjoba	**Vlera leke (/000)**	**Nr. Gjoba**	**Vlera leke (/000)**	**Nr. Gjoba**	**Vlera leke (/000)**	**Nr. Gjoba**	**Vlera lek (/000)**	**Nr. Gjoba**	**Vlera lek (/000)**	**Nr. Gjoba**	**Vlera lek (/000)**	**Nr. Gjoba**	**Vlera lek (/000)**
Korrik 2020	2	**400000**	0	0	0	0	1	100000	0	0	1	300000	4	**800000**
2021	**4**	**4000000**	5	**2600000**	0	**0**	4	**3500000**	0	0	2	**3000000**	11	**9600000**

Totali	**6**	**4400000**	**5**	**2600000**	**0**	**0**	**5**	**3600000**	**0**	**0**	**3**	**3300000**	**15**	**10800000**

Siç shihet dhe në tabelën nr. 1,numri total i Vendimeve për Dënim Administrativ të mbajtur nga inspektorët e ARM Tirane është **15 gjithsej dhe në vlerën -10400000 lekë.**

Nga 15 subjekte ndaj të cilave janë vendosur sanksione administrative (gjobë) për vitin korrik 2021 dhe 2022,vetëm **9** prej këtyre kanë bërë ankim në rrugë administrative pranë Komisionit të Ankim imi të ARM-së Qendër.

Nëvitin **korrik 2020**jane vendosur 4 gjoba ,kane ankimuar 3 subjekte nga ku 1 subjekt*(ALB KALUSTVAN nr. serie 087-5 dt 12.11.2020,3192/1 date 12.08.2021*) është shfuqizuar nga KA, 1 Subjekt është shfuqizuar nga GJ SHK PARE TR, 2subjekte ka dale vendim i urdhrit për ekzekutim dhe janë dërguar në përmbarim.

Në vitin**2021janë vendosur 11 gjoba** janë ankimuar 6 subjekte , **2** gjobe janë shfuqizuar nga KA(*grand auto center Denimi adm nr serie 0195-5dt 06.10.2021shfuqizuar 5641 date 12.11.2021 dhe R Deadm nr serie 082-5 dt 18.08.2021shfuqizuar 5642 date 12.11.2021*), 9 janë dergj për urdhër ekzekutim, nga ku 4 subjekte ka dale vendim i urdhrit për ekzekutim dhe janë drg ne përmbarim, 4 subjekte janë në proces gjy gjsorë.

Theksojmë se institucioni ka hasur këto Problematika

- Komisioni i Ankimit pranë AKM ka nisur të funksionoi me VKM Nr 186 datë 25.03.2021 e cila ka penguar në ndjekjen e gjobave për ekzekutim, për arsye se ankimi administrativ është kusht ligjor për tu ezauruar përpara ankimit Gjyqësorë.
- Problematik është hasur lidhur me dërgimin e gjobave përmes postës. Lajmërim marrja nga subjektit kundërvajtës është mjaft e rëndësishme për arsye sepse këtu nisin afatet ligjore për ndjekjen procedurave për ekzekutimin e gjobave. Një pjesë e dërgesave postare kthehen, ose kur dërgohen lajmërim marrja në institucion vonon, kjo përbën një pengës për ndjekjen e gjobave.
- Problematik është hasur dhe me nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit nga Gjykata Administrative Shkalles së parë, e cila vonon në daljen e këtij vendimi. Herë pas here juristi e institucionit paraqitet pranë kësaj gjykate për tërheqjen e këtyre urdhrave (pasi nuk dërgohen me shkrese ne institucion) nga sekretaria e gjykatës nxjerrin justifikime për arsye vonesës se hedhjes se shortit ose nuk ka zbritur vendimi. I jemi drejtuar dhe me shkrese 198 prot date 11.02.2022.

Numri dhe vlera në total e Vendimeve për Dënim Administrativ që nuk janë ankimuar administrativisht dhe gjyqësish qe duhet të arkëtohet sipas procedurave të përshkruara në kuadrin ligjor në fuqi është**0.**

Për periudhën e vitit korrik 2020-2021, ARM Tirane, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesë për nxjerrjen e urdhrit ekzekutiv për 11vendime dënimi administrativ, për 6 subjekte ka dale urdhërim i ekzekutimit të cilat janëdërguarpërmbaruesit për ekzekutim nga ku, 5vendime dënimi adm janënë pritje të lëshimit të urdhrit ekzekutiv .

Nga sanksionet e vendosura nga sektorët e ARM Tirane ,numri i Vendimeve për Dënime Administrative të dërguara në Gjykatën Administrative të Shkalles së Parë Tiranë, për t'u shndërruar në titull ekzekutiv, paraqitet në tabelën sa më poshtë vijon:

Tabela nr.3 Vendimet për Dënim Administrativ të ankimuara dhe të pandikuara, të dërguara në gjykatën Administrative të Shkalles se Parë Tiranë për t'u shndërruar në titull ekzekutiv.

Periudha	Sektori i Inspektimit Mjedisor

	Nr. Gjoba	Vlera lek (/000)
Korrik 2020	**2**	**400,000**
Vit2021	**9**	**5,700,000**
Totali	**11**	**6,100,000**

Nga Kundërvajtjet administrative të konstatuara në vitin korrik2020 për të cilat janë mbajtur 4 vendime dënim administrativ, janë dërguar për nxjerrje të titullit ekzekutiv 2 Vendime për Dënim Administrativ nga ku 2 ka dal vendimi i urdhrit të ekzekutimit dhe është dërguar ne përmbarim, ndërsa 1 Vendime është shfuqizuar nga KA,1 Vendim është shfuqizuar nga GJ ADM shkalla parë Tiranë.
Nga Kundërvajtjet administrative të konstatuara në vitin 2021 për të cilat janë mbajtur 11vendime për dënim administrativ, 9gjoba janë dërguar për nxjerrje të titullit ekzekutiv nga ku 4 ka dal vendimi i urdhrit te ekzekutimit dhe janë dërguar ne permbarim,2 vendim dënimi adm është shfuqizuar nga KA , 4 subjekte ndodhen ne proces gjyqësorë.
Numri i Vendimeve për Dënime Administrative për të cilat është pranuar kërkesa dhe është nxjerrë Titull Ekzekutiv nga Gjykatës Administrative të Shkalles se Parë Tirane referuar tabelës nr. 4 , janë6 Vendime për Dënim Administrativ në vlerën **4,400,000**lekë. Nga ku 5jemi ne pritjet vendimit për lëshimin e urdhrit te ekzekutimit nga gjykata adm shkalla parë Tiranë.
Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna për numrin e Vendimeve për Dënim Administrativ për të cilat ARM Tirane i është drejtuar për titull ekzekutiv Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tiranë, dhe i ka pranuar kërkesat dhe i ka kthyer në titull ekzekutiv:

Tabela nr. 4 Nr. i Titujve Ekzekutiv

Nr i Vendimeve me Dënim Administrativ të kthyera në Titull Ekzekutiv nga Gjykata Administrative të Shkalles se Pare Tiranë		
	Sektori i Inspektimit Mjedisor	
	Nr. Gjoba	**Vlera lekë (/000)**
Korrik 2020	2	400,000
2021	4	4,000,000
Totali	**6**	**4,400,000**

Numri i Vendimeve për Dënime Administrative të cilat janë ende në proces në Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tirane paraqitet në tabelën sa më poshtë vijon:

Vendime administrative (Në proces)		
	Nr. Gjoba	**Vlera lek (/000)**
Korrik 2020	1	100,000
2021	4	**3,500,000**
Totali	5	3600000

Sipas nenit 9 "Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative" të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk

ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarimor, sipas këtij ligji. Pra për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv të nxjerrë nga Gjykatës Administrative të Shkalles se Parë Tiranë lidhet një marrëveshje me shërbimin përmbarimor gjyqësor privat.

Në tabelën e mëposhtme jepet në mënyrë të përmbledhur numri i Vendimeve për Dënim Administrativ të shndërruar në Titull Ekzekutiv për të cilët i është bërë kërkesë studive përmbarimore që ofrojnë shërbimin e tyre Mbi rezultatet e ekzekutimit të vendimit të gjobave përmbaruesit kanë njoftuar vetëm AKM Qëndër , nuk ka informacion të mëtejshëm.

Tituj ekzekutiv për ekzekutim		
	Nr. Gjoba	**Vlera lek (/000)**
Korrik 2020	2	400,000
Viti 2021	4	4,000,000
Totali	**6**	**4,400,000**

Për 6 kërkesa të pranuara nga Gjykata Administrative të Shkalles së Parë Tirane që janë shndërruar në titull ekzekutiv të cilët janë dërguar nga ana e juristit, Përmbarimi ka filluar procedurat për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

Për të dhënë një pasqyrë më të qartë mbi numrin e Vendimeve për Dënim Administrativ (gjobë) të vendosura gjatë viti korrik2020 dhe 2021, nga ARM Tirane sipas, statusit aktual të numrit te vendimeve dhe vlerave te tyre paraqitet në tabelën sa më poshtë vijon:

Tabela e përgjithshme e vendimeve administrative për vitet korrik2020 dhe 2021

Vendime administrative për vitet tetor/2020 dhe2021														
	Gjoba të derguara ne përmbarim		Gjoba në proces për titull ekzekutiv në Gjykatë		Gjoba të shlyera vullnetarisht		Gjoba në ankim gjyqësor , në proces		Gjoba në pritje mbarimit të afatit të ankimit administrativ 0 (ne ndjekje)		Gjoba të shfuqizuara		Totali i gjobave të vëna nga ARM Tirane	
	Nr. Gjoba	Vlera lek	Nr. Gjoba	Vlera lek	Nr. Gjoba	Vlera lek	Nr. Gjoba	Vlera lek (/000)	Nr. Gjoba	Vlera lek (/000)	Nr. Gjoba	Vlera lek (/000)	Nr. Gjoba	Vlera lek (/000)
Viti 2020	2	400000	**0**	**0**	0	0	1	100000	0	0	1	300000	4	**800000**
2021	4	4000000	5	**2600000**	0	0	4	**3500000**	0	0	2	3000000	11	**9600000**
Totali	**6**	**4400000**	**5**	**2600000**	0	0	5	3600000	0	0	3	3300000	15	**10400000**

Lidhur me dorëzimet e praktikave të proceseve gjyqësore dhe praktiket e vendim dënimeve administrative (gjobat)nga ish-ISHMPUT (ISHMPUT Dega Tiranë,ISHMPUT Dega Dibër dhe ISHMPUT Dega Durrës),

Gjobat e vendosura nga **ish - ISHMPUT Dega Tiranë**, duke qene specialist jurist e ish - ISHMPUT Dega Tiranë në bazë të Urdhrit të AKM-së Nr.72 dt.30.06.2020 se bashku me specialisten e financës të ish- ISHMPUT , kanë kryer dorëzimet pranë Komisionit të marrjes në dorëzim pranë ARM Tiranë, Durrës, Dibër të aseteve dhe dokumentacionit arkivor të ish- ISHMPUT Dega Tirane më date 7.07.2020 nr. 1 prot. si dhe i gjithë dokumentacioni lidhur me proceset gjyqësore dhe ndjekjen e procedurave të vendim Dënimeve Administrativ të Vendosura nga ish-ISHMPUT Dega Tiranë me nr. 1/1 prot. datë 7.7.2020. Dorëzimet janë kryer me proces verbal inventarizimi për çdo dosje të juristit, financierit dhe arkiv-protokoll të ish-ISHMPUT Dega Tiranë,

Ju bëjë me dije se është vijuar me ndjekjen e procedurave për gjobat e ish-ISHMPUT Dega Tirane dhe aktualisht .

- 207 gjoba janë dërguar në përmbarim me vlere 50,905,000 leke,
- 48 gjoba janë animuar pranë Gjykatës ADM, nga të cilat 25 kanë përfunduar dhe janë dërguar në përmbarim18 ndodhen në proces gjyqësoren apel në vlere 19,100,000 dhe 5 procese gjyqësore janë të humbura ne vlere 1900,000 lekë.
- 33 gjoba të shfuqizuara nga Komisioni i Ankimit pranë ish-ISHMPUT në vlere 2,7790,000 lekë.

Për gjobat e vendosura nga **ish -ISHMPUT Durrës** nuk ka informacion për arsye se specialisti jurist i saj nuk ka dorëzuar asnjë dokumentacion lidhur me gjobat dhe proceset gjyqësore.

Lidhur me dokumentacionin e **ish-ISHMPUT Dibër**, në bazë të urdhër nr. 20 dt. 14.09.2020 është ngritur Komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve dhe dokumentacionit arkivor për ish-ISHMPUT Dibër.

Juristi i ish-ISHMPUT Dibër Krenar Islami, përmes emalit ka dërguar data basë të gjobave për këte institucion dhe fizikisht ka dorëzuar gjobat për Sektorin e Mjedisit si dhe për Sektorin e Pyjeve pranë Komisionit.

Nënvizoj se dorëzimet e dokumentacionit nga juristi i ish ISHMPUT Dibër nuk kanë qenë të shoqëruara me proces-verbal inventarizim dosjesh. Dosjet nuk kanë qenë të mirë organizuar për secilin subjekt kundërvajtës, dhe ka patuar shumë mangësi.

Nga gjobat ish-ISHMPUT Dibër rezultojnë kryesisht gjoba të vitit 2014-2016 nga të cilat;

- 13 gjoba janë dërguar në përmbarim të cilat janë ekzekutuar ne vlere 7000 000
- 21 gjoba janë ankimuar pranë gjykatës ADM nga të cila 10 procese kanë përfunduar dhe janë dërguar në përmbarim 8 ndodhen në proces (apel, rekurs) 4000 000 dhe 3 procese gjyqësore kanë humbur.
- 6 gjoba janë shfuqizuar nga Komisioni Ankimit pranë ish – ISHMPUT në vlerë 3,500,000

Gjobat që janë të trashëguara nga ISHMPUT, nuk ndiqen me pasi kanë kaluar të gjitha afatet për arkëtim duke përjashtuar raste që janë n zyrat e përmbarimit.

Nga auditimi rezulton se të gjitha gjobat e ARM Tiranë janë brenda afatit të parashkrimit .

Të merren masa nga specialisti i financës dhe Drejtori i ARM –së, që të ndiqen të gjitha rrugët ligjore, për vjeljen dhe arkëtimin e gjobave mbarna afateve të përshkruara në ligj,

Pasi nga tabelat dhe të dhënat e mësipërme konstatohet një përformance e ulet nga institucionet që kanë pas detyrimin ligjorë për vjeljen dhe arkëtimin e gjobave.

-Titullari Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, të njoftojë zyrtarisht, Drejtorinë juridike në AKM që të sigurojë zbatimin e urdhrit të Ministrit të MTM nr.54 dt 24.2.2020, pasi nga ish juristi i ISHMPUT Durrës nuk është dorëzuar asnjë e dhënë mbi gjobat e ish-ISHMPUT Durrës, statusin e tyre dhe dokumentet që shoqërojnë ato.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër mungon grupi i punës së Menaxhimit Strategjik (GMS-së), i cili nuk është krijuar sipas nenit 27, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", sipas ligjit 9936, datë 21.07.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, dhe udhëzimeve përkatëse për hartimin e PBA. Për periudhën kohore 01.07.2020 deri në 31.12.2021, nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër nuk është përgatitur raporti i monitorimit përfundimtar dhe raportet periodike të

monitorimit të buxhetit, në kundërshtim me nenin 65, Kreu VIII të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar" (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe nr.11-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa për krijimin e grupit të punës, si dhe për çdo vit buxhetor të përgatisë raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit, sipas udhëzimeve përkatëse për hartimin e PBA-së.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ditarët e veprimeve kontabël nuk mbaheshin në përputhje me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël". Nuk është kryer kontabilizimi i fletë hyrjeve dhe fletë daljeve, pra nuk janë mbajtur kartelat dyfishe ne kundërshtim pika 34 germa e)të udhëzimit nr. 30. Date 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Nga Specialisti i financës nuk është hartuar bilanci i konsoliduar për dy DRM-të, sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, në Njësitë e Qeverisjes se Përgjithshme". (*Më hollësisht trajtuar në pikën2, faqe nr.17-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike (ose Sektorin e Financës), të marrë masat për të çelur ditarët kontabël dhe të pasqyrojë veprimet ekonomike sistematikisht dhe në mënyrë kronologjike, si dhe të kuadrojnë bilancet përkatëse në një bilanc të konsoliduar**.**

Menjëherë dhe në vazhdimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në momentin e fillimit të inventarizimit në objekt, anëtarët e komisionit të inventarizimit nuk kanë përpiluar deklarata për konflikt të interesit me punonjësit me përgjegjësi materiale, ose që kanë në përdorim aktive, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 "*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*" dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011"*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", pika 82.

Nga komisioni i inventarizimit nuk është kryer inventarizimin e llogarisë 215 "Mjete transport", por janë mbajtur vetëm procesverbale marrje dorëzim mbi gjendjen fizike, nuk janë hapur kartela përkatëse për çdo mjet ku të jenë firmosur nga personat që i kanë në përdorim.

Komisioni inventarizimit fizik në përfundim të procesit nuk ka përgatitur raportin informues për të paraqitur te Titullari i njësisë shpenzuese, informacionin mbi gjendjen fizike të vlerave të aktiveve, veprim në mospërputhje me pika 85, germa (c) dhe 86 e UMF nr.30,datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* **(***Më hollësisht trajtuar në pikën2.2 faqe nr.25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi : Drejtori i ARM Tiranë, Durrës dhe Dibër në bashkëpunim me Sektorin e Financës, të marrë masa për ngritjen e grupit të inventarizimit të llog. 215 "Mjete transporti", si dhe të monitorojë zbatimin e urdhrit të ngritur mbi punën e komisionit.

3.2. Rekomandimi: Sektori i Financës të krijojë regjistrin e aktiveve si dhe të hapë kartelat individuale për çdo punonjës, për aktivet që kanë në ngarkim.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk ka bazë të dhënash të subjekteve të pajisura me leje mjedisore, të ndara sipas tipit të tyre dhe ndikimeve që ato kanë në mjedis,

mbi bazën e të cilave të hartojë programet vjetore dhe mujore të inspektimit bazuar mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut. Në planifikimet vjetore e mujore dhe në inspektimet e kryera, nuk janë përfshirë një masë e konsiderueshme e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në Qarkun e Tiranë, Durrës, Dibër, për 6/mujorin e dytë 2020, janë anuluar 36 inspektime pasi janë hedhur në sistem nga Titullari, autorizimet kanë të përfshira fusha të ndryshme të veprimtarisë së subjekteve të pajisura me leje mjedisore, në kundërshtim me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2, nenet 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit". Po ashtu, nuk ka metodologji konkrete për llogaritjen e riskut dhe frekuencën e inspektimit gjatë një vetitë subjekteve që do të inspektohen (*Më hollësisht trajtuar në pikën4, faqe nr.56-76 të Raport Përfundimtare të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër të marrë masa për krijimin e regjistrave të subjekteve që ushtrojnë aktivitet si dhe krijimin e dosjeve për çdo subjekt objekt inspektimi. Në programet vjetore dhe mujore të inspektimit të pasqyrohen dhe inspektorët që kryejnë inspektimet, të hartohen në bazë risku, të përcaktohet në detaje inspektimi, duke u nisur nga informacioni paraprak për të gjitha subjektet që ushtrojnë aktivitetet në Qark, në bashkëpunim me institucionet e qarkut si Drejtoria Rajonale e Tatimeve, QKB, Bashki e Njësi Administrative si dhe institucione të tjera që janë objekte të ndotjes dhe mbetjeve integrale.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, programi vjetor i inspektimit për periudhën korrik 2020 dhjetor 2021, nuk është hartuar sipas përcaktimeve ligjore të bëra në shkronjat "a, c, ç dhe d" të pikës 2 të Urdhrit nr.5, datë 19.02.2015 "Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programimin e inspektimeve".
Gjithashtu programet mujore të inspektimit për periudhën korrik 2020 dhjetor 2021, nuk janë dërguar për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të Kreut IV të VKM nr.696, datë 16.08.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi". *(Më hollësisht trajtuar në pikën4, faqe (56-76) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

5.1.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër në bashkëpunim, me sektorët e inspektimit, të marrë masa për subjektet e inspektuara, të bëjë një vlerësim të paraqitjes së tyre ndaj respektimit të kërkesave ligjore, ku në bazë të këtij vlerësimi të bëhet ndryshimi i kategorizimit të riskut të tyre (i lartë, i mesëm, i ulët), e për rrjedhojë edhe frekuenca e inspektimit të tyre, gjatë planifikimit të inspektimit.

5.2.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër në bashkëpunim, me sektorët e inspektimit, të marrë masa që të gjitha programet mujore të inspektimit të përcillen për mendim pranë Inspektoratit Qendror

Menjëherë dhe në vazhdimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se mungonin relacionet dhe raportet e inspektimeve të kryera nga Sektorët e Mjedisit dhe Ujërave, pasi ato realizoheshin vetëm për nivelin faktik dhe jo të tabeluar dhe krahasuar me treguesit e parashikuar në planet vjetore, megjithëse planet vjetore mungonin.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 56-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që sektori i Mjedisit dhe Ujërave të hartojë raporte javore dhe mujore për njohjen

e problematikave të subjekteve të inspektimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në inspektimet e kryera në terren, për plotësimin e procesverbalit të inspektimit nuk është i gjithë informacioni i nevojshëm duke u bazuar në kushtet e lejes mjedisore që disponon subjekti dhe zbatimin e secilit prej kushteve, si dhe të gjitha mangësitë e konstatuara nga ushtrimi i aktivitetit, sipas inspektimit në terren nga ana e inspektorëve, nuk ka përshkrime specifike mbi situatën konkrete në terren dhe mënyrën se si subjekti i zbaton kushtet e lejes mjedisore, konstatimet e inspektorëve janë të përgjithshme dhe për rrjedhim detyrat e lëna kufizohen në plotësim të dokumentacionit, si dhe kryerjen e dërgimin e vetë monitorimeve. Detyrat që lihen nuk janë të lidhura me konstatimet konkrete të situatës në terren të kryera nga specialistë të fushës së mjedisit, veprime në kundërshtim me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" nenin 45-48,ku neni 45 (*Më hollësisht trajtuar në pikën4, faqe.55-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që Sektori i Mjedisit dhe Ujërave pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër, në çdo inspektim të kryer në terren të plotësoj sipas formatit procesverbalin e inspektimit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

8.Gjetje nga auditimi: Nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër sektori i Mjedisit dhe Ujërave, në përzgjedhjen e subjekteve për tu inspektuar nuk kanë përzgjedhur subjektet sipas rëndësisë së tyre dhe sipas ndikimit që mund të kenë në mjedis, pasi nga praktikat e përzgjedhura subjektet janë me ndikim të ulët ose të mesëm në mjedis. Nuk është inspektuar një numër i madh i subjekteve të pajisura me leje mjedisore ndër vite, si gurore, miniera, etj, me qëllim për të verifikuar zbatimin e detyrimit ligjor për rehabilitimin e zonës, sipas kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore (*Më hollësisht trajtuar në pikën4, faqe nr.56-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1.Rekomandimi: Drejtori i Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës Dibër, Përgjegjësi i Sektorit të Mjedisit dhe Ujërave të marrë masa dhe të hartojë plane vjetore dhe mujore për inspektimin e subjekteve me impakt të lartë ndikimi në mjedis.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, sektori i mjedisit nuk ka kryer verifikim në terren për subjekte, që kalojnë kapacitetet, nga lejet të Tipit C, në leje të Tipit B, sidomos për pikat e karburantit, pas ndryshimeve ligjore nr. 52/2020 "Për Lejet Mjedisore" . *Më hollësisht trajtuar në pikën4.2, faqe nr.56-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër në bashkëpunim me Sektorin e Mjedisit të marrë masa për të kryer verifikimin në terren të këtyre subjekteve, si dhe pajisjen e tyre me leje mjedisore në përputhje me kërkesat ligjore.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se:

-Në 12 raste në inspektimet e kryera nga inspektorët në procesverbal thuhet se: "subjekti u gjend i mbyllur", ose nuk gjendet në adresën e dhënë. Inspektimet janë kryer në mungesë të përfaqësuesit të subjektit dhe nuk është lënë detyrë për paraqitje në ARM për marrje dijeni të problemeve të trajtuara,

- Nuk ka verifikime të dokumentuara në sistemin e QKL-së,

- Nuk ka dokumente për bashkëpunimin dhe rezultatet e tij me institucione të tjera. Veprime në *kundërshtim me nenin Neni 36- Detyrimet e subjektit të inspektimit pika "d";* me ligjin nr. 10431 datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" seksioni 2 neni 62-66 "Inspektimi për mbrojtjen e Mjedisit" si dhe me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011"Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" nenin 45-48,ku neni 45; nenin 11"Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimi" të ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011"Për Mbrojtjen e Mjedisit"*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe nr.58-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10,1.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masa për hartimin e një regjistri me subjektet e konstatuara të mbyllura nga inspektimet dhe të konfirmojë statusin e gjendjes së regjistrimit, aktiv apo pasiv si biznes në QKB, në

Menjëherë dhe në vazhdimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se formulari i Inspektimit, për paragrafin "I", pika 3 "Të dhënat të përgjithshme të subjektit", "Lloji i aktivitetit ekonomik" gjenerohet nga sistemi dhe plotësohet me numër dhe jo me përshkrimin e aktivitetit në fjalë, gjë që e bën të pamundur të kuptohet lloji i aktivitetit që do të inspektohet kjo nga numri i lartë i aktiviteteve që operojnë në Qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Dibrës.*(Më hollësisht trajtuar në pikën4.2, faqe.56-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa, që në bashkëpunim me Inspektoratin Qendror, të përmirësojnë formatin elektronik, "pikën 3 Lloji i aktivitetit", me qëllim që të identifikohet saktë veprimtaria dhe aktiviteti i subjektit në rubrikën përkatëse.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: për periudhën objekt auditimi në 18 raste nuk janë kthyer përgjigje, ankesave të ardhura nga qytetarë në lidhje me problematikat për ndotjen e mjedisit, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 " Për Arkivat" dhe Kreun e III-të "Njoftimet dhe afatet Kohore për bërjen e tyre, neni 56, detyrimi për tu njoftuar, neni 59 Afatet kohore për njoftim dhe afatet kohore për zbatimin e akteve administrative të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999" Kodi Procedurës Administrative" me ligjin "Për të Drejtën e infomimit".*(Më hollësisht trajtuar në pikën4, faqe nr.76- 78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1- Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës Dibër të marrë masa që të trajtojë ankesat e qytetarëve dhe në rastet kur është e nevojshme të ngrejë grupe inspektimi për ato subjekte ndaj të cilave janë administruar ankesa nga qytetarët.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

13.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: për periudhën objekt auditimi korrik 2020- dhjetor 2021 në praktikat e dhënies së mendimit për VNM dhe mendim për Leje të Tipit A e B në dosjet përkatëse mungojnë dokumente mbështetëse, dokumente këto paraprake, mbi të cilat përgatitet shkresa për dhënie mendimi. Nuk ka informacione nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për ecurinë e procedurës për praktika të dhënieve të mendimit. Veprime në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe me Ligjin Nr.10440 datë 07.07.2011 " Për vlerësimin e ndikimit në mjedis *(Më hollësisht trajtuar në pikën3, faqe nr.30-55, të Raportit Përfundimtaret Auditimit).*

13.1.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që:
- Në praktikat e dhënies së mendimit për VNM apo mendime për Leje mjedisore Tipi A/B, të bashkëlidhin dhe përfshijnë në dosje dokumente plotësuese dhe mbështetëse, pasi të jenë miratuar me udhëzim formatet përkatëse, me synim që të vërtetojnë realizimin e procedurave dhe justifikojnë dhënien e mendimit.
- Të kryejë korrespondencë zyrtare me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për marrjen e të dhënave që lidhen me ecurinë e praktikave të dhënies së mendimeve për VNM e leje mjedisore A/B me synim përditësimin në formë elektronike të regjistrit të lejeve të tipit A/ B dhe VNM-ve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

14.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se: për periudhën objekt auditimi korrik 2020- dhjetor 2021 Agjencia Rajonale Tiranë, Durrës, Dibër, procedurat e dëgjesës me publikun për lejet mjedisore Tipi A / B, i ka realizuar në një afat të shkurtër kohor (5-7 ditë) nga delegimi i dëgjesës nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, veprime në kundërshtim me piken 10 të VKM-së nr.419 datë 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri" (*Më hollësisht trajtuar në pikën3, faqe nr.30-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
14.1.Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës dhe Dibër të marrë masa që njoftimi i dëgjesës me publikun të qëndrojë më gjatë se 15 ditë në ŵeb, me qëllim sensibilizimin dhe informimin sa më shumë të pjesëmarrësve në takim**.**

Menjëherë dhe në vazhdimësi

A. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër për 14 subjekte të cilat nuk kanë dorëzuar raportet e monitorimit mjedisor dhe kriteret e tjera ligjore, nuk ka marrë masa administrative me gjobë ndaj subjekteve përkatëse (nga 300 mijë lekë deri 500 mijë lekë), duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën ***4,200 mijë lekë****(300 mijë lekë gjoba minimale x 14 subjekte = 4,200 mijë lekë)* në kundërshtim me nenin 29 pika b (ii) të ligjit nr. 10488/2014 "Për lejet e mjedisit"*(Trajtuar më hollësisht në pikën 4, faqet 56-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1.Rekomandim: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër në bashkëpunim me Sektorin e Financës, Sektorin e Mjedisit dhe Sektorin Juridik të marrë masa për aplikimin dhe kontabilizimin e gjobës në masën 300 mijë lekë për çdo subjekt i cili nuk ka depozituar raportet e monitorimit mjedisorë dhe të kritereve të tjera, si dhe të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e tyre.
1.2. Rekomandimi: Drejtori i Agjencisë Rajonale të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër në bashkëpunim me Sektorin e Mjedisit, të marrë masa që 14 subjektet të cilat nuk kanë paraqitur raportet e monitorimit mjedisor, të hartojnë në planet mujore subjekte të cilat nuk kanë plotësuar detyrimin ligjorë në rrast të kundërt të marrë masa sipas ligjit të sipërcituar.

Brenda afatit 30.06.2022

B. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 58 germa a, c) "Llojet e masave disiplinore", nenin 59 "Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore" të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" si dhe VKM nr.171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil" i ndryshuar, pas ristrukturimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit Tiranë, Durrës, Dibër, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit Tiranë**, masat disiplinore si më poshtë:

I. "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet", Gërma "c", neni 58, ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", për punonjësit e mëposhtëm:

1. Z. G.T me detyrë përgjegjës sektori të Mjedisit.
Për të metat e mangësitë e konstatuara:
-Nuk janë hartuar programe dhe plane pune për inspektimin e subjekteve, pasi me ndryshimet ligjore, në bazë të kapacitetit të cilat kalojnë nga leje të tipit C, në lëjë të Tipit A, B .
-nuk kanë hartuar plane si dhe nuk është inspektuar një numër i madhe i subjekteve të pajisura me leje mjedisore ndër vite, si gurore, miniera, etj., me qëllim për të verifikuar zbatimin e detyrimit ligjor për rehabilitimin e zonës, sipas kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore.
-në 7 raste konstatuar pa rregulluesi, në inspektimet në fushën e mjedisit.
-në 8 raste mangësi në plotësimin e lista -verifikimit si dhe të procesverbaleve në inspektime.
-Mos përgatitje të planeve mujore dhe vjetore për subjektet që me ndryshimet ligjore kalojnë në lejë të Tipit A, B.
-Mos raportim Titullarit në funde të çdo muaji, për problematikat dhe mangësitë e inspektimit në fushën e mjedisit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë "nenin 45-48,neni 45;të ligjit nr.10431,datë 9.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit ", s dhe në kundërshtim me rregulloren e brendshme të Agjencisë Kombëtare e Mjedisit Nr.120, datë 12.01.2021.pika 5,8,10,12,13,dhe 14.

2- Znj. S.v.me detyrë specialiste lejesh mjedisore.
Për të metat e mangësitë e konstatuara:
-në 9 raste, nuk ka dhënë mendime për VNM , Lejet Mjedisore si dhe dëgjesa me publikun vepruar në kundërshtim me VKM. Nr. 419, datë 25.06.2014, si dhe të Rregullores Nr.120, datë 12.01.2021) "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë/agjencive Rajonale të Mjedisit".
për periudhën 20,09,2021,e në vazhdim përgjegjëse sektorit të mjedisit.
-në 5 raste konstatime dhe pa rregulluesi në inspektimet në fushën e mjedisit ,
në 6 rate mos hartim planesh për r- inspektimi të subjekteve që janë konstatuar të mbyllura,,
-mos hartim të planeve mujore në bazë rrisku.
-Mos raportim të Titullarit në fund të çdo muaji, për problematikat dhe mangësitë e inspektimit në fushën e mjedisit.
- nuk kanë përzgjedhur subjektet sipas rëndësisë së tyre dhe sipas ndikimit që mund të kenë në mjedis.

-nuk kanë hartuar plane si dhe nuk është inspektuar një numër i madh i subjekteve të pajisura me leje mjedisore ndër vite, si gurore, miniera, etj., me qëllim për të verifikuar zbatimin e detyrimit ligjor për rehabilitimin e zonës, sipas kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore, -
-nuk janë planifikuar subjektet të cilat me ndryshimet ligjore në baza të kapacitetit kalojnë nga leje të Tipit C në leje te Tipit A, B, sidomos subjekte që ushtrojnë aktivitet siç janë pikat e karburantit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë "nenin 45-48,neni 45;të ligjit nr.10431,datë 9.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit ".si dhe pika 8,10.12,13,14 të rregullores së brendshëm nr. 120 /2020 "Rregullore e brendshëm për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtarë të Mjedisit dhe Agjencive Rajonale të Mjedisit ", veprime në kundërshtim me ligjin nr.10433 datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë" nenin 45-48,ku neni 45, të ligjit nr. 10431, datë 9.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".
3- Z. Xh.H, në cilësinë e Inspektorit në Drejtorinë ë inspektimit në Agjencinë Kombëtarë të Mjedisit, me detyrë Drejtor i komanduar në Agjencinë Rajonale të Mjedisit Tiranë Durrës, Dibër.
Për të metat e mangësi të konstatuara,
-Nuk ka siguruar respektimin e kërkesave ligjore, si dhe nuk ka përmbushur detyrat funksionale gjatë kryerjes së funksioneve të institucionit në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi. Nuk ka nxjerrë urdhër të brendshëm për përcaktimin e detyrave funksionale për organizimin e punës në sektorin e lejeve mjedisore/person përgjegjës për publikimin e VNM në ŵebin e ARM-së sipas përcaktimeve në VKM Nr.419, datë 25.06.2014"Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi Tipi A, B", rregulloren e Agjencisë Kombëtare e Mjedisit Nr.120, datë 12.01.2021, rregulloren Nr. 01, datë 3.03.2017 me Nr.435/1 prot., datë 03.03.2017, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit "Për zbatimin e procedurave dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 " Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore.
-Nuk kanë hartuar planet vjetore mbi bazë rrisku ,
-në 36 raste, pezulluar inspektimit në fushën e mjedisit pas hedhjes në sistem , o-nline të portalit e-Inspektimit për subjekte që kanë, veprimtari të ndryshme,
-në 7 raste, nuk janë hartuar autorizime për inspektimin e subjekteve që janë konstatuar të mbyllura (ri*-inspektime) të subjekteve .
-në 4 raste nuk janë hartuar programe inspektimi ndaj subjekteve te cilat rezultojnë aktive në QKB.
- në 11 raste, nuk kanë janë kthyer përgjigje ankesave të qytetarëve apo grupeve të interesit, në lidhje me problematikat në fushën e mjedisit, ankesa të cilat ishin të protokolluara pranë AKM së.
– Mos përfshirjen në planet vjetore për inspektime të subjekteve me rrisk të lartë në fushën e mjedisit.
-nuk janë miratuar programet mujore të inspektimit, si dhe nuk janë dërguar për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2 të Kreut IV të VKM nr.696, datë 16.08.2013 "Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik "e-inspektimi".

II. "Vërejtje", Gërma "c", neni 58, ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", për punonjësit e mëposhtëm:

1.Z.O,Gj, në cilësinë e inspektorit në sektorin e mjedisit, Drejtor i komanduar.
Për të metat e mangësi të konstatuara,
-Nuk ka siguruar respektimin e kërkesave ligjore gjatë kryerjes së funksioneve të institucionit në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi, nuk ka përmbush detyrat funksionale sipas rregullores së Brendshme të Agjencisë Kombëtare e Mjedisit Nr.120, datë 12.01.2021, rregulloren Nr. 01, datë 3.03.2017 me Nr.435/1 prot.,datë 03.03.2017, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit "Për zbatimin e procedurave dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, VKM Nr. 686, datë 29.07.2015 " Për miratimin e rregullave , të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore.
-Nuk kanë hartuar planet vjetore mbi bazë rrisku ,
-Mos përfshirjen në planet vjetore inspektime të subjekteve me rriskë të lartë në fushën e mjedisit.
-në 8 raste nuk ka hartuar programe pune, për subjektet të cilat kanë rezultuar të mbyllura.
-në 7 raste nuk janë kthyer përgjigje, ankesave të ardhur nga qytetarë në lidhje me problematikat në lidhje me ndotjen e mjedisin.

2. Z. E.D, me detyrë inspektor në sektorin e Mjedisit, për gjithë periudhën objekt auditimi**,** për pa rregulluesit e konstatuara në 8 raste në inspektimet në fushën e mjedisit.

3. Z. J.Zh , me detyrë inspektor në sektorin e Mjedisit, për gjithë periudhën objekt auditimi**,**për parregullsitë e konstatuara në 6 raste në inspektimet në fushën e mjedisit.

4. Z. A.K, me detyrë inspektor në sektorin e Mjedisit, për gjithë periudhën objekt auditimi**,** për parregullsitë e konstatuara në 8 raste, ne inspektimet në fushën e mjedisit.

5. Z. **B.D.,** me detyrë inspektor në sektorin e Mjedisit, për gjithë periudhën objekt auditimi**,** për parregullsitë e konstatuara në 7 raste në inspektimet në fushën e mjedisit.

6. Z. A.B , me detyrë inspektor në sektorin e Mjedisit, për gjithë periudhën objekt auditimi**,** për parregullsitë e konstatuara në 8 raste në inspektimet në fushën e mjedisit.

7. Z. R.XH me detyrë inspektor në sektorin e Mjedisit, për gjithë periudhën objekt auditimi**,** për parregullsitë e konstatuara në 4 raste në inspektimet në fushën e mjedisit.
përgjegjës i komanduar i lejeve mjedisore në 4 raste (veprime në kundërshtim me VKM. Nr. 419, datë 25.06.2014, "Rregullores së Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" Nr.120, datë 12.01.2021.

8. Z. I.A me detyrë inspektor në sektorin e Mjedisit, për gjithë periudhën objekt auditimi**,** për parregullsitë e konstatuara në 6 raste në inspektimet në fushën e mjedisit.

9. Z.B.Cme detyrë inspektor në sektorin e Mjedisit, për gjithë periudhën objekt auditimi**,** për parregullsitë e konstatuara në 6 raste në inspektimet në fushën e mjedisit.

10. F.M me detyrë inspektor në sektorin e Mjedisit, për gjithë periudhën objekt auditimi**,** për parregullsitë e konstatuara në 5 raste në inspektimet në fushën e mjedisit.

11. Znj. F.M, me detyrë inspektore në sektorin e Mjedisit, për gjithë periudhën objekt auditimi**,** për parregullsitë e konstatuara në 8 raste, në akt konstatimet nr. 4, 5 datë 31.03.2022.

12. Znj. **M .h**, me detyrë përgjegjëse e komanduar në sektorin e lejeve mjedisore për parregullsitë e konstatuara në 6 raste, në lidhje me dhënie mendime për leje mjedisore VNM dhe konsultime me publikun. Veprime këto në kundërshtim me VKM Nr. 419, datë 25.06.2014 si dhe "Rregullores Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" Nr.120, datë 12.01.2021.

13. Znj. A.M, me detyrë specialiste lejesh mjedisore, për parregullsitë e konstatuara në 4 raste, në lidhje me dhënie mendime për leje mjedisore VNM dhe konsultime me publikun. Veprime këto në kundërshtim me VKM Nr.419, datë 25.06.2014 si dhe "Rregullores Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" Nr.120, datë 12.01.2021.

14. Znj. A M. me detyrë specialiste lejesh mjedisore, për parregullsitë e konstatuara në 5 raste, në lidhje me dhënie mendime për leje mjedisore VNM dhe konsultime me publikun. Veprime këto në kundërshtim me VKM Nr.419, datë 25.06.2014 si dhe "Rregullores Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" Nr.120, datë 12.01.2021.

15. Znj. M S, me detyrë specialiste lejesh mjedisore për parregullsitë e konstatuara në 10 raste, në lidhje me dhënie mendime për leje mjedisore VNM dhe konsultime me publikun. Veprime këto në kundërshtim me VKM Nr.419, datë 25.06.2014 si dhe "Rregullores Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" Nr.120, datë 12.01.2021.

16. Znj. M L, me detyrë specialiste e komanduar në sektorin e lejeve mjedisore për parregullsitë e konstatuara në 6 raste, në lidhje me dhënie mendime për leje mjedisore VNM dhe konsultime me publikun. Veprime këto në kundërshtim me VKM Nr.419, datë 25.06.2014 si dhe "Rregullores Brendshme të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit" Nr.120, datë 12.01.2021.

E.NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Agjencia Kombëtare e Mjedisit Tiranë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

Persa me sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT